BAU
821.133.1-3 =18

FONDI
I ARTE
I LETERSISE
BOTERORE

CHARLES BAUDELAIRE

Brenga e Parisit


Onufri

R/2007

Lexuesit martirë të botës komuniste, lexuesit me emra të panjohur, që stuhia e kohës i gëlltiti në terrin e saj, bëjnë pjesë në sferën ende të pandriçuar të historisë së letërsisë botërore. Për këtë holokaust letrar është folur ende pak. E në këtë holokaust kanë pa dyshim vendin e tyre edhe lexuesit shqiptar.

Ndaj botimi në gjuhën shqipe i prozës së Charles Baudelaire-it, një ndër figurat qendrore të letërsisë së mallkuar, është më shumë se një ngjarje letrare. Ajo është pjesë e vuajtjes shqiptare, pra pjesë e historisë së saj.

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-



Fondi i artë i letërsisë botërore

Botohet nën kujdesin e

Ismail Kadare

V

Nr. inv. 1374


BIBLIOTEKA KOMBËTARE - REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE

CHARLES BAUDELAIRE

Brenga e Parisit

Poema në prozë

Përktheu nga origjinali:
Besiana Kadare

Onufri

Titulli i origjinalit:
Le spleen de Paris
(Petits poëmes en prose)

Përgatiti për botim:
Bujar Hudhri

© Onufri, 2000

ISBN 99927-30-86-2

Botuesi i shpreh mirënjohjen Fondacionit Bardha,
që financon këtë kolanë.

Shtëpia Botuese Onufri
Rr. "Asim Vokshi", Kulla 10 katëshe, Ap.3, Tiranë
Tel&Fax 00355 42 20017
htpp://www.Onufri.com
E-mail:onufri@albnet.net

PARATHENIE

Proza e të mallkuarit

Në pothuajse të gjitha gjuhët e botës gjendet shprehja "tokë e nëmur" e në shembullim të saj "popull i nëmur" e "ditë e nëmur".

Pra qysh në lashtësi mendja njerëzore e quajti të natyrshme t'ia bashkangjisë hijen e rëndë të mallkimit tre elementëve themelorë: tokës, kohës dhe njeriut. Në shekullin e XIX-të Paul Verlaine krijoi togfjalëshin "artist i mallkuar", që do të shërbente si karakterizim i një brezi të tërë poetësh, ndër të cilët më të shquarit ishin Arthur Rimbaud dhe Charles Baudelaire.

Shprehja e Verlaine-it hynte ndër ato mrekulli të errëta të gjuhës, që paralajmëronin fatkeqësi të ardhme. Shkrimtarët "e mallkuar" qoftë në Francë, qoftë në vendet e tjera evropiane, e përjetuan në mënyra të ndryshme gjendjen e tyre të veçantë, disa në trajtë vetëvuajtje, të tjerë duke e kthyer mallkimin

mallkimin në një farë ekstaze krijuese, e ndonjë si Oscar Wilde, e pagoi me çnderim e burgim të rëndë. Megjithatë në atë kohë, as ata vetë e as të tjerët që u morën me ta, qoftë ithtarët e zjarrtë e qoftë kundërshtarët plot helm, nuk e parashikuan dot se pesha e mallkimit, në vend që të zbutej, do të zymtohej edhe më në shekullin e ardhshëm, atë të XX-in. Për të qenë më të saktë duhet thënë se ndodhi diçka e habitshme, krejtësisht kundër-thënëse, një nga ato dukuri që dëshmojnë se jeta e letërsisë dhe e artit rrjedh sipas ligjeve të ndryshme nga ato të jetës njerëzore. Në shekullin e XX pra, kur shkrimtarët e nëmur njëri pas tjetrit po çliroheshin nga nëmia e po zinin vendet e tyre, gjer atëherë të mohuar, në tempujt e panteonet letrare, mallkimi befas u përtërit, në mënyrën më të papritur. Ai u projektua tashmë jashtë tyre në popuj e hapësira të tjera, në trajtën më të zezë që mund të mendohej. Në gati gjysmën e botës, në atë që quhej "perandori komuniste", shkrimtarët e mallkuar e rifituan vulën e tyre ogurzezë. Ata vetë ishin të mbrojtur tashmë nga vdekja dhe fama që në vendet e tyre sa vinte rritej, por kjo nuk pengonte aspak që mekanizmi i mallkimit, ashtu siç përfytyrohej nga popujt e lashtë, të punonte edhe më fort. Tërbimi kundër këtyre shkrimtarëve, djegia, ndalimi i tyre, ishin vetëm një pjesë e së keqes. Pjesa tjetër e mallkimit, ajo më e tmerrshmja, ra mbi lexuesit e tyre. Dhjetëra, mijëra njerëz në botën komuniste u përndoqën, u burgosën, u

torturuan, e disa herë u grinë barbarisht me plumb vetëm se patën guximin ose pakujdesinë të lexonin, të përkthenin a të kujtonin në ndonjë pasdarke vargje të poetëve të nëmur. Bota kishte njohur edhe më parë ndalime librash shoqëruar me ndëshkime të ashpra, por ishte herë e parë që raportet shkrimtar-lexues merrnin në një shkallë kaq të gjerë një ngjyrim të tillë tragjik.

Lexuesit martirë të botës komuniste, lexuesit me emra të panjohur, që stuhia e kohës i gëlltiti në terrin e saj, bëjnë pjesë në sferën ende të pandriçuar të historisë së letërsisë botërore. Për këtë holokaust letrar është folur ende pak. E në këtë holokaust kanë pa dyshim vendin e tyre edhe lexuesit shqiptarë.

Ndaj botimi në gjuhën shqipe i prozës së Charles Baudelaire-it, një ndër figurat qendrore të letërsisë së mallkuar, është më shumë se një ngjarje letrare. Ajo është pjesë e vuajtjes shqiptare, pra pjesë e historisë së saj.

Charles Baudelaire u lind më 1821, në të njëjtin vit që erdhën në këtë botë Dostojevski dhe Flaubert-i. Jeta e tij ishte e shkurtër dhe e trazuar. I ngrysur, i ftohtë me familjen, "shpirt që ndriçohet prej afrimit të fatit të keq", siç e ka krahasuar një bashkëkohës, me borxhe qysh në rini, me një tundim vetëvrasjeje, i joshur nga droga, nga viset e largëta, nga një vajzë mulate, që do të ishte dashuria kryesore e jetës së tij, shëndetdobët, i pavullnet, i torturuar nga sifilisi, dhe së fundi, si të



mos mjaftonin të gjitha këto, i prekur nga çmenduria, ai vdiq në moshën 46 vjeçare, pothuajse i paralizuar dhe i pagojë.

Siç ndodh shpesh në jetën e krijuesve, e gjithë kjo ngrehë e zymtë e jetës së tij ngjante si e përgatitur enkas për të ndihmuar krijimin e një vepre që do të ishte në harmoni me të. "Ju jeni i qëndrueshëm si mermeri e i tejdukshëm si një mjegull e Anglisë" i shkruante në një letër Flaubert-i.

Më 15 mars 1866, ndërsa vizitonte një kishë, Baudelaire u shemb papritur përdhé. Ishte kjo rënie e cila ia paralizoi gjymtyrët, pa ia prekur mendjen. Ndërkaq duhet thënë se përpara se të ndodhte kjo goditje, që shumëkujt do t'i ngjante si një ndëshkim qiellor, Baudelaire qysh herët e kishte marrë kërcënimin tokësor të njerëzve: vepra e parë e rëndësishme e tij, përmbledhja poetike "Lulet e së keqes", fill pas botimit më 1857 u godit nga një proces gjyqësor, i cili e dënoi shkrimtarin për imoralitet, duke e ndëshkuar me gjobë dhe me censurimin e 8 vjershave.

Proceset gjyqësore nuk do t'u ndaheshin "të mallkuarve", që nga ato që lidheshin me kacafytjet kafeneve të Verlain-it me Rimbaud, gjer te dënimi i Oscar Wilde për homoseksualitet, i vetmi në koleksionin e veseve, siç quheshin atëherë, që Baudelaire nuk e njohu. Ndërkaq duhet thënë se gjyqi kundër "Luleve të së keqes" ishte një tmerr, përmasat e të cilit do të projektoheshin, siç u tha më lart, në të ardhmen. Njëqind vjet më pas, kur

dhjetëra, mijëra shkrimtarë të botës komuniste do të zvarriteshin nëpër burgjet dhe baltrat e Kinës, për një përkim ogurzi, qëlloi që në këtë hetakombë të pashembullt gjendej prapë fjala "lule". (Të lulëzojnë njëqind lulet!).

Poezia e Baudelaire-it u quajt imorale jo në mënyrë tinzare, për të fshehur një shkak tjetër, ta zëmë politik, çka do të ndodhte shpesh më pas. Ajo u quajt e tillë ngaqë ashtu ngjante dhe ashtu ishte për moralin e kohës, pra si rrjedhojë e një keqkuptimi tragjik për artin.

Vetë shkrimtarët e "mallkuar", jo vetëm që nuk deshën të përligjin asgjë për veprën e tyre, por me dëshirë shkuan drejt lëçitjes dhe mallkimit. "Unë e kultivoj histerinë time me ngazëllim e tmerr" shkruante Baudelaire në ditarin e tij intim. Në këtë rendje drejt bujës e skandalit, atje ku dukej se ishte strehuar forca e tyre, pikërisht atje, bashkë me të, ishte strehuar edhe brishtësia. Krijuesit e mëdhenj, ata, mendja e të cilëve punon në sferat sipërane të artit, vetvetiu i shmangen përzierjes së jetës së tyre të përditshme me aventurën e madhe të krijimit. Me fjalë të tjera, duke qenë të detyruar të jetojnë jetën njerëzore, qoftë me shkëlqimin e luksin, qoftë me mizerjen e saj, ata s'mund t'i marrin seriozisht as njërën as tjetrën, e aq më pak të vetmahniten a të vetvajtojnë për to. Shkurt, sfida e tyre ndaj epokës zhvillohet në përmasa të tjera dhe vështirë se mund të ketë gjë të përbashkët me modën kalimtare, me përndezjet e kafeneve, me lavdinë e dyshimtë, që

mund të vijë nga përdorimi i drogës, apo përkëdhelja e amoralitetit.

Shkrimtarët e "mallkuar", e kryesisht Baudelaire, të tërhequr nga ai që u quajt "dandizmi në letërsi" krijuan përshtypjen te shumëkush se u dhanë më shumë se ç'duhej pas gjërave, që mund të ishin tërheqëse e joshëse për njerëzit e rëndomtë, por kurrsesi për krijimin e madh. Duke patur një përbuzje të ligjshme për gjërat e rëndomta e për vulgaritetin, u duk sikur ata ranë vetë në kurthin e tyre.

Kështu shpjegohet ndoshta që, duke qenë të rëndësishëm si dukuri e si grup shkrimtarësh, duke i dhënë poezisë franceze e asaj botërore perla të rralla e të papërsëritshme, nuk mund të thuhet se ndonjëri prej tyre u ngrit në lartësinë komplekse të Balzakut, për të marrë një shembull francez, e aq më pak në atë të familjes së gjenive të tillë si Dante apo Shekspiri.

Kjo nuk cënon asgjë në peshën e tyre, e as që e vë në dyshim atë, që Baudelaire të quhet si prijës i letërsisë moderne franceze. Përkundrazi, është pikërisht kjo që ndoshta shpjegon më së miri tiparet e kësaj letërsie sot.

Historia e zhvillimit të letërsisë botërore mbetet përherë e ndërlikuar dhe shpesh misterioze. Shkëlqimet e saj, siç qëllon që shfaqen nëpërmjet një gjeniu të vetëm, po ashtu mund të shfaqen nëpërmjet një grupi. Madje edhe ky i fundit qëllon që nuk arrin të japë vetë vlera të njëmendta, por

përgatit ndërkaq klimë të ardhshme e horizonte të reja, e mbetet i rëndësishëm. Për të bërë një krahasim që mund të plagosë natyrat e ndjeshme, mund të thuhet se, ashtu sikundër në kërkimet e naftës, kur shpimi i puseve edhe kur nuk jep asgjë quhet një sukses, ngaqë i çliron kërkuesit nga një iluzion, edhe në kërkimet letrare, qofshin të pafrytshme aty për aty, gjëllon shpesh fara e vlerave të ardhme. Thesari letrar botëror mund të përfytyrohet kështu në një pamje të tij të plotë bashkë me pjesët e tij të aspakta, domethënë me ato gropa e zbrazëti që s'kanë emër, por që u flijuan për të përgatitur emrat e mëdhenj. Shembull i fundit për këtë ka qenë historia iluzore e "romanit të ri", ajo që qysh tani bën pjesë në varrezat e letërsisë, e për të cilën, megjithatë, askush nuk mendon se ka qenë e kotë.

"Shkrimtarët e mallkuar" patën si rrallëkush fatin e dyfishtë të krijonin vlera të njëmendta e të hapnin horizonte të rinj. Baudelaire ngulte këmbë në "sipëraninë e përjetshme të dandyt", ndonëse dandizmi në letërsi s'mund të ishte veçse një iluzion në radhën e iluzioneve të shumta. "Mallkimi", dandyzmi, pirgu i fildishtë, stili mandarin, etj. të gjitha këto kaluan si valë përqethëse në letërsinë evropiane, duke përshkënditur në veprat e Flauber-it, Nerval-it, Wild-it, Moor-it, Eliot-it, Woolf-it, Proust-it e gjer të Joyc-it. Në të gjithë këtë rrjedhë trazuese ndihet shqetësimi i shkrimtarëve për të mbrojtur letërsinë nga sulmi i vulgaritetit dhe i së

rëndomtës, shqetësim i përjetshëm i krejt racës së shkrimtarëve. Letërsia kështu ka lindur qysh para tre mijë vjetësh, bashkë me instiktin e saj mbrojtës: të jetojë sa më gjatë në këtë rruzull të egër që quhet tokë. Dëshira për drejtësi, ajo që Cyril Connolly i kohës sonë e ka shprehur me fjalët "që libri të jetojë pakëz më shumë se një qen, ose një veturë, ose afati i një huaje bankare", është bazike te të gjithë krijuesit. Shkrimtarët sqimatarë, (elitistë, mandarinë, pirgofildishienë, parnasienë, etj.etj.), prijësi e pararendësi i të cilëve mbetet pa kurrfarë dyshimi Charles Baudelaire, sikur të parandjenin mësymjen e tmerrshme që letërsia do të pësonte në shekullin që po vinte prej turmave vulgare, shpejtuan të forconin ledhet e saj mbrojtëse. Atë që ata nuk e kapën ndoshta plotësisht, ishte se letërsia botërore i kishte patur përherë ato ledhe, ngaqë pa to as që mund të jetonte. Letërsia e vërtetë ashtu edhe kishte lindur: zonjë e madhe, me sqimë të madhe, e jo të rreme. Ajo nuk e kishte ndarë kurrë atë që quhej "zonë hyjnore" nga zona e përditshme e jetës. Falë kësaj, letërsia e vjetër greke përballoi mijëvjeçarët. Dante Aligheri i përzieu këto dy zona në ferrin e tij, Shekspiri në kështjellat e zymta skoceze, kurse Servantesi brenda trurit të krisur të Don Kishotit.

Në jetën e shumicës së shkrimtarëve ia beh gjithmonë një kohë kur atyre iu duket se gjinitë letrare, (ose më saktë, ato që mendja jonë e gjymtuar nga gjithfarë trysnish i quan kështu), janë një veshje

penguese për ta. Me të drejtë ata rebelohen kundër tyre, përpiqen t'i ndryshojnë, t'i zgjerojnë, t'i pasurojnë, me fjalë të tjera t'i thyejnë. Përfundimi shpesh është i kundërt me ëndrrën e tyre: janë ata që në shumicën e rasteve thyhen e jo gjinitë. Shpjegimi është i thjeshtë: nervozizmi kundër gjinive letrare është shpesh më i bujshëm te shkrimtarët e mesmë sesa te krijuesit e mëdhenj. Të parët, duke mos qenë të aftë të japin vlera të mirëfillta askurrkund, i ndërrojnë gjinitë shpesh e duke i braktisur i fajësojnë gjithë mllef e pa dyshim i bëjnë shkaktare për çdo dështim. Të dytët, krijuesit e mëdhenj, kanë marrëdhënie harmonioze me gjinitë, dhe ndonëse ato kostume shekullore qëllon që i shtrëngojnë, ata dinë të merren vesh me to. Kjo është e natyrshme ngaqë letërsia e madhe botërore kështu ka lindur: në një përzierje, apo më saktë, marrëveshje midis atyre që do të quheshin më pas gjini. "Iliada" lexohet po aq si roman, sa si poemë epike, si kronikë e një lufte, ose si dramë me shumë akte.

Proza e Charles Baudelaire është shembull i harmonisë krijuese brenda universit të një shkrimtari. Duke mos qenë as rastësi, as trill e as dëshirë për freskim, e aq më pak dyzim i poezisë së tij, ajo është pjesë themelore e botës bodleriane.

Baudelaire shkroi në prozë për një kohë tepër të gjatë dhe proza e tij është jo vetëm vazhdimësi, por edhe risim i krejt veprës së tij.

Ne nuk mund ta dimë kurrë, e qëllon që as

krijuesi vetë nuk e ka të qartë gjer në fund shtysë
e vërtetë për të kaluar nga një gjini letrare te tjetra
Për krijuesit e mirëfilltë, ajo urdhërohet në sferat e
larta, të fshehta të krijimit, ndaj edhe shpjegimi për
të mbetet gjithmonë i mangët. Shtysa e Charles
Baudelaire-it drejt prozës mund të ketë lidhje të
natyrshme me dufin e tij sfidues ndaj botës, me
sqimën, me përçmimin ndaj së rëndomtës, së fundi,
me prirjen për blasfemi e satanizëm. Në vështrim
të parë ngjan disi kundërthënëse që elitizmi të të
çojë drejt prozës, por po të hetohet më thellë bëhet
e qartë se, pikërisht në prozë shpaloset më mirë
kundërtia midis shfaqjes banale të jetës dhe thelbit
të fshehtë, shpeshherë misterioz, që është ndryrë
brenda lëvozhgës së saj. Në rrëfimin e një endacaku
parizian, te hyrja e një restoranti, te një grumbull
laviresh që qeshin ose që rrihen prej dashnorëve,
shkrimtari kërkon të zbulojë një tjetër gjë, ai kërkon
të bëjë një zbritje ose një ngjitje danteske, për të
patur kështu mundësi për një vizion të madh.

Natyrisht që të gjitha këto duken se janë "punë
të poezisë", por Baudelaire ndaj është sfidues,
përçmonjës e kërkues, ngaqë për të na trandur, apo
për të na plagosur më fort, e zbulon "zonën qiellore"
atje ku ajo është e fshehur më mirë: në baltën e së
përditshmes.

Proza e Charles Baudelaire-it botohet për herë
të parë në gjuhën shqipe. Në botimet frëngjisht, që
u bënë kryesisht pas vdekjes së tij, midis titujve të

shumtë të lënë prej autorit, *Poezi nate, Brenga e Parisit, Endësi i vetmuar, Poezi të vogla në prozë,* u zgjodh kjo e fundit që mori në njëfarë mënyre miratimin e kritikës universitare. Meqenëse fjalët "poezi në prozë" ose "prozë poetike", në vendet e ish perandorisë komuniste lidhen me kujtimet e kohës kur pikërisht në këtë gjini letrare u bënë edhe shpërdorimet më të shumta për vulgarizmin e letërsisë, në emër të masivitetit të saj, u mendua që në botimin shqip të zgjidhej një nga titujt e tjerë: "Brenga e Parisit". Mund të thuhet se përkthimi i prozës së Baudelaire-it në gjuhë të ndryshme ka qenë shpesh më i vështirë se ai i poezisë së tij. Kjo vështirësi ka lidhje pikërisht me vizionin elitist të shkrimtarit. E panatyrshmja, droja e dhunimit të artit prej realitetit, duke bërë pjesë në thelbin e kësaj proze, shprehet edhe në veshjen gjuhësore të saj. Ndaj ka qenë e kuptueshme mëdyshja e përkthyesve të shumë vendeve për të zgjedhur midis besnikërisë së plotë ndaj autorit dhe një lirie që do të synonte një tingëllim më të natyrshëm në gjuhën e përkthyer. Kjo e fundit, e zgjedhur prej shumicës së përkthyesve, do të ishte një dhunim në rastin e Baudelaire-it. Ndaj në gjuhën shqipe, ashtu si në përkthimet anglisht, u parapëlqye në këtë botim të parë, besnikëria.

Ismail Kadare

Për Arsène Houssaye[1)]

Miku im i dashur, po ju dërgoj një vepër të vogël për të cilën kurrsesi nuk mund të thuhet se s'ka as fillim as fund, meqenëse përkundrazi, gjithçka është njëkohësisht e në mënyrë të ndërsjelltë, herë fillim herë fund. Përfytyroni pak, ju lutem, ç'të mira të admirueshme kjo thurje na ofron të gjithëve, juve, mua, lexuesit. Kështu, mund ta ndërpresim kur të duam, unë ëndërrimin, juve dorëshkrimin, lexuesi këndimin; sepse unë nuk e mbaj të varur dëshirën e pabindur të këtij të fundit në fijen e pafund të një intrige të cekët. Hiqni një rruazë, dhe të dyja copat e kësaj fantazie dredha-dredha do të bashkohen pa mundim. Grijeni në copa të panumërta, dhe do ta shihni se secila mund të qëndrojë më vete. Me shpresën se disa prej këtyre copave do të jenë aq të

[1)] Arsène Houssaye (1814-1896), kryeredaktor i revistës *L'Artiste* dhe redaktor në revistën *La Presse*, kish botuar gjithashtu një vëllim me poezi.

gjalla sa t'ju pëlqejne dhe t'ju dëfrejnë, po marr guximin t'jua dedikoj krejt gjarprin.

Kam një rrëfim të vogël për t'ju bërë. Isha duke shfletuar, për të njëzetën herë të paktën, të famshmin *Gaspari i Natës*[2] të Aloysius Bertrand (një libër që njihet nga ju, unë dhe disa prej miqve tanë, a nuk merr çdo të drejtë të quhet *i famshëm*?) kur më erdhi ideja të përpiqesha të bëja diçka të ngjashme dhe të përdorja për të përshkruar jetën moderne, ose më saktë *një* jetë moderne dhe më abstrakte, metodën që ai kishte përdorur për të dhënë tablonë e jetës së vjetër, aq çuditërisht piktoreske.

Cili prej nesh, ditëve kur i hypën ambicja, nuk ëndërron mbi mrekullinë e një proze poetike, muzikore por pa ritëm dhe pa rimë, sa të epshme aq edhe plot ngërç, që iu përshtatet hoveve lirike të shpirtit, valëzimeve të ëndërrimit, ngulçeve të ndërgjegjes?

Dihet se ky ideal ngulmues lind nga njohja e qyteteve të mëdha dhe nga kryqëzimi i marrëdhënieve të tyre të panumërta. Ju vetë, mik i dashur, a nuk jeni përpjekur të ktheni në një *këngë* klithmën çjerrëse të *Xhamashitësit*[3] , dhe të shprehni në një prozë lirike të gjitha ato mendime pikëlluese që kjo klithje dërgon përmes avujve të rrugës deri në papafingo?

---

2) Është një përmbledhje poemash në prozë, në formë balladash, e botuar më 1842.

3) Poemë sentimentale e Houssaye, më tepër prozaike se sa poetike.

Por, me thënë të drejtën, kam frikë se xhelozia ime nuk më ka sjellë lumturi. Sapo kisha filluar punën, vura re se jo vetëm isha larguar shumë nga modeli im misterioz dhe i shquar, por edhe se isha duke bërë diçka (nëse kjo mund të quhet *diçka*) *krejtësisht të veçantë*, aksident i cili pa dyshim do *të kish bërë të krenohej cilindo* tjetër përveç meje, por që poshtëron thellësisht një mendje që e quan si krenarinë më të madhe të poetit të kryejë *pikërisht* atë ç'ka ka patur synim.

Përzemërsisht, i juaji
C.B.

I

I huaji

— Thuajmë, kë do më shumë, njeri i mistershëm, atin, nënën, motrën, apo vëllanë?

— Nuk kam as atë, as nënë, as motër, as vëlla.

— Miqtë e tu?

— Tani po përdorni një fjalë të cilës gjer më sot s'ia di kuptimin.

— Atdheun tënd?

— Nuk e di as se ku ndodhet.

— Bukurinë?

— Do ta doja me gjithë zemër, perëndeshë dhe të pavdekshme.

— Arin?

— E urrej, sikurse ju urreni Zotin.

— Epo atëherë çfarë do ti, i huaj i jashtëzakonshëm?

— Unë dua retë... retë që përshkojnë qiellin... atje tutje... atje tutje... të mrekullueshmet re!

II

Dëshpërimi i plakës

Plaka e rregjur dhe e fishkur u ngazëllye krejt kur pa atë fëmijë të bukur, të cilit të gjithë sa ishin përpiqeshin t'i bënin qejfin dhe t'i pëlqenin; atë qenie të bukur, po aq të brishtë sa plaka e vogël, dhe po si ajo, pa dhëmbë e pa flokë.

Dhe plaka iu afrua që ta përkëdhelte e ta gëzonte. Por fëmija i tmerruar filloi të përpëlitej nën përkëdheljet e gruas së drobitur dhe shtëpia ushtoi nga kuisjet e tij.

Atëherë, plaka e shkretë u tërhoq në vetminë e saj të përhershme, dhe duke qarë në një kënd thoshte me vete: "Ah! Mjerë ne femrat e plakura që na ka kaluar mosha për t'iu pëlqyer njerëzve, madje edhe të pafajshmëve; ne u kallim datën fëmijëve të vegjël që duam të përkëdhelim!"

III

Confiteor[1] i artistit

Sa depërtuese janë muzgjet vjeshtore! Ah! Depërtuese gjer në dhimbje! Sepse ekzistojnë disa ndjesi fort të këndshme që, ndonëse të mjegullta, janë të fuqishme; dhe nuk ka majë më të mprehtë sesa ajo e Pafundësisë.

Ç'kënaqësi e madhe është të kredhësh vështrimin në hapësirën e pafundme të qiellit e të detit! Vetmi, heshtje, dëlirësi e pakrahasueshme e kaltërsisë! një velë e vockël që fërgëllon në horizont, dhe që me vogëlsinë dhe vetminë e saj imiton jetën time të pandreqshme, melodi monotone e valëve; të gjitha këto mendojnë nëpërmjet meje, ose unë mendoj nëpërmjet tyre (sepse në madhështinë e

1. Titulli është me qëllim i dykuptimshëm: Confiteor në latinishten klasike do të thotë: "Unë shpall solemnisht..." Confiteor-i i krishterë është pohimi i mëkateve. Këtu, mëkatet për të cilat rrëfehet poeti janë të metat të tij për sa i përket idealit artistik.

ëndërrimit kuptimi i *unit* humbet shpejt!); ato mendojnë, them unë, por në një mënyrë muzikore dhe piktoreske, pa stërhollime, pa silogjizma, pa përfundime.

Sidoqoftë, këto mendime, pavarësisht nëse dalin prej meje apo burojnë prej gjërave, shumë shpejt bëhen tepër të fuqishme. Dhe energjia e kënaqësisë të krijon një shqetësim e një vuajtje pozitive. Nervat e mia tepër të tendosura nuk japin tashmë veç ca dridhje çjerrëse e të dhimbshme.

Tani thellësia e qiellit më pikëllon; qartësia e tij më acaron. Pandjeshmëria e detit, pandryshueshmëria e pamjes, më revoltojnë... A duhet vallë pambarimisht të vuash apo t'i largohesh pambarimisht Bukurisë? Natyrë magjiplote dhe e pamëshirshme, kundërshtare gjithmonë fitimtare, lermë! Mjaft i tundove dëshirat dhe krenarinë time! Studimi i Bukurisë është një dyluftim, ku artisti klith nga tmerri përpara se të dorëzohet.

IV

Një hokatar

Festimi i Vitit të Ri kishte arritur kulmin e vet; një rrëmujë balte dhe dëbore, e përshkruar nga mijëra karroca, e përndritur nga lojërat e bombonet, gëluese në lakmira e dëshpërime; është marrëzia zyrtare e një qyteti të madh, e aftë të turbullojë edhe mendjen e vetmitarit më kokëfortë.

Në mes të kësaj katrahure të potershme, një gomar ecte me gjallëri, ndjekur nga një harbut i armatosur me një kamxhik.

Në çastin kur gomari po merrte kthesën e një rruge, një zotëri bukurosh me doreza, i lustruar, mizorisht i kravatuar e i burgosur në një kostum fringo të ri, u përkul në mënyrë ceremoniale përpara kafshës së përulur dhe i tha duke hequr kapelen: "Ju uroj një vit të mbarë e të lumtur!" Pastaj u kthye nga miqtë e tij me një pamje mburraveci, si të kërkonte miratimin e tyre për të kurorëzuar suksesin e vet.

Gomari as nuk e vuri re këtë hokatar të hollë dhe vazhdoi të vraponte me zell atje ku e thërriste detyra.

Kurse mua më zuri papritur një tërbim i pakufishëm kundër këtij tyryfyli të përsosur, që m'u duk se mishëronte krejt mendësinë dhe humorin francez.

V

Dhoma dyshe

Një dhomë që i ngjan një ëndrre, një dhomë me të vërtetë *shpirtërore*, në të cilën atmosfera e amullt është lehtas e ngjyruar në rozë e në blu.

Aty shpirti kridhet në një banjë plogështie, të aromatizuar me keqardhje e dëshirë. – Është një mugëtirë e kaltër dhe e trëndafiltë; një ëndërr epshndjellëse gjatë një eklipsi.

Orenditë kanë trajta të zgjatura, të kapitura, të mekura. Duken sikur ëndërrojnë dhe jetojnë në një gjendje somnambulike, njëlloj si bota bimore e minerale. Stofrat flasin një gjuhë të heshtur, sikurse lulet, qiejt, diejt që perëndojnë.

Mbi mure, asnjë ndotje artistike. Në krahasim me ëndrrën e kulluar, me ndjesinë e paanalizuar, arti i përcaktuar, arti pozitiv, është një blasfemi. — Këtu gjithçka ka qartësinë e mjaftueshme dhe errësirën fort të këndshme të harmonisë.

Një kundërmim fare i lehtë, i përzgjedhur me shije të përsosur dhe i përzier me një notë lagështire, noton në këtë atmosferë ku mendja e dremitur përkundet nga ndjesi që të kujtojnë serat e ngrohta.

Tyli bie si shi i dendur mbi dritare e mbi shtrat; ai derdhet si ujëvarë dëbore. Dhe mbi këtë shtrat është shtrirë Idhulli, mbretëresha e ëndrrave. Po si vallë ndodhet ajo këtu? Kush e solli? Ç'fuqi magjike e vendosi mbi këtë fron ëndërrimi e kënaqësie? Po ç'rëndësi ka? Ja tek është! Unë e njoh.

Ja tek janë ata sy, flaka e të cilëve përshkon muzgun; ata *sy* të mprehtë e të tmerrshëm që i njoh nga djallëzia e tyre e frikshme. Ata tërheqin, magjepsin, përpijnë vështrimin e kokëshkretit që i sodit. I kam studiuar shpesh këta yje të zinj që zgjojnë kureshtjen dhe adhurimin.

Cilit demoni zemërmirë duhet t'ia di për nder që gjendem kështu i rrethuar me mister, me heshtje, me paqe dhe parfume? O lumturi e përsosur! Ajo që ne zakonisht quajmë jetë, edhe në shprehjen e saj më të lumtur s'ka asgjë të përbashkët me këtë jetë kaq të epërme që po njoh tani e që po shijoj minutë pas minute, sekondë pas sekonde!

Jo! S'ka më minuta, s'ka më sekonda! Koha është zhdukur; Përjetësia mbretëron, një përjetësi ëndjesh!

Por një trokitje dere e tmerrshme, e rëndë, oshëtin dhe si në një ëndërr skëterre, më duket sikur marr një goditje kazme mu në lukth.

Dhe atëherë një Fantazmë hyn brenda. Është

një ftues gjyqi që vjen të më torturojë në emër të ligjit; është një dashnore e ndyrë që vjen të ankohet e t'i shtojë banalitetet e jetës së saj dhimbjeve të asaj times; ose shegerti i një drejtori gazete që kërkon vazhdimin e dorëshkrimit.

Dhoma parajsore, idhulli, mbretëresha e ëndrrave, *Silfida* siç thoshte i madhi René[1], e gjithë kjo magji u zhduk nga trokitja e dhunshme e Fantazmës.

O tmerr! Tani më kujtohet! më kujtohet! Po! kjo karakatinë, ky vend ku mbretëron mërzia e përhershme, është tamam i imi. Ja ku janë orenditë budallaqe, të pluhurosura, të ciflosura; vatra pa zjarr e ndotur nga të pështyrat; dritaret e trishtuara mbi pluhurin e të cilave shiu ka lënë vazhda; dorëshkrimet plot zhgarravina ose të papërfunduara; kalendari mbi të cilin lapsi ka shënuar datat ogurzeza!

Dhe ai parfum i tjetërbotshëm që dehte ndjeshmërinë time të rafinuar, medet! është zëvendësuar nga një kundërmim i qelbur duhani, përzier me nuk di çfarë myku të neveritshëm. Tani këtu mund t'i mbash erë thartirës së dëshpërimit.

Në këtë botë të ngushtë, por kaq të pështirë, veç një send i njohur më buzëqesh: shishka e lodanumit[2]; një mikeshë e vjetër dhe e tmerrshme;

1. Imazh i femrës ideale i ëndërruar nga shkrimtari Chateaubriand, autor i librit *René* (1802).

2. Tretësirë alkoolike opiumi të cilën Baudelaire e merrte për të qetësuar dhimbjet fizike që e mundonin.

e si të gjitha mikeshat, mjerisht! bujare në përkëdhelje e tradhëtira.

Oh! Koha u shfaq përsëri; Koha mbretëron e plotfuqishme tashmë; dhe bashkë me plakën e shëmtuar është kthyer e gjithë shpura djallëzore e Kujtimeve, Keqardhjeve, Ngërçeve, Frikëve, Anktheve, Maktheve, Pezmeve dhe Nevrozave.

Ju siguroj që tani sekondat janë janë bërë të forta e solemne, dhe çdonjëra, duke u sulur jashtë lavjerrësit, thotë: — "Unë jam Jeta, e padurueshmja dhe mizorja Jetë!".

Ekziston vetëm një sekondë në jetën njerëzore që ka për mision të japë një lajm të mirë, *lajmin e mirë* që i shkakton gjithkujt një frikë të pashpjegueshme.

Po! Koha mbretëron; ajo e vendosi përsëri tiraninë e saj brutale, ndërsa mua më shtyn përpara si ka, me hostenin e saj të dyfishtë. "Hya! Ec pra, gomar! Djersit pra, skllav! Jeto pra, i mallkuar!"

VI

Secili Kimerën e vet

Nën një qiell të gjerë gri, mbi një fushë të gjerë e me pluhur, pa shtigje, pa lëndina, pa një gjëmbaç, pa një hithër, takova disa njerëz që ecnin të kërrusur.

Secili prej tyre mbartte mbi shpinë një kimerë[1] të madhe, po aq të rëndë sa një thes me miell a me qymyr, apo pajisjet e një ushtari romak.

Por kafsha e përbindshme nuk ishte një peshë pa jetë; përkundrazi, ajo e mbështillte dhe e shtypte njeriun me muskujt e saj të fuqishëm e të zhdërvjelltë dhe mbërthehej me ca kthetra të mëdha mbi gjoksin e mbartësit të vet, ndërsa koka e saj e stërmadhe kapërcente ballin e njeriut dhe dukej si një nga ato helmetat e lemerishme me anë të të cilave luftëtarët

1. Bodleri kombinon përdorimin modern të fjalës, që do të thotë "ëndërr e parealizueshme", dhe kuptimin primitiv: përbindësh i mitologjisë që vjell zjarr, me trup e turi luani dhe bisht dragoi.

e lashtë shpresonin t'ia shtonin tmerrin armikut.

Pyeta njërin prej tyre se ku shkonin ashtu. Ai m'u përgjigj se nuk dinte gjë, as ai, as të tjerët; por me siguri që po shkonin diku, meqenëse një nevojë e pamposhtme i shtynte që të ecnin.

Diçka e çuditshme më ra në sy: asnjëri prej këtyre udhëtarëve nuk dukej të ishte i acaruar kundër bishës së tmerrshme që i varej qafës e i qepej shpinës; thua se e quante si pjesë përbërëse të vetes. Të gjitha ato fytyra të lodhura e serioze nuk tregonin asnjë lloj dëshpërimi; nën kupolën e zymtë qiellore, me këmbë të zhytura në pluhurin e një toke po aq të pikëlluar sa dhe qielli, ata ecnin me pamjen e nënshtruar të atyre që janë të dënuar të shpresojnë pafundësisht.

Procesioni kaloi pranë meje dhe u zhyt në horizont, aty ku sipërfaqja e rrumbullakuar e planetit i përvidhet kureshtjes së vështrimit njerëzor.

Për disa çaste u mundova me ngulm të kuptoja këtë mister; por shumë shpejt e papërballueshmja Mospërfillje më kaplloi dhe unë u ndjeva edhe më i dërrmuar sesa ata vetë nën kimerat e tyre shtypëse[2].

---

2. Jean Prévost, kritik letrar dhe specialist i Baudelaire, shihte në këtë poemë një Kapriçio të Gojës, të titulluar Tu que no puedes, gravurë që tregon njerëz që mbajnë mbi shpinë gjithë mundim gomerë të përbindshëm, të cilët simbolizojnë Spanjën e dërrmuar nën peshën e budallenjve që e drejtonin. "Mendimi i Gojës, shton Prévost, mbetet më prapa se vizionet e tij. Baudelaire, në të kundërt, shkon më tutje. Ai kap në këtë vizatim një të vërtetë njerëzore shumë të rëndësishme: secili prej nesh mbart Kimerën e tij, pa e kuptuar as vetë dhe pa e ditur se ku e shpie ajo."

VII

I çmenduri dhe Venusi

Ç'ditë e mrekullueshme! Parku i madh prehet nën syrin përvëlues të diellit, sikurse rinia nën sundimin e Dashurisë.

Ekstaza e përgjithshme e sendeve nuk shprehet nëpërmjet asnjë zhurme; edhe vetë ujërat janë si të përgjumura. Krejt ndryshe nga festat njerëzore, orgjia këtu është e heshtur...

Duket sikur një dritë, përherë e më e fortë, e bën çdo gjë të vezullojë gjithnjë e më shumë; sikur lulet e harlisura digjen nga dëshira për të rivalizuar me ngjyrat e tyre të ndezura kaltërsinë e qiellit, ndërsa të nxehtët i bën aromat të dukshme dhe i ngjit drejt yllit flakërues në formë shtëllungash tymi.

E megjithatë, në mes të këtij ngazëllimi të përbotshëm, pikasa një qenie të pikëlluar.

Në këmbë të një Venusi madhështor, një nga

ata palaçot[1], ata kllounët vullnetarë që kanë për detyrë të bëjnë të qeshin mbretërit kur ata i pushton Pendimi apo Mërzija, i kullandrepsur me një kostum qesharak gjithë shkëlqim, me brirë e zilka në kokë, i mbledhur kruspullur pas piedestalit, ngre sytë me lot drejt Perëndeshës së pavdekshme.

Dhe sytë e tij thonë: — "Unë jam më i fundmi dhe më i vetmuari i njerëzve, nuk kam as dashuri as miqësi, dhe ndihem ca më poshtë edhe se kafsha më primitive. Por edhe unë jam krijuar për të kuptuar dhe ndjerë Bukurinë e pavdekshme! Ah! Perëndeshë! kini mëshirë për trishtimin dhe jermin tim!".

Por e pamëshirshmja Venus shikon, nuk e di çfarë, diku larg, me sytë e saj të mermertë.

1. Bufon i veshur në mënyrë qesharake (kapele me zilka etj) që mbretërit i mbanin pranë vetes, meqenëse ata thoshin me një ton komik gjëra që të tjerët s'guxonin t'i thonin.

VIII

Qeni dhe shishja

"—Qeni im i bukur, qeni im i mirë, konia ime e dashur, afrohu dhe merri erë një parfumi të mrekullueshëm që e kam blerë te parfumeria më e mirë e qytetit."

Dhe qeni, duke tundur bishtin, shenjë që më duket se përkon me buzëqeshjen te këto qenie të mjera, afron me kureshtje hundën e lagësht te shishja e hapur; pastaj, duke u sprapsur papritur me tmerr, leh kundër meje, në shenjë qortimi.

"—Ah! qen i poshtër, po të të kisha dhuruar ndonjë copë të pëgëre, do ta kishe nuhatur gjithë ëndje, e ndoshta gllabëruar. Pra dhe ti more, mik i padenjë i jetës sime të trishtuar, i ngjan publikut, të cilit kurrë s'i duhen dhënë parfume delikate që e acarojnë por vetëm plehra të zgjedhura me kujdes."

IX

Xhamashitësi i keq

Ka disa njerëz, që nga natyra janë thjesht soditës dhe pa kurrfarë prirje për veprim, por që, nën një shtytje misterioze e të panjohur, gjallërohen disa herë me një shpejtësi që as vetë s'do t'ua kish marrë mendja.

Ata njerëz që, nga frika se mos portieri iu jep ndonjë lajm të hidhur, sillen paburrërisht vërdallë një orë përpara portës pa guxuar të hyjnë brenda; ose ata që mbajnë një letër 15 ditë pa e hapur, apo ata që iu duhen 6 muaj përpara se të bëjnë diçka që duhet ta kishin bërë që prej një viti, këta lloj njerëzish pra, disa herë, krejt papritmas, ndjehen të tërhequr drejt veprimit nga një forcë e papërballueshme, si të ishin shigjeta që lëshohen prej harkut. Moralisti dhe mjeku, që pretendojnë se dinë gjithçka, nuk janë në gjendje të shpjegojnë se nga iu vjen papritur kjo energji kaq e çmendur këtyre

shpirtrave të mefshtë, dhe se si është e mundur që, duke qenë të paaftë të bëjnë edhe punët më të thjeshta e më të nevojshme, iu hipën brenda një çasti guximi i marrë për të kryer vepra nga më absurdet, e madje shpesh nga më të rrezikshmet.

Një miku im, që është ëndërrimtari më i padëmshëm që mund të ekzistojë, i vuri një herë zjarrin një pylli, sa për të parë, siç thoshte ai, nëse zjarri do të merrte aq lehtë sa ç'thuhej zakonisht. Dhjetë herë rresht eksperienca dështoi; por të njëmbëdhjetën ajo doli me sukses të plotë.

Një tjetri i pëlqen të ndezë një cigare pranë një fuçie baruti, *për të parë, për të ditur, për të provuar fatin,* për ta detyruar veten të tregohet energjik, për të imituar bixhozçiun, për të njohur kënaqësinë e ankthit, pa ndonjë shkak, për trill, ngaqë s'di ç'të bëjë.

Është një lloj gjallërie që buron nga mërzia dhe ëndërrimet dhe që shfaqet tek qeniet më të plogëta e më të prirura ndaj ëndrrave.

Një tjetër, i druajtur gjer në atë shkallë saqë ul sytë edhe kur takon vështrimin e njerëzve, ose që i duhet të mbledhë të gjithë vullnetin e tij të mjerë për të hyrë në një kafe apo për të kaluar përpara një biletarie teatri, kontrollorët e së cilës i duken të mveshur me madhështinë e Minosit, Eakusit dhe Radamantit[1], i teket befas t'i hidhet në qafë ndonjë plaku që i kalon pranë e ta puthë

1. Gjyqtarët e botës së përtejme.

gjithë ngazëllim, në sy të turmës së habitur.

Përse? Sepse... sepse ndjeu një simpati të papërmbajtshme për atë fytyrë? Ndoshta; por do të ishte më e përligjur të mendoje që as ai vetë s'e di se pse.

Unë vetë kam qenë më shpesh se një herë viktimë e këtyre krizave që na bëjnë të besojmë se Djalli i lig futet tinëz në shpirtin tonë e na detyron që, pa e kuptuar as vetë, t'iu bindemi vullneteve të tij më absurde.

Një mëngjes isha ngritur i ngrysur, i trishtuar, i lodhur nga të ndenjurit duarkryq, dhe ndieja një shtytje, kështu më dukej, për të kryer një vepër të madhërishme, një heroizëm; dhe mjerisht! hapa dritaren.

(Vini re ju lutem, qe shpirti i mistifikimit, i cili te disa nuk vjen si rrjedhim i ndonjë pune apo planifikimi por buron nga një frymëzim i rastit, luan një rol të rëndësishëm, qoftë edhe për nga afshi i dëshirës, në këtë lloj gjendjeje, histerike sipas mjekëve, satanike sipas atyre që janë pak më të mençur se mjekët, që na shtyn në mënyrë të papërballueshme drejt një morie veprimesh të rrezikshme a të pahijshme).

Njeriu i parë që më zunë sytë në rrugë ishte një xhamashitës, sokëllima e mprehtë dhe çjerrëse e të cilit u ngjit deri tek unë nëpërmjet ajrit të rëndë e të ndotur parizian. E kam të pamundur të shpjegoj se pse më zuri ndaj atij të varfrit një urrejtje sa e beftë. aq edhe despotike.

"—Hej! Ti!" Dhe i thirra të ngjitej lart. Ndërkohë mendoja, jo pa njëfarë kënaqësie, se me që dhoma ndodhej në kat të gjashtë dhe shkalla ishte fare e ngushtë, ai do ta kishte të vështirë të ngjitej dhe cepat e mallit të tij të brishtë do të ngeceshin gjithandej.

Më në fund ai u shfaq: unë shqyrtova me kureshtje të gjithë xhamat e tij, dhe i thashë: "Si! Nuk paskeni xhama me ngjyra! Xhama rozë, të kuq, blu, xhama magjikë, xhama parajse? Sa i pacipë që qenkeni! Guxoni të shëtisni nëpër lagjet e varfra dhe nuk keni as xhama dritaresh me ngjyra që të bëjnë ta shohësh jetën të bukur!" Dhe e shtyva me forcë drejt shkallëve ku ai u pengua duke hungëruar nëpër dhëmbë.

Iu afrova ballkonit, kapa një vazo lulesh, dhe kur njeriu u rishfaq poshtë te porta, e lëshova predhën time luftarake pingul mbi pakon e tij; dhe ai, duke u rrëzuar mbi shpinë nga goditja, e theu nën vete të gjithë pasurinë e tij të mjerë e endacake, gjë që u shoqërua me zhurmën buçitëse të një pallati kristali që shembet nga rrufeja.

Ndërsa unë, i dehur nga çmenduria, i ulërija me tërbim: "Për ta parë jetën të bukur! jetën të bukur!".

Këto shakara nervoze nuk janë pa rrezik dhe shpesh mund t'i paguash shtrenjtë. Po ç'rëndësi ka përjetësia e mallkimit për atë që ka gjetur gjatë një çasti një kënaqësi të pafundme?

X

Në orën një të mëngjesit

Më në fund! vetëm! S'dëgjohet gjë tjetër përveç zhurmës së rrotave të ndonjë karroce të vonuar e të rraskapitur. Për disa orë do të kem heshtjen, ndoshta dhe çlodhjen. Më në fund! tirania e fytyrës njerëzore[1] është zhdukur dhe vuajtja do të më vijë vetëm prej vetvetes.

Më në fund! Mund të prehem në një banjë errësire! Më parë, do kyç mirë portën. Kam përshtypjen se kjo kyçje do ta thellojë vetminë time dhe do të përforcojë barrikadat që më ndajnë tashmë nga bota.

Jetë e ndyrë! Qytet i ndyrë! Le të përmbledhim

1. Shprehje që Baudelaire ia huazon Thomas de Quincey, dhe të cilën e ka përkthyer në Parajsat artificiale. Nën një formë paksa të ndryshme, Baudelaire e citon në një letër (10 gusht 1862) dërguar së ëmës, duke kujtuar se do ta takonte së shpejti në Honfleur (fshat pranë Normandisë): "Më në fund! Më në fund! Mendoj se në fund të muajit do të mund t"i shpëtoj tmerrit të fytyrës njerëzore. As mund ta përfytyrosh se deri në ç'pikë është e degjeneruar raca pariziane".

ngjarjet e ditës së sotme: takova plot njerëz të letrave, njëri prej të cilëve më pyeti nëse mund të shkohej në Rusi me rrugë tokësore (me siguri që e merrte Rusinë për ndonjë ishull); u zura paq me një drejtor reviste i cili çdo kundërshtimi i përgjigjej me fjalët: "—Këtu keni të bëni me njerëz të ndershëm," gjë që linte të kuptohej se të gjitha gazetat e tjera drejtoheshin nga batakçinj; përshëndeta nja njëzet njerëz, pesëmbëdhjetë prej të cilëve nuk i njoh; shtrëngova duar në të njëjtat përpjestime dhe kjo, pa marrë më parë masat për të blerë një palë doreza; u ngjita për të shtyrë kohën, gjatë një shtrëngate, tek një kërcimtare që m'u lut t'i vizatoja një kostum *Venustre*[2]; i bëra lajka një drejtori teatri që më tha duke më përcjellë: "— Do të bënit mirë t'i drejtoheshit Z...; është më i trashi, më budallai dhe më i njohuri nga të gjithë autorët e mi, dhe me të mund të arrini, ndoshta, të bëni diçka. Takojeni një herë e pastaj shohim e bëjmë"; u mburra (përse vallë?) për gjithë ato ligësira që s'i kam bërë kurrë, dhe paturpësisht mohova të tjera poshtërsira që i kisha kryer tërë kënaqësi, mëkat mburrjeje, krim kundër respektit njerëzor[3]; i refuzova një miku një shërbim të thjeshtë dhe i dhashë një letër mirëbesimi një tuhafi të vërtetë; uf! mbaroi më në fund?

I pakënaqur me të tërë dhe i pakënaqur me

---

2. Do, sigurisht, të thotë Venusi.

3. Shprehje e vjetër e moralistëve fetarë, e marrë nga latinishtja; fjalë për fjalë: "marrja parasysh e gjykimit të të tjerëve ndaj vetes".

veten, do të doja të përmirësohesha e të krenohesha ndopak në qetësinë dhe vetminë e natës. Shpirtra të atyre që kam dashur, shpirtra të atyre që kam kënduar, jepmëni forcë, ndihmomëni, largomëni nga gënjeshtra dhe avujt zvetënues të botës, dhe ju, o Zoti im! falmëni bekimin tuaj që të mund të krijoj disa vargje të bukura dhe t'i provoj vetes që s'jam një fundërrinë, që s'jam më i ulët se ata që përbuz!

XI

Gruaja e egër dhe dashnorja nazemadhe

"Me të vërtet e dashur që po më lodhni pa masë e pa mëshirë; po t'ju dëgjonte njeri se si psherëtini, do t'i dukej se po vuani më shumë se lypset 60 vjeçare të qymyrit apo plakat që mbledhin kore buke te porta e kabareve.

"Sikur psherëtimat tuaja të shprehnin pendim, të paktën kjo do t'ju nderonte disi; por ato nuk pasqyrojnë gjë tjetër veç nginjës nga mirëqënia dhe rraskapitjes prej të ndenjurit kot. Pastaj, ju nuk pushoni së nxjerri nga goja fjalë të kota: "Duamëni fort! kam kaq shumë nevojë për këtë gjë! Ngushëllomëni këndej, përkëdhelmëni andej!" Dëgjoni, unë do të përpiqem që t'ju shëroj; ndoshta do ta gjejmë mënyrën, duke shpenzuar vetëm disa qindarka, mu në mes të një feste, pa qenë nevoja të shkojmë shumë larg.

"Shikojeni mirë, ju lutem, këtë kafaz të fortë

prej hekuri brenda të cilit sillet poshtë e lart, duke ulëritur si një shpirt i mallkuar, duke shkundur hekurat si një orangutang i dëshpëruar nga mërgimi, duke imituar me përsosmëri herë kërcimet qarkore të tigrit, herë kapardisjet e pakuptimta të ariut polar, ky përbindësh leshtor, trajtat e të cilit iu shëmbëllejnë turbull atyre tuajave.

"Ky përbindësh është një nga ato kafshë, të cilave iu thërritet zakonisht "ëngjëlli im!", domethënë një grua[1]. Përbindëshi tjetër, ai që çirret me sa i ha gurmazi dhe që ka një shkop në dorë, është i shoqi. E ka lidhur gruan e tij të ligjshme si të ishte një bishë e egër dhe e tregon nëpër lagje ditëve të panairit, me lejen e zyrtarëve, kuptohet vetvetiu.

"Vëzhgojeni me kujdes! Shikoni se me ç'babëzi (ndoshta të sinqertë) ajo shqyen lepujt e gjallë dhe shpendët pingërues që i hedh i zoti. "Hajde, mjaft tani, i thotë ai, s'mund të gllabërosh gjithë ç'ke brenda një dite," dhe, ndërsa shqipton këto fjalë të urta, ia shkul nga goja mizorisht prenë, zorrët e shpështjella të së cilës qëndrojnë për një grimë të varura në dhëmbët e kafshës së egër, e gruas, desha të them.

"Hajt t'i japim një goditje të mirë me shkop për ta qetësuar, sepse ajo i ka ngulur ca sy të tmerrshëm lakmie ushqimit që ia hoqën nga goja. O Zot i madh! shkopi s'është nga ata që përdoren nëpër teatro. A e dëgjuat se si kërciti mbi mish, megjithë qimet e

1. Në shekullin e XIX-të, gruaja e egër ishte një argëtim i shpeshtë nëpër panaire.

rreme? Tani asaj i dalin sytë vendit dhe ulërin *më natyrshëm.* Në tërbim e sipër ajo lëshon shkëndija, si hekuri që rrihet.

"Të tillë janë zakonet bashkëshortore të këtyre dy pasardhësve të Evës dhe Adamit, të këtyre dy krijesave të duarve tuaja, o Zoti ynë! Kjo grua është pa dyshim fatkeqe, ndonëse, në fund të fundit, kënaqësirat gudulisëse të lavdisë nuk i janë ndoshta të panjohura. Ka fatkeqësi më të pandreqshme se kjo dhe që s'i shpërblen kush. Por në atë botë ku e kanë hedhur, ajo s'ka menduar kurrë që gruaja mund të meritonte një tjetër fat.

"Dhe tani le të kthehemi tek ne të dy, e dashur precioze[2]! Kur shikon skëterrat që ka në këtë botë, e ç'mund të mendoj për ferrin tuaj të mrekullueshëm, ku ju flini veçse ndër çarçafë po aq të butë sa lëkura juaj dhe hani veçse mish të pjekur, të cilin një shërbëtor i shkathët kujdeset që t'jua bëj gati?

"E ç'kuptim mund të kenë për mua gjithë këto psherëtima të vogla që gufojnë gjoksin tuaj të parfumuar, nazemadhja ime e bëshme? Dhe gjithë këto të shtirura që i keni mësuar nëpër libra, dhe gjithë kjo melankoli e vazhdueshme që i ngjall tjetrit një ndjenjë krejt të ndryshme nga mëshira? Në të vërtetë, ndonjëherë më kap dëshira që t'ju mësoj se ç'është fatkeqësia e vërtetë.

"Duke ju parë kështu, bukuroshja ime buzë-

2. Fjala precioze ka këtu dy kuptime: do të thotë e shtrenjtë, por gjithashtu e shtirur, gjithë poza e sjellje artificiale.

hollë, me këmbët në baltë dhe sytë e mjegulluar të kthyer drejt qiellit si në pritje të një mbreti, më dukeni vërtet si një zhabë që i përgjërohet idealit. Nëse do ta përbuzni trarin e shpëtimit[3] (që, siç e dini mirë, tani jam unë), kini kujdes nga vinçi që *do t'ju zerë, do t'ju gllabërojë dhe do t'ju vrasë për qejf të tij*[4]!

"Sado poet të jem, nuk jam aq sylesh sa ç'më kujtoni, dhe ndonjë ditë, nëse më lodhni ca si shumë me ato qaravitjet tuaja *precioze,* do t'ju trajtoj si një *grua të egër*, ose do t'ju hedh nga dritarja, si një shishe të zbrazët."

3. Trarin e shpëtimit: aluzion për fabulën e La Fontaine "Bretkocat që kërkuan një mbret", *Fabula*, III, 4.

4. Do t'ju zerë, do t'ju gllabërojë dhe do t'ju vrasë për qejf të saj: këtu Baudelaire i referohet të njëjtës fabul, duke ndryshuar paksa formulimin.

XII

Turmat

Jo gjithkush është i aftë të zhytet në turmë; të ndjesh kënaqësi nga kjo gjë është art më vete; dhe vetëm ai të cilit fatat i kanë dhuruar që në djep prirjen për t'u maskuar, urrejtjen për jetën shtëpiake dhe pasionin për udhëtime, mund të tallet paq dhe të bëj qejf me gjininë njerëzore.

Turmë, vetmi; fjalë të njëjta e të këmbyeshme nga poeti aktiv e pjellor. Ai që nuk di të popullojë vetminë e vet, nuk di as të ndjehet i vetmuar në mes të një turme të trazuar.

Poeti gëzon atë privilegj të pakrahasueshëm që i jep mundësinë të jetë, sipas qejfit, ai vetë dhe dikush tjetër. Si ata shpirtrat endacakë në kërkim të një trupi, ai hyn kur t'i teket në personazhin e çdokujt. Veç për të, çdo vend është i lirë; dhe në qoftë se disa vise duken të mbyllura, kjo vjen ngaqë në sytë e tij ato s'ia vlejnë mundimin të vizitohen.

Shëtitësi i vetmuar e mendimtar shijon një dehje të veçantë nga kjo vëllazëri e përgjithshme. Ai që shkrihet lehtë në turmë, provon disa kënaqësira të ethshme të cilat s'mund t'i njohë kurrë egoisti, i mbyllur si në kuvli, dhe përtaci, i mbledhur si një molusk. Ai i bën të tijat të gjitha profesionet, të gjitha gëzimet e të gjitha vuajtjet që i sjell rasti.

Ajo që njerëzit quajnë dashuri është tepër e vogël, tepër e kufizuar e tepër e dobët në krahasim me këtë orgji të parrëfyeshme, me këtë prostitucion të shenjtë të shpirtit që i jepet i tëri, gjithë poezi e përdëllim, të papriturës që shfaqet, të panjohurit që kalon rastësisht.

Është mirë, herë pas here, t'u tregosh njerëzve të lumtur të kësaj bote, qoftë edhe sa për t'i ulur hundën për një çast mendjemadhësisë së tyre idiote, që ka lumturi më të mëdha e më të rafinuara se ato të tyret. Themeluesit e kolonive, pastorët e popujve, priftërinjtë misionarë të mërguar në fund të botës, njohin me siguri diçka nga këto dehje misterioze; dhe në gjirin e familjes së gjerë që gjenia e tyre ka krijuar, ata duhet të qeshin herë pas here me njerëzit që ua qajnë hallin për fatin e tyre aq të trazuar e jetën e tyre aq të virgjër.

XIII

Vejushat

Vauvenargues[1] thotë se në kopshtet publike ka rrugina ku enden e gëlojnë ambicjet e zhgënjyera, shpikësit pa fat, lavditë e dështuara, zemrat e thyera, të gjithë ata shpirtra të trazuar e të ndrydhur në të cilët gumëzhijnë ende psherëtimat e fundit të një stuhije, dhe që duan t'i fshihen vështrimit të pacipë të njerëzve gazmorë e të ngeshëm. Këto streha të errëta janë vendtakimet e atyre që jeta i ka gjymtuar.

Hamendjet lakmitare të poetit dhe filozofit tërhiqen në radhë të parë prej vendeve të tilla. Aty janë të sigurt se do gjejnë ushqim për mendimet e tyre. Sepse nëse ka diçka që iu zgjon përbuzje, siç e lashë të kuptohet më lart, kjo është mbi të gjitha gëzimi i të pasurve. Ai trazim në zbrazëti s'ka asgjë

1. Luc de Clapiers, Marquis de Vauvenargues (1715-1749), moralist francez. Baudelaire i referohet një fraze të tij në librin *Refleksione mbi subjekete te ndryshme.*

që t'i joshë. Përkundrazi, ata tërhiqen në mënyrë të papërmbajtshme nga çdo gjë që është e dobët, e rrënuar, e pikëlluar, jetime.

Një sy i stërvitur nuk gabohet kurrë në të tilla gjëra. Në këto tipare të ngrira apo të dërrmuara, në këta sy të zgropët e të shuar, ose të ndezur nga shkëlqimet e fundit të një mundimi, në këto rrudha të thella e të shumta, në këto ecje të ngadalta e të prera, ai zbulon menjëherë legjendat e panumërta të dashurisë së tradhtuar, të përkushtimit të pabegenisur, të përpjekjeve të pashpërblyera, të urisë e të të ftohtit të duruar përulësisht e në heshtje.

A ju ka rastisur të shihni ndonjëherë vejusha të ulura në këto stola të vetmuar, vejusha mjerane? Është e lehtë t'i njohësh, edhe kur nuk janë në të zeza. Në zinë e të varfrit ka gjithnjë diçka që mungon, një mungesë harmonie që e bën të duket edhe më pikëlluese. Ai është i detyruar të jetë dorështrënguar edhe me dhimbjen. Ndërsa zisë së të pasurit nuk i mungon asgjë.

Cila është vejusha më e trishtuar dhe më dëshpëruese, ajo që tërheq për dore një fëmijë, me të cilin s'mund t'i ndajë ëndrrat, apo ajo që është krejt e vetmuar? Nuk e di... Më ka rastisur një herë të ndiqja për orë të tëra një plakë të dëshpëruar kësisoj; e ngrirë, e drejtë, e mbështjellë me një shall të vogël e të vjetëruar, ajo mbante në qenien e saj një krenari stoike.

Dukej që vetmia e plotë e kishte dënuar të merrte zakonet e një beqareje plakë, rreptësisë së të cilave

iu shtohej një notë misteri nga karakteri mashkullor i sjelljes së saj. Nuk më kujtohet në ç'kafene të mjerë shkoi dhe as se ç'hëngri për drekë. E ndoqa më pas në një sallë biblioteke dhe e vështrova me kujdes për një kohë të gjatë, ndërsa ajo kërkonte në gazeta, me sy depërtues, dikur të djegur nga lotët, lajmet që i interesonin më shumë.

Më në fund, pasdite, nën një qiell të bukur vjeshte, një nga ata qiejtë prej të cilëve bien shtëllunga keqardhjesh dhe kujtimesh të panumërta, ajo u ul në një park për të dëgjuar, larg turmës, një nga ata koncerte, muzika ushtarake e të cilëve i grish parizianët.

Kjo ishte, pa dyshim, shthurrja e vetme e kësaj plake të pafajshme (ose kësaj plake të dëlirë), ngushëllimi i fituar me djersë prej njërës nga ato ditë të rënda pa miq, pa kuvendim, pa një çast gëzimi, pa kurrkënd për t'i hapur zemrën, që Zoti lëshonte mbi të, prej vitesh ndoshta!, treqind e gjashtëdhjetë e pesë herë në vit.

Ja edhe një tjetër:

Kurrë nuk e përmbaj dot veten së hedhuri një vështrim në mos simpatik, të paktën kureshtar, mbi turmën e leckamanëve që shtyhen te hyrja e një koncerti publik. Orkestra e mbush natën me melodi feste, triumfi ose ëndjesh. Fustanet rrëshqasin duke vezulluar; vështrimet takohen; të ngeshmit, të lodhur nga të ndenjurit duarkryq, tunden sa andej këndej duke u hequr se shijojnë përtueshëm muzikën. Këtu ka vetëm pasanikë të lumtur;

gjithçka rrezaton ose të frymëzon moskokëçarjen dhe kënaqësinë e të jetuarit pa e vrarë mendjen; gjithçka, përveç pamjes së atij llumi që mbështetet atje larg te parmaku i jashtëm, duke rrokur falas, sipas tekave të erës, grimca muzike dhe duke ndjekur me sy zjarrminë e shndritshme që lëviz brenda.

Është tepër interesante të vëzhgosh pasqyrimin e gëzimit të të pasurve në sytë e të varfërve. Por atë ditë, në mes të asaj turme të veshur varfërisht, më zunë sytë një qenie, fisnikëria e së cilës bënte një kontrast marramendës me banalitetin që e rrethonte.

Ishte një grua e gjatë, e madhërishme, dhe me një pamje aq fisnike, sa s'më kujtohet të kem parë diçka të ngjashme as edhe në koleksionet e bukurive aristokratike të së kaluarës. Një parfum virtyti kryelart buronte nga e gjithë qenia e saj. Fytyra, e trishtuar dhe e hequr, ishte në harmoni të përsosur me zinë e plotë që mbante. Edhe ajo, ashtu si turma me të cilën ishte përzier dhe që ajo as e vështronte, i hidhte asaj bote gjithë shkëlqim një vështrim të thellë, dhe dëgjonte duke tundur lehtas kokën.

Pamje e çuditshme! "Nuk është e mundur, thashë me vete, që varfëria e saj, nëse është vërtet varfëri, ta pranojë kursimin e ndyrë; fytyra e saj aq fisnike më siguron për këtë gjë. Pse pra qëndron me vetëdije në një mjedis krejt të huaj për të?".

Por, tek kaloja gjithë kureshtje pranë saj, mendoj se e kuptova arsyen. Vejusha e gjatë mbante për dore një fëmijë, të veshur si ajo në të zeza; sado i

ulët të ishte çmimi i hyrjes, ai çmim mjaftonte ndoshta për të paguar ndonjë nga nevojat e qenies së vogël, ose më saktë, ndonjë tekë, a ndonjë lodër.

Dhe ajo ka për t'u kthyer në këmbë, duke menduar e duke ëndërruar, e vetmuar, gjithnjë e vetmuar; sepse fëmija është i zhurmshëm, egoist, dhe s'ka as ëmbëlsi as durim; ai nuk është në gjendje as që, njëlloj si kafsha, si qeni apo macja, të bëhet konfidenti i vuajtjeve të vetmisë.

XIV

Akrobati i vjetër

Kudo, turma në pushime shpërndahej, hallakatej, dëfrente. Ishte një nga ato festa tek të cilat akrobatët, xhonglerët, kafshëzbutësit dhe shitësit ambulantë kishin vënë prej kohësh të gjitha shpresat, për të mbuluar humbjet që kishin sjellë periudhat e zbrazëta të vitit.

Në ditë të tilla më duket sikur njerëzit harrojnë gjithçka, dhimbjen dhe punën, dhe bëhen njëlloj si fëmijët. Për të vegjlit është një ditë pushimi, me fjalë të tjera, një shtyrje e tmerrit të shkollës për 24 orë. Për të mëdhenjtë është një armëpushim i nënshkruar me forcat dashakeqëse të jetës, një pezullim në betejën e përgjithshme.

Madje edhe mondanët ose ata që merren me punëra shpirtërore nuk i shpëtojnë dot lehtë ngazëllimit popullor. Pa dashur, ata thëthijnë pjesën që iu takon të kësaj atmosfere moskokëçarjeje. Dhe

unë, si parizian i vërtetë, nuk e lë të më iki rasti pa vizituar të gjitha barakat që kapardisen në këtë periudhë feste.

Kishte, në të vërtetë, një garë të hatashme ndërmjet tyre: ato pingëronin, pallnin, ulërinin. Ishte një përzierje klithmash, gjëmimesh bakri dhe shpërthimesh fishekzjarri. Akrobatët dhe kllounët shtrembëronin tiparet e tyre zeshkane, të rreshkura nga era, shiu dhe dielli; me guximin e aktorëve të sigurt në zotësinë e tyre, ata hidhnin e pritnin vërejtje të holla dhe thumba me një humor po aq të fortë dhe të rëndë sa ai i Molierit. Herkulët, krenarë për gjymtyrët e tyre të stërmëdha, pa ballë e pa kafkë si orangutangët, preheshin madhërishëm të veshur me kanatiere që i kishin larë një ditë më parë posaçërisht për këtë ditë. Kërcimtaret, të bukura si shtojzovalle ose si princesha, hidheshin e bënin kollotumba nën zjarrin e fenerëve që ua mbushnin fundet me shkëndija.

Gjithçka ishte veçse dritë, pluhur, klithma, gëzim, rrëmujë; disa prishnin para, të tjerët i fitonin, dhe si të parët dhe të dytët ishin njësoj të kënaqur. Fëmijët i tërhiqnin nënat nga fustani duke u lutur për kallamsheqera, ose kacavireshin mbi supet e etërve për të parë më mirë ndonjë magjistar mahnitës si një hyjni. Dhe gjithandej ndihej, më e fuqishme se të gjithë parfumet, një kundërmim skuqurinash që ishte si thimjani i kësaj feste.

Në fund fare të rreshtit të barakave, si të ishte mënjanuar vetë plot turp nga gjithë ato llamburitje,

më zunë sytë një akrobat të mjerë, të kërrusur, plak, të drobitur, një gërmadhë njerëzore, të mbështetur pas njërës prej shtyllave të kasolles së tij; një kasolle më e mjeruar se ajo e njeriut të egër më të zvetënuar; kasolle në të cilën dy mbeturina qirinjsh, që kullonin e lëshonin tym, ndriçonin tepër shkoqur skamjen.

Gjithandej gëzim, fitim, shthurrje; gjithandej siguria e bukës për të nesërmen; gjithandej shpërthimi i harbuar i gjallërisë. Këtu mjerim i plotë, mjerim i spitulluar (kulmi i tmerrit!) me lecka komike, ku kontrasti vinte nga nevoja më tepër se nga arti. Ai i mjeri nuk qeshte! As nuk qante, as nuk vallzonte, as nuk lëvizte, as nuk këlthiste; nuk këndonte asnjë këngë, as të gëzuar, as të vajtueshme, nuk lypte. Rrinte i heshtur dhe i ngrirë. Kishte hequr dorë, e kish lëshuar veten. Fati i tij ish vendosur tashmë.

Por çfarë vështrimi të thellë, të paharrueshëm që i hidhte turmës dhe dritave, vala lodërtare e të cilave ndalonte disa hapa larg skamjes së tij të neveritshme! Ndjeva të më shtrëngonte fytin dora e tmerrshme e histerisë, dhe m'u duk se vështrimi më ish mjegulluar nga lot rebelë që s'donin të derdheshin.

Ç'mund të bëja? A ia vlente ta pyesja fatkeqin se ç'kureshti, ç'mrekulli kishte për të treguar në atë errësirë kutërbuese, prapa asaj perdeje copë-copë? Në të vërtetë, nuk guxova; dhe ndonëse arsyeja e druajtjes sime mund t'ju bëj të qeshni,

duhet ta pohoj që kisha frikë se mos e poshtëroja. Më në fund, mora guximin dhe vendosa t'i lija në kalim e sipër ca para, me shpresë se ai do ta merrte me mend qëllimin tim, kur një dallgë e fuqishme njerëzore, e shkaktuar nga nuk e di çfarë turbullire, më mori me vete larg tij.

Duke kthyer kokën, me mendjen tek ajo pamje, kërkova të hetoja dhimbjen time të papritur, dhe thashë me vete: sapo pashë imazhin e njeriut plak të letrave, atij që i ka mbijetuar brezit të cilin e kish dëfryer aq shkëlqyeshëm; imazhin e poetit plak pa miq, pa familje, pa fëmijë, të poshtëruar nga varfëria dhe mosmirënjohja e publikut, në kasollen e të cilit njerëzit pa kujtesë nuk duan më të hyjnë.

XV

Embëlsira

Isha në udhëtim. Peizazhi, në mes të të cilit po qëndroja, kishte një madhështi dhe një fisnikëri të pakrahasueshme. Në atë çast, diçka ndodhi me sa duket në shpirtin tim. Mendimet më fluturonin me lehtësinë e ajrit; pasionet e rëndomta, si urrejtja apo dashuria profane, më dukeshin tashmë po aq të largëta sa retë që rrëshqisnin njëra pas tjetrës në fundin e humnerave, nën këmbët e mia; shpirti më dukej po aq i gjerë dhe i dëlirë sa kupola qiellore që më mbështillte; kujtimi i gjërave tokësore arrinte në zemrën time i zbehur dhe i mehur, si tingëllima e zilkave të bagëtive të padukshme që kalonin atje larg, shumë larg, mbi shpatin e një mali tjetër. Mbi liqenin e vogël dhe të palëvizshëm, që dukej i zi nga thellësia e tij e pamasë, kalonte herë pas here hija e ndonjë reje, si pasqyrimi i pelerinës së një gjigandi me flatra që fluturonte nëpër qiell. Dhe

më kujtohet që kjo ndjesi solemne dhe e rrallë, e shkaktuar nga një lëvizje e gjerë dhe përsosmërisht e heshtur, më mbushte me një gëzim të përzier me frikë. Me një fjalë, në sajë të bukurisë frymëzuese që më rrethonte, ndihesha në një paqe të përsosur me vetveten dhe gjithësinë; madje më dukej se në mes të lumturisë dhe harresës së plotë të së keqes tokësore, arrita gjer aty sa të mos më dukeshin më aq qesharake gazetat që pretendonin se njeriu lind i mirë; kur lënda e pashërueshme i përtëriti kërkesat e saj, mendova të riparoja lodhjen dhe të lehtësoja urinë e shkaktuar nga një ngjitje aq e mundimshme. Nxora nga xhepi një copë të madhe buke, një tas lëkure dhe një shishkëz me një lloj eliksiri që farmacistët u shisnin në atë kohë turistëve, dhe që mund të përzihej, po të ish nevoja, me ujin e dëborës.

Isha duke prerë qetësisht bukën, kur një zhurmë fare e lehtë më bëri të ngre sytë. Përpara meje qëndronte një qenie e vogël rreckamane, zeshkane, me flokë të shprishur; sytë e saj të futur, të egër dhe lutës përpinin copën e bukës. Dhe e dëgjova të pëshpëriste me një zë të ulët dhe të ngjirur fjalën: *ëmbëlsirë!* Nuk e mbajta dot të qeshurën tek dëgjova emrin me të cilin qenia donte të nderonte bukën time gati të bardhë dhe preva për të një goxha copë, të cilën ia ofrova. Ajo u afrua ngadalë, pa ia larguar sytë objektit të lakmisë së saj; pastaj, pasi e rrëmbeu bukën me nxitim, u zmbraps me shpejtësi, si të kish frikë se mos

dhurata ime nuk ishte e sinqertë dhe unë pendohesha.

Por, po në atë çast, ajo u përmbys përtokë nga një tjetër egërsirë e vogël, e dalë nga nuk e di se ku dhe aq e ngjashme me të parën, sa që mund t'i merrje për binjakë. U rrokullisën bashkë përtokë, duke u përleshur për prenë e çmuar, sepse asnjëri nuk donte të flijonte gjysmën për të vëllanë binjak. I pari, në kulmin e tërbimit, e kapi të dytin prej flokësh; ky i fundit i kafshoi veshin dhe pështyu një copë të vogël të përgjakur, të shoqëruar me një sharje të fortë. Pronari legjitim i ëmbëlsirës u përpoq t'i ngulte kthetrat e tij të vogla në sytë e uzurpatorit; nga ana e tij, ky u përpoq me të gjitha forcat t'i zinte frymën kundërshtarit me njërën dorë, ndërkohë që me tjetrën mundohej të fuste në xhep shkakun e përleshjes. Por, i ringjallur nga dëshpërimi, i munduri e mori përsëri veten dhe e rrëzoi fitimtarin përdhe me një goditje koke në stomak. A ia vlen të përshkruaj një përleshje fort të shëmtuar që zgjati shumë më tepër sesa mund të përfytyrohej, po të gjykoje nga shtati dhe forcat e tyre fëminore? Ëmbëlsira kalonte nga dora në dorë, dhe ndërronte xhep çdo çast; por mjerisht, ajo ndërronte edhe volumin; dhe kur më në fund, të dërrmuar, gulçues, të përgjakur, ata reshtën se s'kishin më fuqi të vazhdonin, me thënë të drejtën nuk kishte më shkak beteje; copa e bukës ishte zhdukur dhe ishte shpërndarë në thërrime të ngjashme me kokrrizat e rërës me të cilat ishte përzier.

Ai spektakël e kishte zymtuar peizazhin, dhe gëzimi i qetë në të cilin qe përhumbur shpirti im përpara se të shihte ata njerëz të vegjël, ishte zhdukur krejt; ndenja i trishtuar për një kohë mjaft të gjatë, duke i përsëritur vetes: "Paska pra në këtë botë një vend të mrekullueshëm ku bukës i thërrasin *ëmbëlsirë*, ushqim aq i rrallë sa që është në gjendje të shkaktojë një luftë të vërtetë vëllavrasëse!".

XVI

Ora

Kinezët e shohin orën në sytë e maceve.

Një ditë, një misioner që shëtiste në rrethinat e Nankinit, pa se kishte harruar orën e dorës dhe pyeti një çunak se ç'kohë ishte.

Çunaku i Perandorisë qiellore ngurroi në fillim ; pastaj, pasi u mendua, u përgjigj: "Tani jua them." Disa çaste më pas, ai u rishfaq me një goxha maçok të madh në krahë, dhe pasi e pa, si i thonë, në dritë të syrit, tha pa ngurruar: "Ende s'ka vajtur ora 12." Gjë që ishte e vërtetë.

Ndërsa unë për veten time, kur përkulem drejt Felines së bukur, me atë emër që i përshtatet aq mirë dhe, që është njëherazi nderi i seksit të saj, krenaria e zemrës dhe parfumi i mendjes sime, qoftë natën, qoftë ditën, në dritë të diellit apo në errësirën opake, në sytë e saj të adhurueshëm gjithnjë e shoh fare qartë orën, përherë të njëjtën, një orë

madhështore, solemne, të gjerë si hapësira, të pandarë në minuta dhe sekonda, — një orë të pandryshueshme që nuk e tregojnë sahatet, e megjithatë të lehtë si një psherëtimë, të shpejtë si një vështrim.

Dhe në qoftë se ndonjë njeri i padëshirueshëm do të vinte të më shqetësonte ndërsa vështrimi im prehet mbi këtë fushëzë të mrekullueshme, në qoftë se ndonjë Gjeni i pandershëm dhe nursëz, ndonjë Demon i prapësisë, do vinte të më thoshte: "Çfarë vështron ashtu me aq kujdes? Çfarë kërkon në sytë e asaj qenieje? A sheh orën në ta, o bjerakohës i vdekshëm e shkapërdarë?" do t'i përgjigjesha pa ngurruar: "Po, shoh orën vërtet; dhe në më pyetsh ç'kohë është, unë të përgjigjem: është Përjetësi!"

A nuk është kjo vjershë e vogël, zonjë, vërtet e lavdërueshme dhe po aq emfatike sa dhe ju vetë? Në të vërtetë, kaq shumë u kënaqa duke qëndisur këtë galanteri të stërfryrë, saqë s'do t'ju kërkoj asgjë në këmbim.

XVII

Një hemisferë në një floknajë

Lërmë të thith gjatë, shumë gjatë, erën e flokëve të tu, të kredh fytyrën në to si një i etur që kridhet në ujin e burimit dhe t'i trazoj me dorë si të ishin një shami e parfumuar, për të shkundur kujtime nëpër ajër.

Sikur ti dije të gjitha ato që shoh! të gjitha ato që ndiej! të gjitha ato që dëgjoj në flokët e tu! Shpirti im fluturon mbi parfum si shpirti i të tjerëve mbi muzikë.

Flokët e tu mbajnë një ëndërr plot vela e direkë; ata mbajnë detra të gjerë, musonet e të cilëve më shpien drejt klimave të mrekullueshme ku hapësira është më blu e më e thellë, dhe ku ajri është i parfumuar nga frutat, gjethet dhe lëkura njerëzore.

Në oqeanin e floknajës tënde, shikoj një port që gëlon nga këngët melankolike, burrat e fuqishëm të të gjitha kombeve dhe anijet me trajta nga më të

ndryshmet, spikamat delikate dhe të ndërlikuara të të cilave ravijëzohen në sfondin e një qielli të pafund, ku prehet zhegu i përjetshëm.

Në përkëdheljet e floknajës tënde rigjej kapitjet e orëve të gjata të kaluara mbi një divan, në kthinën e një anijeje të bukur, të lëkundur nga troshitjet e lehta të portit, midis vazove me lule dhe brokeve me pije freskuese.

Në vatrën plot afsh të floknajës tënde thith erën e duhanit të përzier me atë të opiumit dhe të sheqerit; në terrin e floknajës tënde shoh të shndrisë pafundësia e kaltërsisë tropikale; mbi brigjet me push të floknajës tënde dehem me aromat e përziera të serës, myshkut dhe vajit të kokosit.

Lërmë të kafshoj gjatë gërshetat e tua të rënda dhe të zeza. Kur kafshoj lehtas flokët e tu të epshëm e rebelë, më duket sikur jam duke ngrënë kujtime.

XVIII

Ftesë për udhëtim

Ekziston një vend i mrekullueshëm, një vend i begatë, thonë, që ëndërroj ta vizitoj me një mike të vjetër. Është një vend i jashtëzakonshëm, i mbytur në mjegullat e Veriut tonë, dhe që mund të quhej Orienti i Perëndimit, apo Kina e Evropës, aq bukur ka lulëzuar atje një fantazi e ngrohtë dhe trillane, e cila i ka stolisur gjithë durim dhe këmbëngulje ato vise, me një bimësi të rrallë dhe delikate.

Një vend i vërtetë begatie, ku gjithçka është e bukur, e pasur, e paqme, e fisme; ku luksi pasqyrohet gjithë ëndje brenda rregullit; ku jeta është e kolme dhe e ëmbël për t'u thithur; një vend ku nuk ekzistojnë rrëmuja, trazira dhe e papritura; ku lumturia shkrihet me heshtjen; ku edhe vetë kuzhina është njëkohësisht poetike, e pasur dhe joshëse; ku gjithçka ju ngjan juve, ëngjëlli im i dashur.

A e njeh atë sëmundje të ethshme që të pushton e të mbështjell me ftohtësinë e saj mjeruese, atë nostalgji për një vend që s'e njeh, atë ankth që të jep kureshtja? Ka ca vise që të ngjajnë ty dhe ku gjithçka është e bukur, e pasur, e paqme dhe e fisme, ku fantazia ka ndërtuar dhe stolisur një Kinë perëndimore, ku jeta është e ëmbël për t'u thithur, ku lumturia shkrihet me heshtjen. Atje duhet të shkojmë për të jetuar, atje duhet të shkojmë për të vdekur!

Po, atje duhet të shkojmë për të marrë frymë, për të ëndërruar dhe për të zgjatur orët me pafundësinë e ndjenjave. Një muzikant ka shkruar një *Ftesë për vals*[1]; cili është ai që do të kompozojë një *Ftesë për udhëtim* që të mund t'ia ofrojmë gruas që duam, motrës së zgjedhur?

Po, në këtë atmosferë do të ishte bukur të jetoje, — atje larg, ku orët, më të ngadalta, përmbajnë më shumë mendime, dhe ku tik-taku e ritmon lumturinë me një solemnitet më të thellë dhe më kuptimplotë.

Mbi tablo të shndritshme, ose mbi bashka të praruara të një luksi të zymtë, jetojnë pa bujë piktura të paqme, të qeta dhe të thella, ashtu si shpirtrat e artistëve që i kanë krijuar. Drita e perëndimit të diejve, që i jep ngjyra aq të pasura sallës së bukës apo sallonit, filtrohet prej stofrash të bukura ose prej dritareve të punuara me mjeshtëri dhe të ndara nga shufra plumbi në katrorë të shumtë. Orenditë

1. Aluzion për rondon e famshme për piano te Weber, të rimarrë në Freischütz dhe të adaptuar për orkestër nga Berliozi.

janë të gjera, kureshtare, të çuditshme dhe të mbyllura, sikurse shpirtrat e rafinuar, me brava dhe sekrete. Pasqyrat, metalet, stofrat, argjendaria dhe fajanca luajnë për sytë një simfoni të heshtur dhe misterioze; dhe nga çdo gjë, nga çdo cep, nga sirtarët dhe palat e stofrave, çlirohet një parfum i veçantë që të kujton Sumatrën dhe që është bërë tashmë si shpirti i banesës.

Një vend vërtet i begatë, të them, ku gjithçka është e pasur, e pastër dhe e ndritshme, si një ndërgjegje e kthjellët, si enë kuzhine madhështore, si argjendurina të shkëlqyeshme, si stolira të larmishme! Thesaret e botës kanë vërshuar aty, si në shtëpinë e një njeriu punëtor që e ka merituar me djersë të gjithë botën. Vend i çuditshëm, sipëran nga gjithë të tjerët, siç është Arti ndaj Natyrës, kur kjo e fundit është e tjetërsuar nga ëndrra që e ka ndrequr, zbukuruar dhe ripërtërirë.

Le të kërkojnë pa fund, le t'i zmbrapsin pa reshtur kufizimet e lumturisë së tyre alkimistët e kopshtarisë. Le të ofrojnë çmime prej 60 apo 100 mijë fjorintash për atë që do të zgjidhë problemet e tyre ambicioze! Unë për vete e kam gjetur *tulipanin tim të zi* dhe *gjeorgjinën time blu*[2]!

Lule e pakrahasueshme, tulipan i rizbuluar, gjeorgjinë alegorike, a s'është vallë në atë vend aq

2. Tulipanomania ka mbetur nje klishe e lidhur me imazhin e Hollandës që prej shekullit të XVII-të. Ménage, Furetière, La Bruyère, kanë shkruar për të, ndërsa Alexandre Dumas i ka kushtuar nje roman të tërë, *Tulipani i zi* (1850). Gjeorgjina blu eshte nje tjeter klishe, sot e harruar, por mjaft e njohur ne shekullin e XIX-të, që simbolizon ndjekjen e nje utopie.

të qetë dhe ëndërrndjellës ku duhet vajtur të jetojmë dhe të lulëzojmë? A nuk do të ishe ti e mbyllur si në kornizën e shëmbëllimit tënd, dhe a nuk do të pasqyroheshe, për të folur si mistikët[3], në *dyzimin* tënd?

Ëndrra! gjithmonë ëndrra! dhe sa më ambicioz dhe delikat është shpirti, aq më tepër ëndrrat e largojnë nga e mundshmja. Çdo njeri mbart në vetvete dozën e tij të lindur të opiumit, të prodhuar dhe ripërtërirë pareshtur. Por, që nga ora e lindjes derisa arrin ajo e vdekjes, sa orë mund të numërojmë që janë të mbushura me kënaqësi, me veprime të planifikuara dhe të dala mbanë me sukses? A do të shkojmë dhe të jetojmë dot vallë në këtë tablo që ka pikturuar mendja ime, tablo që të ngjan ty?

Këto thesare, këto mobilje, ky luks, kjo harmoni, këto parfume, këto lule të jashtëzakonshme, je ti. Prapë ti je edhe këta lumenj të gjerë e këto kanale të qetë. Këto anije madhështore që lundrojnë mbi ta, të ngarkuara rrëng me pasurira, dhe nga të cilat ngrihen këngët monotone të detarëve, janë mendimet e mia që prehen ose rrokullisen mbi gjoksin tënd. Ti i udhëheq butësisht drejt detit që është Pafundësia, gjithë duke pasqyruar thellësitë e qiellit në tejdukshmërinë e shpirtit tënd të bukur; dhe, kur të lodhura

3. Aluzion për Swedenborg që ka përkufizuar teorinë e tij të dyzimeve (*les correspondances*) në dy libra: *Qielli me mrekullitë e tij* dhe *Ferri dhe Feja e vërtetë e krishterë.*

nga lëkundja e valëve dhe të ngopura me prodhimet e Orientit, ata hyjnë në portin amë, janë përsëri mendimet e mia që, të pasuruara, rikthehen nga Pafundësia për të ardhur tek ty.

XIX

Lodra e varfanjakut

Dua t'ju jap idenë e një dëfrimi të pafajshëm. Ka kaq pak argëtime që nuk janë të dënueshme! Kur të dilni në mëngjes me dëshirën për të bredhur nëpër shëtitoret e mëdha, mbushni xhepat me shpikje të vogla njëqindarkshe, — si për shembull, figurina që mund t'i lëvizësh me anë të një fijeje, farkëtarë që rrahin kudhrën, një kalorës mbi kalë, bishti i të cilit është një bilbil, — dhe përgjatë kabareve, në rrëzë të pemëve, tregojuani fëmijëve që takoni, fëmijëve të panjohur dhe varfanjakë. Do të vini re se si sytë e tyre zmadhohen pa masë. Në fillim nuk do të guxojnë t'i marrin; do të druhen ta besojnë lumturinë e tyre. Pastaj duart e tyre do ta mbërthejnë me shpejtësi dhuratën, dhe ata do të ikin me vrap, si macet që shkojnë ta hanë larg jush copën që iu keni dhënë, sepse kanë mësuar që të mos i zënë besë njeriut.

Në një rrugë, prapa gardhit të një kopshti të madh, në fund të të cilit shndriste bardhësia e një kështjelle gjithë hijeshi të rrahur nga dielli, qëndronte një fëmijë i bukur e plot freski, i veshur me ca rroba fshati të spitulluara.

Luksi, moskokëçarja dhe kamja e përditshme i bëjnë këta fëmijë aq të bukur, sa që duken sikur janë mbarsur nga një tjetër lloj brumi prej atij të fëmijëve të mediokritetit apo të varfërisë.

Pranë tij shtrihej mbi bar një kukull e mrekullueshme, po aq e freskët sa i zoti, e llustruar, e praruar, e veshur me një fustan të purpurt, dhe e mbuluar me pupla dhe stringla. Por fëmija nuk ia varte lodrës së tij të preferuar, dhe ja se ç'shikonte:

Nga ana tjetër e gardhit, mbi rrugë, midis gjëmbaçëve dhe hithrave, qëndronte një fëmijë tjetër, i pisët, varfanjak, i zi si bloza, një nga ata camërdhokët leckamanë, tek të cilët vetëm një sy i paanshëm mund ta diktonte bukurinë, ashtu si syri i njohësit të vërtetë që e njeh një pikturë ideale edhe nën një shtresë lustre karrocash, nëse e pastronte nga zgjyra e neveritshme e mjerimit.

Përmes atij gardhi simbolik që ndante dy botë të ndryshme, rrugën e madhe dhe kështjellën, fëmija i varfër i tregonte fëmijës së pasur lodrën e tij, që ky i fundit e kqyrte gjithë lakmi, si të ish një send i rrallë dhe i paparë. Por ajo lodër, që pisanjosi i vogël e ngacmonte, tundte dhe shkundte në një kafaz, ishte një mi i gjallë! Prindërit e tij,

me siguri për të kursyer, e kishin nxjerrë lodrën nga vetë jeta.

Dhe të dy fëmijët i buzëqeshnin njëri-tjetrit vëllazërisht, me dhëmbë *barabar* të bardhë.

XX

Dhuratat e zanave

Kuvendi i madh i Zanave ishte mbledhur për t'u shpërndarë dhuntitë të gjithë të sapolindurve të ardhur në jetë njëzet e katër orët e fundit.

Të gjitha këto Motra të Fatit, antike dhe trillane, këto Nëna të çuditshme të gëzimit dhe të dhimbjes, ishin fort të ndryshme: disa dukeshin të zymta dhe rrinin buzëvarur, të tjerat kishin një pamje gazmore dhe shpotitëse; disa ishin të reja dhe kishin qenë gjithnjë të reja; të tjerat ishin plaka dhe kishin qenë gjithnjë plaka.

Të gjithë ata etër që besonin ende te Zanat kishin ardhur, duke sjellë në krahë foshnjën e tyre të posalindur.

Dhuntitë, Aftësitë, Rastet e mira, Rrethanat e pashmangshme, ishin grumbulluar në një cep, si çmimet mbi podium në një ceremoni të ndarjes së çmimeve. Por veçantia këtu ishte që Dhuratat nuk

ishin një shpërblim që jepej për ndonjë përpjekjeje, por përkundrazi, një mirësi që i dhurohej atij që nuk kishte jetuar ende, një mirësi që mund të ishte vendimtare për fatin e tij dhe të bëhej po aq lehtë burim fatkeqësie ose lumturie.

Të varfrat Zana ishin shumë të zëna me punë, pasi turma e atyre që kërkonin ishte e madhe, dhe bota e ndërmjetme që ndodhet midis njeriut dhe Zotit i nënshtrohet, sikundër edhe ne, ligjit të tmerrshëm të Kohës dhe pasardhësve të saj të pafund, Ditëve, Orëve, Minutave, Sekondave.

Në të vërtetë, ato ishin po aq të trallisura sa ministrat në një ditë mbledhjesh parlamenti, apo shitësit e dyqaneve me kredi, kur një festë kombëtare autorizon shlyerjen falas të kredive. Më duket madje, se ato vështronin herë pas here akrepin e orës me po aq padurim sa gjyqtarët njerëzorë që, të mbërthyer pas karriges qysh prej mëngjesit, nuk e mbajnë dot veten së ëndërruari për darkën, familjen dhe pantoflat e tyre të dashura. Në qoftë se edhe në drejtësinë e mbinatyrshme nguti dhe rastësia luajnë një farë roli, të mos habitemi që e njëjta gjë ndodh edhe në drejtësinë njerëzore Ndryshe edhe ne do të ishim gjyqtarë të padrejtë.

Si përfundim, u bënë atë ditë disa proçka që mund të quheshin të çuditshme sikur maturia, më tepër se trilli, të ishte tipari dallues e i përjetshëm i Zanave.

Kështu, aftësia për të tërhequr si magnet paranë iu dha trashëgimtarit të vetëm të një familjeje shumë

të pasur, i cili, duke mos patur as ndjenjën më të vogël të zemërgjerësisë si dhe as ndonjë lakmi për të mirat e dukshme të jetës, do të ndihej më vonë jashtëzakonisht i bezdisur nga milionat e tij.

Ndërsa dashuria për Bukurinë dhe Dhuntia poetike iu dhanë djalit të një varfanjaku të zymtë, një punëtori guroreje, që nuk kishte asnjëfarë mundësie as që t'ia nxiste aftësinë e as që t'ia lehtësonte nevojat pjellës së tij të mjerë.

Harrova t'ju them që shpërndarja në këto raste solemne është pa apel, dhe që asnjë dhuratë nuk mund të kthehet mbrapsht.

Të gjitha Zanat u ngritën në këmbë duke kujtuar se puna e tyre e lodhshme kish marrë fund, sepse nuk kishte ngelur më asnjë dhuratë, asnjë bujari për t'i ofruar gjithë asaj turme njerëzish pa rëndësi, kur një goxha burrë, një tregtar i vogël më duket, u ngrit dhe, duke kapur nga fustani prej avujsh shumëngjyrësh Zanën që kishte më afër, thirri:

"Ej, zonjë! na harruat neve! është edhe vogëlushi im! Nuk dua të kthehem duarthatë".

Zana mund të ish ndjerë ngushtë, sepse nuk kishte mbetur më *asgjë*. Megjithatë, asaj iu kujtua në çastin e duhur një ligj shumë i njohur, ndonëse rrallë i vënë në zbatim, në botën e mbinatyrshme të banuar nga këto hyjni të pakapshme, mike të njeriut, dhe shpesh të shtrënguara t'i përshtaten pasioneve të tij, siç janë Zanat, Xhuxhat, Salamandrat, Shtojzovallet, Xhindet e ajrit, Nimfat, Floçkat e ujit, — e kam fjalën për ligjin që u jep Zanave në një

rast të ngjashëm, pra në rastin kur dhuratat mbarohen, aftësinë për të dhënë edhe një dhuratë tjetër, plotësuese dhe të jashtëzakonshme, me kusht sidoqoftë, që zana të ketë aq imagjinatë sa për ta krijuar në çast.

Pra Zana e mirë u përgjigj, me një gjakftohtësi të denjë për rangun e saj: "Tët biri i jap... i jap... *Dhuntinë që të pëlqehet!*".

"Po si që të pëlqehet? Të pëlqehet...? pse të pëlqehet?" pyeti me ngulm tregtari i vogël, që ishte pa dyshim një nga ata njerëz me mendje sa të rëndomtë aq edhe të paaftë për tu ngritur gjer në logjikën e Absurditetit.

"Sepse! sepse!" iu përgjigj Zana e zemëruar, duke i kthyer shpinën; dhe tek bashkohej me vargun e shoqeve të saj, iu thoshte: "Si iu duket juve ky palo francez mendjemadh që kërkon të kuptojë gjithçka, dhe që ndonëse mori për të birin më të mirën e dhuntive, guxon prapëseprapë të bëjë pyetje e të diskutojë të padiskutueshmen?"

XXI

Tundimet ose Erosi, Plutusi dhe Fama

Dy Djaj madhështorë dhe një Djallushe, jo më pak e jashtëzakonshme, ngjitën mbrëmë shkallët misterioze nëpërmjet të cilave Ferri sulmon dobësinë e njerëzve në gjumë dhe merr e jep fshehtazi me ta. Ata erdhën dhe qëndruan gjithë mendjemadhësi përballë meje, si të ishin mbi një podium. Nga këta tre personazhe buronte një shkëlqim sulfuror, që i nxirrte në pah në sfondin e errësirës opake të natës. Kishin një pamje aq krenare dhe zotëruese, saqë në fillim i mora për Zota të vërtetë.

Fytyra e Djallit të parë i përkiste një gjinie të papërcaktuar, ndërsa trajtat e trupit të tij kishin plogështinë e Bacchus-it[1] të vjetër. Sytë e tij të bukur dhe të dergjur, të errët dhe të turbullt, iu ngjanin manushaqeve të ngarkuara ende me dënesat e rënda

1. Latinizim i Bacchos, një nga emërtimet e Dionisit, perëndi e vreshtave, verës dhe e festave delirante në mitologjinë greke.

të stuhisë, dhe buzët, paksa të hapura, të kujtonin vazot e ngrohta prej nga shpërndahet era e mirë e parfumit që digjet. Sa herë që merrte frymë, kandra me erë myshku që fluturonin lehtë-lehtë përndriteshin nga afshi i frymës së tij.

Rrotull tunikës së tij të purpurt ishte mbështjellë në formë rripi një gjarpër farfuritës i cili e vështronte si në dergjë me ca sy prej prushi. Prej këtij rripi të gjallë vareshin, ndërmjet shishkave plot me barna të mynxyrshme, thika të shndritshme dhe instrumenta kirurgjie. Në dorën e djathtë mbante një tjetër shishkë, përmbajtja me ngjyrë të kuqe të ndezur e së cilës kishte si etiketë këto fjalë të çuditshme: "Pini, ky është gjaku im, një bar i përsosur për zemrën"; në dorën e majtë mbante një violinë që i duhej pa dyshim për të kënduar ëndjet dhe dhimbjet, si dhe për të përhapur flamën e çmendurisë së tij netëve të sabatit.

Në nyjet e brishta të këmbëve i vareshin rrathë të këputur të një zinxhiri ari, dhe kur bezdia që ato i shkaktonin e detyronte të ulte sytë, ai sodiste gjithë vetëkënaqësi thonjtë e këmbëve, të shkëlqyer dhe të lëmuar si gurë të gdhendur.

Ai më vështroi me sytë e tij të trishtë e të pangushëllueshëm, nga të cilët buronte një dehje tinëzare, dhe me një zë melodioz më tha: "Po të duash, po të duash, unë mund të të bëj zotin e shpirtrave, dhe ti do të bëhesh mjeshtër i lëndës së gjallë më shumë se skulptori i argjilit; dhe do të provosh kënaqësinë, të përtërirë gjithësaherë, që

ndjen njeriu kur del prej vetvetes për t'u harruar tek dikush tjetër, dhe josh një shpirt për ta përhumbur në atë tëndin".

Dhe unë iu përgjigja: "Shumë faleminderit! por as që më bëhet vonë për ato qenie koti, që me siguri s'vlejnë më shumë sesa uni im i mjerë. Ndonëse disa herë më vjen pak turp nga ca kujtime, nuk dua të harroj asgjë; por edhe sikur të mos të të kisha njohur, përbindësh i vjetër, thikat e tua misterioze, shishkat e tua të dyshimta, vargonjtë në të cilët të janë ngatërruar këmbët, janë simbole që shpjegojnë mjaft qartë kokëçarjet që sjell miqësia me ty. Mbaji për vete dhuratat e tua".

Djalli i dytë nuk kishte as atë pamje sa tragjike aq dhe gazmore, as ato mënyra të bukura dhe dredharake në të sjellur, as atë bukuri delikate dhe të parfumuar. Ishte një burrë i gjerë, me një fytyrë të shëndoshë dhe pa sy, me një bark të dhjamosur që i varej mbi kofshë, me një lëkurë të praruar mbi të cilën ishin pikturuar një mori figurash të vogla që lëviznin dhe paraqisnin format e shumta të mjerimit universal. Kishte njerëz të vegjël dhe të drobitur që kishin varur veten në një gozhdë; kishte shkurtabiqë shtrembaluqë e thatanikë, sytë lutës të të cilëve kërkonin lëmoshë më mirë se duart e tyre që dridheshin; pastaj nëna të plakura që mbartnin dështakë të mbërthyer pas sisave të tyre të flashkura. Kishte edhe plot figura të tjera.

Djalli i trashë i binte me grusht barkut të tij të madh, nga i cili dilte atëherë një tringëllimë

metalike, e gjatë dhe kumbuese, që mbaronte me një rënkim të dobët zërash njerëzorë. Dhe ai qeshte, duke treguar me paturpësi dhëmbët e prishur, me një të qeshur të fortë prej gdheri, siç bëjnë ca njerëz pas një darke tepër të bollshme.

Dhe ky më thotë: "Unë mund të të jap atë që blen gjithçka, atë që vlen gjithçka, atë që zëvendëson gjithçka!". Dhe i ra barkut të tij të përbindshëm, jehona tingëlluese e të cilit përcolli fjalët e tij trashanike.

U ktheva me neveri dhe iu përgjigja: "S'kam nevojë ta ushqej kënaqësinë time me vuajtjen e të tjerëve; dhe nuk e dua një pasuri të helmuar prej gjithë atyre gjëmave që figurojnë mbi lëkurën tënde".

Sa për Djallushen, do të gënjeja po të mos pohoja që në vështrim të parë i gjeta një joshje të çuditshme. Për ta përcaktuar këtë joshje, krahasimin më të mirë ma japin ato gratë shumë të bukura që ndonëse s'janë më të reja, nuk plaken më, bukuria e të cilave ruan magjinë e thekshme të rrënojave. Ajo kishte një pamje urdhëruese dhe në të njëjtën kohë të ngathët, dhe sytë e saj, ndonëse të drobitur, kishin një fuqi magjepsëse. Ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte misteri i zërit të saj, i cili më kujtonte *kontraltot* më të mrekullueshme, por gjithashtu ngjirjen e fyteve të lagura ditë e natë nga alkooli.

"A do ta njohësh fuqinë time?" tha perëndesha e rreme me zërin e saj të këndshëm dhe paradoksal. "Dëgjo."

Dhe ajo shpuri atëherë te goja një trompetë gjigande, si një fyell, të stolisur me kordhela mbi të cilat ishin shkruar titujt e të gjitha gazetave të universit, dhe nëpërmjet kësaj trompete ajo thirri emrin tim, që gjëmoi nëpër hapësirë me zhurmën e njëqind mijë bubullimave, dhe që u kthye përsëri si jehonë e planetit më të largët.

"Ta marrë dreqi!" bëra unë, gjysmë i magjepsur "ja diçka e çmuar që ia vlen ta kesh!" Por duke shqyrtuar më me kujdes atë grua aq tërheqëse, ndonëse mashkullore, pata një përshtypje të turbullt se e kisha parë të ngrinte gotën me disa tuhafër që njihja; dhe tingulli i ngjirur i bakrit më solli në vesh nuk e di ç'kujtim të një trompete prostitutë.

Kështu që iu përgjigja, gjithë përbuzje: "Ik që këtej! Nuk jam nga ata unë që martohen me dashnoren e disave që nuk dua t'i përmend".

Natyrisht që nga ky vetëmohim i guximshëm kisha të drejtë të ndihesha krenar. Por fatkeqësisht në atë çast më doli gjumi, dhe e gjithë forca më braktisi. "Duhet të kem qenë vërtet shumë i përgjumur për të treguar skrupuj të tillë, thashë me vete. Ah sikur ata të mund të vinin tani që jam zgjuar, s'do të tregohesha aq buzëhollë!"

Dhe i thirra me zë të lartë, duke iu lutur me lot në sy të më falnin, dhe duke u treguar i gatshëm që të më çnderonin sa herë të donin për të merituar favoret e tyre; por me siguri që i kisha fyer rëndë, meqenëse ata nuk u kthyen më kurrë.

XXII

Muzgu i mbrëmjes

Dita po thyhet. Një fashitje e thellë i kaplon shpirtrat e gjorë, të lodhur nga puna e ditës; dhe mendimet e tyre marrin tashmë ngjyrat e ëmbla e të mjegullta të muzgut.

Por ndërkaq, nga maja e malit arrin deri te ballkoni im, përmes reve të tejdukshme të mbrëmjes, një ulërimë e thekshme e përbërë nga një mori klithmash të çjerra, që hapësira i shndërron në një harmoni të përzishme, të ngjashme me atë të një batice që ngrihet apo të një stuhie që zgjohet.

Kush janë ata fatkeqë që mbrëmja nuk arrin t'i qetësojë, dhe që ashtu si hutat, e marrin rënien e natës për një shenjë orgjie? Kjo ulërimë ogurzezë e zogjve të natës vjen nga streha e errët që ndodhet në majë të malit; dhe mbrëmjeve, ndërsa tymos duke soditur qetësinë e luginës së pafund, të

mbuluar me shtëpi dritaret e të cilave thonë: "Paqja ka rënë këtu tashmë; edhe lumturia e familjes këtu ndodhet!", ndërsa era fryn që nga lart, unë e lejoj këtë shembëllim të harmonive të ferrit të përkundë mendimet e mia të habitura.

Muzgu i ngacmon të çmendurit. — Më kujtohet që dikur kam patur dy miq të cilët muzgu i sëmurte. Njëri prej tyre i harronte të gjitha rregullat e miqësisë dhe të mirësjelljes dhe keqtrajtonte, si të ish një egërsirë, njeriun e parë që takonte. E kam parë t'i vërviste kokës një maxhordomi një pulë mjaft të shijshme, në të cilën ai pandehte se kish lexuar nuk e di çfarë hieroglifi fyes. Mbrëmja, paraardhëse e ëndjeve të thella, ia prishte edhe gjërat më të këndshme.

Ndërsa tjetri, një ambicioz i plagosur në sedër, teksa dita venitej, bëhej me i hidhur, më i zymtë, më zevzek. Zemërbutë dhe i shoqërueshëm gjatë ditës, ai ishte i pamëshirshëm natën; dhe mania e tij muzgore nuk e drejtonte tërbimin e saj vetëm ndaj të tjerëve, por edhe ndaj vetes së tij.

I pari dha shpirt gjatë një krize çmendurie, i paaftë të njihte gruan dhe fëmijët; i dyti mbart në vete një shqetësim të përhershëm: edhe nëse do t'i jepeshin të gjitha nderimet që mund të ofrojnë republikat dhe mbretërit, besoj se muzgu do të ndizte prapë në trurin e tij dëshirën zhuritëse për çmime imagjinare. Nata, e cila zhyste në errësirë mendjet e tyre, e ndriçon atë timen; dhe ndonëse nuk është e rrallë që i njëjti shkak të japë dy pasoja

të kundërta, kjo dukuri më intrigon dhe më alarmon përherë.

O natë! o errësirë çlodhëse! ju jeni për mua shenja që paraprin një festë të brendshme, ju më çlironi prej ankthit! Në vetminë e fushave, në labirintet e gurta të një kryeqyteti, ju xixëllim yjesh, ju shpërthim fenerësh, ju jeni fishekzjarret e hyjneshës Liri!

Muzg, sa i ëmbël dhe i butë që je! Dritat e kuqe që zvarriten ende në horizont si agonia e ditës nën tiraninë ngadhnjyese të natës, zjarret e shandanëve që lenë njolla të kuqe opake mbi lavditë e fundit të perëndimit, cohrat e rënda që një dorë e padukshme i tërheq që prej thellësive të Orientit, të gjitha këto iu shëmbëllejnë ndjenjave të ngatërruara që kacafyten në zemrën e njeriut, në orët solemne të jetës së tij.

Do të shtoja që muzgu iu shëmbëllen atyre fustaneve të çuditshme të balerinave, tyli i tejdukshëm e i errët i të cilave lë të spikaten bukurirat e përkora të një fundi mahnitës, ashtu si e kaluara e mrekullueshme depërton në errësirën e tanishme; dhe yjet luhatës, të artë ose të argjendtë, të qëndisur mbi të, përfaqësojnë ato zjarret e përfytyrimit që shquhen mirë veçse në errësirën e thellë të Natës.

XXIII

Vetmia

Një gazetar filantrop më thotë se vetmia nuk është e mirë për njeriun; dhe për të mbështetur tezën e tij, ai citon, si të gjithë ata që s'besojnë në Zot, Etërit e Kishës.

E di që Demonit i pëlqen të endet nëpër vende të shkreta, dhe që Shpirti i vrasjes dhe i shthurrjes ndizet mrekullisht në vetmi. Por ka mundësi që kjo vetmi të jetë e rrezikshme vetëm për mendjen e plogësht dhe të hallakatur, që e popullon shkretëtirën me pasionet dhe iluzionet e saj.

Me siguri që një llafazan, kënaqësia më e madhe e të cilit është të flasë që nga maja e një karrigeje apo një tribune, ka shumë rrezik të çmendet krejt në ishullin e Robinsonit. Nuk po i kërkoj gazetarit tim virtytet e guximshme të Kruzosë, por thjesht i kërkoj që të mos akuzojë ata që dashurojnë vetminë dhe misterin.

Në racat tona dërdëllitëse gjenden njerëz që do ta pranonin torturën më mizore me më pak tmerr, nëse do t'iu lejohej të mbanin që nga gijotina një fjalim të gjatë, pa u druajtur se mos daullet e Santerrës[1] ua prisnin fjalën në një çast të papërshtatshëm.

Nuk ua qaj hallin, pasi ma merr mendja që shpërthimet e tyre retorike iu japin ëndje të ngjashme me ato që të tjerë mund të ndiejnë nga vetmia dhe prehja shpirtërore. Por ama i përçmoj.

Mbi të gjitha, do të doja që gazetari im i mallkuar të më lerë të dëfrehem, siç ma ka ënda. "Ju nuk e ndjeni pra kurrë nevojën, më thotë ai, duke folur me hundë dhe me një ton apostolik, — që të ndani gëzimet tuaja me të tjerët?" E shihni ç'smirëzi finok? E kupton që unë i përçmoj të tijat, dhe do që të përfitojë tinëz nga ato të miat, tersi i poshtër!

"Fatkeqësia e madhe e pamundësisë për të ndenjur vetëm!..." thotë diku La Bruyère[2], si të donte t'i bënte me turp të gjithë ata që nxitojnë të harrohen nëpër turmë, pa dyshim nga frika se mos nuk e durojnë dot vetveten.

"Gati të gjitha fatkeqësitë na vijnë nga që nuk

1. Antoine Joseph Santerre (1752-1809) Kish mision që të shoqëronte Luigjin e XVI-të në gijotinë, dhe dha urdhrin që daullet të ndërpritnin fjalimin e lamtumirës së mbretit.

2. Jean de la Bruyère (1645-96), moralist francez. Aforizmi për të cilin bëhet fjalë gjendet në një kapitull të titulluar "De l'homme" (Mbi njeriun), në veprën e tij të famshme *Les Caractères*: "të gjitha të këqijat na bien mbi kokë sepse nuk mundemi të rrimë dot vetëm: kjo është çka të shtyn drejt bixhozit, shthurrjes, çoroditjes, verës, femrave, injorancës, shpifjes, zilisë, dhe na bën të harrojmë veten dhe Zotin".

ditëm të rrimë në dhomën tonë", thotë një i urtë tjetër, Paskali[3] më duket, që fton kështu në qelinë e meditimit të gjithë ata të çakërdisur që kërkojnë lumturinë tek lëvizja dhe tek një prostitucion që mund ta quaja *vëllazëror*, po të flisja gjuhën e bukur të shekullit tim.

3. Blaise Pascal (1623-1662), filozof, matematikan dhe shkrimtar francez. Kjo ide është marrë nga kapitulli që titullohet "Divertissements" (Dëfrime) në librin *Pensees* (Mendime), dhe formulimi ekzakt është: "të gjitha fatkeqësitë e njeriut vijnë nga një shkak i vetëm: paaftësia për të ndejtur qetësisht në dhomën e tij".

XXIV

Projektet

Tek shëtiste në një park të madh e të vetmuar, ai thoshte me vete: "Sa e bukur që do të ishte ajo e veshur me një fustan oborri gjithë qëndisma madhështore, ndërsa zbret, përmes velit të mjegullës së një mbrëmjeje të bukur, shkallët e mermerta të një pallati, përballë të cilit shtrihen lëndina dhe hauzë! Sepse ajo ka pamje princeshe".

Më vonë, ndërsa ecte rrugës, ai ndalon përballë një dyqani gravurash dhe, duke gjetur në një karton një stampë peizazhi tropikal, thotë me vete: "Jo! nuk është në një pallat që do të doja ta gëzoja jetën e saj të dashur. Nuk do të ishim si *në shtëpinë tonë.* Për më tepër, mbi muret e florinjta nuk do të kish vend për të varur portretin e saj; në ato galeri solemne nuk ka as edhe një kënd për intimitet. Nuk kam pikë dyshimi që *këtu* do të dëshiroja të banonim për të përjetuar ëndrrën e jetës sime".

Dhe, gjithë duke shqyrtuar me sy imtësitë e gravurës, ai vazhdonte të thoshte me mendje: "Në breg të detit, një kasolle e bukur druri, e rrethuar nga gjithë këto pemë të çuditshme dhe të shndritshme, emrat e të cilave i kam harruar..., në ajër, një aromë marramendëse, e papërcaktuar..., brenda kasolles një aromë e fortë trëndafili dhe myshku..., më tutje, përtej rrethinës sonë të vogël, maja direkësh që lëkunden nga valët. Dhoma do të ish e ndriçuar nga një dritë rozë e filtruar prej tendave, dhe e dekoruar me kallama të njomë e lule dehëse; disa kolltukë të pakët, stil rokokoje portugez, prej druri të rëndë e të errët (ku ajo do të mund të çlodhej e qetë, në fresk, duke pirë duhan të përzier me pak opium!), ndërsa jashtë, përtej verandës, dëgjohen cicërimat e zogjve të dehur nga drita dhe dërdëllitja e zezakeve të vogla... Netëve, kënga vajtuese e pemëve të muzikës, e shelgjeve melankolikë, do të shoqëronte ëndrrat e mia! Po, pikërisht *ky* është dekori që po kërkoja. E ç'më duhej pallati?".

Më tutje, ndërsa ecte në një shëtitore të gjerë, i zunë sytë një bujtinë të pastër, në njërën prej dritareve të së cilës, të zbukuruar me perde cohe me vija, dukeshin dy fytyra të qeshura. "Me sa duket, tha menjëherë me vete ai, mendja ime do të ketë qenë bredharake e madhe që ka shkuar të kërkojë aq larg atë që ndodhet kaq pranë. Kënaqësia dhe lumturia gjenden në bujtinën e parë që të del përpara, në bujtinën e rastësishme, aq të pasur në ëndje. Një zjarr i madh, ca porcelane me ngjyra të

ndezura, një darkë modeste, një verë e fortë, dhe një shtrat shumë i gjerë me çarçafë paksa të ashpër, por të freskët, e ç'mund të kërkosh më tepër?".

Dhe ndërsa kthehej vetëm në shtëpi, në atë orë kur këshillat e Urtësisë nuk mbyten më nga zukama e botës së jashtme, tha me vete: "Sot jetova, në ëndrrat e mia, në tre banesa të ndryshme, të cilat më dhanë të njëjtën kënaqësi. Përse ta detyroj atëherë trupin të zhvendoset, kur mendja ime udhëton me kaq lehtësi? Dhe pse të mundohesh të sendërtosh projekte, kur projekti në vetvete është një kënaqësi?"

XXV

Doroteja e bukur

Dielli e mbyt qytetin me dritën e tij të ngulët e të tmerrshme; rëra është verbuese dhe deti vezullon. Bota e topitur vithiset si e squllur dhe bën gjumin e' drekës, një gjumë që është si një lloj vdekjeje e këndshme, ku ai që fle, gjysmë i zgjuar, shijon kënaqësinë e asgjësimit të tij.

E megjithatë, Doroteja, e fortë dhe krenare si dielli, ecën në rrugën e shkretë. Është e vetmja krijesë e gjallë që lëviz në atë orë, nën kaltërsinë e pafund, duke sajuar në kundërdritë një njollë të shndritshme e të zezë.

Ajo ecën duke tundur me përtim bustin që duket aq i hollë në krahasim me ijet e saj të bëshme. Fustani i mëndafshtë, që i ngjitet pas trupit, ngjyrë rozë e hapur, bën një kontrast të gjallë me lëkurën e errët dhe i puthitet mirë siluetës së saj të gjatë, kurrizit të drejtë dhe gjoksit të lartë.

Çadra e kuqe e filtron dritën dhe hedh mbi fytyrën e errët të vajzës grimin e përgjakur të reflekseve të saj.

Pesha e floknajës së saj madhështore, aq të zezë, sa që duket si blu, ia tërheq prapa kokën e brishtë dhe i jep një pamje ngadhënjyese dhe të plogët. Vëthët e gjatë e të rëndë mërmërisin fshehtas, ndërsa tunden në veshët e saj të hirshëm.

Herë pas here puhia e detit ia ngre cepin e fundit të gjerë, duke treguar një këmbë të ndritshme dhe të mrekullueshme; shputa e saj, e ngjashme me shputat e këmbëve të perëndeshave të mermerta që Evropa i ruan nëpër muze, lë gjurmë të qarta mbi rërën e imët. Sepse Doroteja është aq mrekullisht koketë saqë tek ajo, dëshira për të qenë e adhuruar është më e fortë sesa krenaria e të qenit e lirë, dhe, ndonëse nuk është më skllave, ajo ecën këmbë-zbathur.

Kështu ecën ajo, harmonishëm, e lumtur që është në jetë dhe me një buzëqeshje të ndritur, si t'i kapte syri diku larg një pasqyrë që reflektonte ecjen dhe bukurinë e saj.

Në një orë kur edhe qentë rënkojnë nga dhimbja që iu shkakton kafshimi i diellit, ç'arsye e fuqishme mund ta ketë shtyrë të dalë Dorotenë e plogët, të bukur dhe të ftohtë si bronzi?

Përse e ka lënë kasollen e saj të vogël të rregulluar me aq sqimë, ku lulet dhe rrogozët krijojnë, me shumë pak shpenzime, një buduar të përsosur ku asaj i pëlqen aq shumë të krihet, të pijë

duhan, të freskohet apo të shihet në pasqyrën e freskores së saj të madhe të rrethuar me pupla, ndërsa deti me dallgët që përplasen mbi breg nja njëqind hapa më larg, i shoqëron fuqishëm dhe në mënyrë monotone ëndërrimet e saj të turbullta, kurse kusia e hekurt, ku zien një ragu gaforresh me oriz e safran, i dërgon që nga fundi i oborrit kundërmimet e tij ngacmuese?

Ndoshta ka takim me ndonjë oficer të ri i cili, në bregdete të largëta, ka dëgjuar nga shokët për Dorotenë e famshme. Me siguri që e gjora krijesë do ta lusë që ai t'i përshkruajë ballon e Operas, dhe do ta pyesë nëse mund të shkohet aty këmbëzbathur, si në vallëzimet e të dielës ku edhe vetë plakat kafre[1] dehen dhe bëhen si të çmendura nga gëzimi; dhe nëse zonjat e Parisit janë të gjitha më të bukura se ajo.

Dorotenë e adhurojnë dhe e përkëdhelin të gjithë, dhe ajo do të kish qenë vërtet e lumtur sikur të mos ishte e detyruar të mblidhte një nga një kacidhet për të riblerë motrën e saj të vogël 11-vjeçare, që është pjekur tani dhe është bërë si perri! Me siguri që do t'ia dalë mbanë, Doroteja zemërmirë; i zoti i vogëlushes është tepër kurrnac dhe s'i hyn në sy tjetër bukuri veç asaj të parasë.

1. Kafrët janë një etni zezake që jetojnë në Afrikën e Jugut.

XXVI

Sytë e të varfërve

Ah! Ju doni të dini se përse unë sot ju urrej. Pa dyshim që ju do ta keni më të vështirë për ta kuptuar se sa unë për t'jua shpjeguar; sepse më duket se ju jeni shembulli më i mirë i padepërtueshmërisë femërore.

Kishim kaluar së bashku një ditë të gjatë që më ishte dukur e shkurtër. I kishim premtuar përnjimend njëri-tjetrit që të gjitha mendimet do t'i kishim të përbashkëta, dhe që këtej e tutje shpirtrat tanë do të bëheshin njësh; — një ëndërr që, në fund të fundit, nuk ka asgjë origjinale përveç asaj që, e ëndërruar prej gjithkujt, nuk ka qenë e njëmendsuar prej askujt.

Në mbrëmje, paksa e lodhur, ju deshët të uleshit në tarracën e një kafeneje të re që ndodhej në cepin e një bulevardi të ri, i cili, ndonëse në ndërtim e sipër, tregonte gjithë lavdi bukuritë e tij ende të

papërfunduara. Kafeneja shkëlqente. Madje dhe gazi i fenerëve përhapte përndezjen e përurimit, ndërsa ndriçonte me sa kishte fuqi muret verbues nga bardhësia, pasqyrat e mahnitshme, floririn e shufrave e të kornizave, pazhët faqembushur që i tërhiqnin qenushë të lidhur me qafore, zonjat me buzë në gaz të cilat mbanin një fajkua mbi kyçin e dorës, nimfat dhe hyjneshat që mbanin mbi kokë fruta, byreçka e mishra gjahu, Hebet dhe Ganimedët[1] që zgjatnin amforën e vogël me çaj e me qumësht ose obelisket dyngjyrësh prej akulloresh të larme; me një fjalë, e gjithë historia dhe mitologjia të vëna në shërbim të makutërisë.

Mu përballë nesh, mbi trotuar, rrinte në këmbë si hu një burrë bablok nja dyzet vjeç, me fytyrë të lodhur e mjekër ngjyrë hiri, i cili mbante për dore një djalë të vogël, ndërsa në krahun tjetër mbante një qenie imcake, tepër të dobët për të ecur vetë. Ai kishte marrë përsipër rolin e dados dhe i kishte nxjerrë fëmijët që të merrnin ajrin e mbrëmjes. Të tre të leckosur. Këto tre fytyra kishin nja pamje tepër serioze dhe të gjashtë sytë soditnin me ngulm kafenenë e re me një adhurim të barabartë, nuancat e të cilit ndryshonin sipas moshës.

Sytë e babait thoshin: "Sa bukur që qenka! sa bukur! duket sikur i gjithë floriri i njerëzve të varfër është mbledhur këtu për të zbukuruar këto mure." – Sytë e djalit të vogël: "sa bukur që qenka! sa

1. Hebe, Ganimedi: vajzë e re dhe djalë i ri të cilët i shërbenin pije perëndive.

bukur! Por është një shtëpi ku mund të hyjnë vetëm njerëzit që nuk janë si ne." – Ndërsa sytë e më të voglit ishin tepër të mahnitur për të shprehur tjetër gjë përveç një gëzimi budalla dhe të pakufishëm.

Autorët e këngëve thonë që kënaqësia e bën shpirtin dashamirës dhe e zbut zemrën. Këto fjalë po më dukeshin mëse të vërteta atë mbrëmje. Ndihesha jo vetëm i prekur nga ajo familje sysh, por edhe pak i turpëruar nga gotat dhe shishet mbi tryezë, më të mëdha sesa etja jonë. Ktheva sytë drejt vështrimit tuaj, e dashura ime, për të lexuar aty mendimin *tim*; u zhyta në sytë tuaj aq të bukur dhe aq çuditërisht të ëmbël, në sytë tuaj të blertë, të banuar nga Trillet dhe të frymëzuar nga Hëna, kur ju më thatë: "Nuk i duroj dot këta njerëz me ata sy si porta të shqyera! Nuk mund t'i luteni të zotit të kafenesë që t'i largojë që andej?"

Sa e vështirë është të merresh vesh, ëngjëlli im i dashur, dhe sa të pakomunikueshëm janë mendimet, edhe ndërmjet njerëzve që duhen!

XXVII

Një vdekje heroike

Fancioulle[1] ishte një bufon që s'e kishte shokun dhe pothuajse bënte pjesë në rrethin e miqve të Princit. Por për njerëzit që janë të prirur t'iu kushtohen gjërave qesharake, të kundërtat e tyre, ato serioze, janë fatalisht tërheqëse, dhe, ndonëse mund të duket e çuditshme që idealet e atdheut dhe të lirisë të mund ta pushtojnë në mënyrë tiranike trurin e një aktori, një ditë të bukur Fancioulle mori pjesë në një komplot të organizuar nga disa zotërinj të pakënaqur.

Ekzistojnë gjithandej njerëz për së mbari që denoncojnë tek autoritetet individët e zymtë që kërkojnë të rrëzojnë princat dhe të ndryshojnë shoqërinë, pa kërkuar mendimin e kësaj të fundit.

1. Ky emër mund të ketë një kuptim të veçantë, meqenëse në italisht fanciullo do të thotë "fëmijë". Sipas Baudelaire, gjenia është "fëmijëria e rigjetur sipas dëshirës".

Zotërinjtë në fjalë u arrestuan, ashtu si dhe Fancioulle, dhe u dënuan me vdekje.

Do ta besoja me gjithë qejf që Princi gati u zemërua kur gjeti aktorin e tij të preferuar midis rebelëve. Ky princ nuk ishte as më i mirë as më i keq se të tjerët; por një ndjeshmëri e tepruar e bënte, në shume raste, më mizor dhe më despotik se të gjithë të ngjashmit e vet. I dashuruar me pasion pas arteve të bukura, dhe, për më tepër, një njohës i shkëlqyer i tyre, ai ishte vërtet i pangopur kur vinte puna te qejfi. Krejt mospërfillës ndaj njerëzimit dhe moralit, dhe duke qenë vetë një artist i vërtetë, ai nuk njihte tjetër armik të rrezikshëm përveç Mërzisë, dhe përpjekjet e çuditshme që bënte për të shmangur apo për të vënë poshtë këtë tiran të botës do ta kishin shtyrë me siguri ndonjë historian të rreptë ta cilësonte me fjalën "përbindësh", sikur në viset e tij të lejohej të shkruhej çfarëdo qoftë që nuk kishte për qëllim të vetëm të ngjallte kënaqësinë apo habinë, një nga format më delikate të kënaqësisë. Fatkeqësia e madhe e këtij Princi ishte se ai nuk kish patur kurrë një teatër aq të madh sa të nxinte gjeninë e tij. Ka Neronë të rinj që iu zihet fryma brenda kufijve tepër të ngushtë, dhe që shekujt e ardhshëm nuk do t'jua njohin kurrë as emrin e as vullnetin. Perëndia e pakujdesshme i kishte dhënë këtij Princi prirje më të mëdha sesa fuqia e tij.

Papritur u hap fjala që sovrani kishte ndërmend t'i falte të gjithë të përbetuarit. Ajo që i dha shkas

thashethemit ishte lajmërimi i një shfaqjeje të madhe, ku Fancioulle do të interpretonte një nga rolet e tij më të rëndësishëm dhe më të mirë, shfaqje në të cilën do të merrnin pjesë madje edhe zotërinjtë e dënuar, kështu thuhej së paku. Një shenjë e qartë, shtonin mendjet e cekta, që linte të kuptohej se Princi i fyer ishte i prirur të tregohej zemërgjerë.

Prej një njeriu që ishte aq natyrshëm dhe aq vendosmërisht trillan, gjithçka ishte e mundur, madje edhe virtyti, edhe përdëllimi, po të mendohej se kishte shpresë që këto t'i jepnin kënaqësi të paparashikuara. Por për ata që, sikurse unë vetë, kishin mundur të depërtonin më thellë në këtë shpirt kureshtar dhe të sëmurë, kishte më tepër gjasë që Princi të donte të gjykonte vlerën e talentit aktorial të një njeriu të dënuar me vdekje. Ai donte të përfitonte nga rasti për të bërë një eksperiment fiziologjik të një interesi *themelor*, me qëllim që të shihte se deri në ç'pikë aftësitë e lindura të një artisti mund të veniteshin apo të tjetërsoheshin nga gjendja e jashtëzakonshme në të cilën ai ndodhej. Përveç kësaj, a ekzistonte në shpirtin e tij ndonjë ndjenjë që i ngjante pak a shumë përdëllimit? Kjo është një pikë që kurrë nuk ka mundur të sqarohet mirë.

Më në fund arriti dita e madhe, dhe ai oborr i vogël mbretëror vuri në pah të gjitha salltanetet. Do të ishte e vështirë të përfytyroheshin, pa i parë vetë me sy, të gjitha madhështitë që klasa e privilegjuar e një shteti të vogël e me të ardhura të

kufizuara, është në gjendje të shpalosë kur bëhet fjalë për një solemnitet të vërtetë. Ky ishte dyfish i vërtetë, e para për nga magjia e luksit, dhe e dyta për nga interesi moral dhe misterioz që ngjallte.

Zoti Fancioulle shkëlqente sidomos në rolet e heshtura ose në ato me pak fjalë, që janë shpesh më të rëndësishme në dramat që iu ngjajnë përrallave, tema e të cilave është vënia në skenë, në mënyrë simbolike, e misterit të jetës. Ai hyri në skenë me një lehtësi dhe gjakftohtësi të përsosur, ç'ka ushqeu te publiku fisnik shpresën për zemërgjerësi dhe falje.

Kur themi për një aktor: "Ja një aktor i mirë", përdorim një formulë që lë të kuptohet se prapa personazhit dallohet ende aktori, me fjalë të tjera, arti, përpjekja, vullneti. Por, në qoftë se një aktor do të mund të arrinte të kishte me personazhin që ai interpreton një marrëdhënie të ngjashme me atë që shtatoret më të bukura të antikitetit do të kishin — sikur një mrekulli t'iu jepte jetë, sy, dhe lëvizje, — me idenë e përgjithshme dhe të turbullt të Bukurisë, ky artist do të përbënte pa dyshim një rast të veçantë dhe krejt befasues. Atë mbrëmje, Fancioulle ishte një mishërim i përsosur i idealit, dhe dukej krejt i gjallë, i besueshëm, i njëmendtë. Bufoni shkonte e vinte, qeshte, qante, shfytyrohej, i rrethuar nga një aureolë e papërshkrueshme, aureolë e padukshme për të tjerët, por e dukshme për mua, ku përziheshin në një ngjizje të çuditshme rrezet e Artit dhe lavdia e Martirit. Me një hir të

veçantë dhe të pashpjegueshëm, Fancioulle arrinte të fuste hyjnoren dhe të mbinatyrshmen edhe në bufonëritë më ekstravagante. Pena më dridhet dhe lotët e një emocioni që s'më ka dalë ende nga mendja më mbushin sytë, ndërsa përpiqem t'ju përshkruaj këtë mbrëmje të paharrueshme. Fancioulle ishte prova e prerë, e pakundërshtueshme, që dehja që të jep Arti arrin më mirë se gjithë të tjerat t'i fshehë tmerret e humnerës; prova që gjeniu mund të luajë komedi në buzë të varrit me një gëzim të atillë që e pengon të shohë varrin, i përpirë siç është nga një parajsë që përjashton çdo ide gropë apo shkatërrimi.

I gjithë publiku, sado i velur dhe mendjelehtë që ishte, e ndjeu shumë shpejt sundimin e plotfuqishëm të artistit. Kurrkush nuk mendonte më për vdekjen, zinë, apo torturat. Secili e la veten të shijonte, pa e vrarë mendjen, kënaqësinë e madhe që të jep një kryevepër arti e gjallë. Shpërthimet e gëzimit dhe të mahnitjes tundën gjithë ato herë kubetë e ndërtesës me fuqinë e një bubullime të paprerë. Vetë Princi, si i dehur, i përzieu duartrokitjet e tij me ato të oborrit.

Megjithatë, për një njeri largpamës, dehja e Princit nuk ishte e plotë. Mos ndoshta ndjente se fuqia e tij despotike kishte pësuar një disfatë? Se arti i tij për të tmerruar zemrat dhe për të topitur mendjet, ishte poshtëruar? Se shpresat nuk po i realizoheshin dhe parashikimet nuk po i dilnin? Të tilla hamendje jo krejt të përligjura, por jo dhe fare

të papërligjura, me përshkuan mendjen, teksa sodisja fytyrën e Princit, mbi të cilën një zbehtësi e panjohur i shtohej pareshtur zbehtësisë së tij të zakonshme, si dëbora që i shtohet dëborës së vjetër. Buzët i shtrëngoheshin gjithnjë e më tepër, ndërsa sytë ia ndriçonte një zjarr i brendshëm, i ngjashëm me atë të xhelozisë dhe të mërisë, ia ndriçonte sytë edhe kur ishte duke duartrokitur në mënyrë të dukshme talentin e mikut të tij të vjetër, karagjozit të çuditshëm që bënte aq bukur karagjozllëqe me vdekjen. Në një çast, pashë Madhërinë të përkulej drejt një pazhi të vogël që ndodhej prapa tij dhe t'i pëshpëriste diçka në vesh. Një buzëqeshje ndriçoi fytyrën prej djallushi të fëmijës së bukur; pastaj ai doli me shpejtësi nga lozha princore, si të kishte një mision të ngutshëm për të kryer.

Disa minuta më pas, një fishkëllimë e mprehtë dhe e gjatë e ndërpreu Fancioulle në një nga momentet e tij më të bukura, duke çjerrë veshë dhe zemra bashkë. Andej nga kishte shpërthyer fishkëllima e papritur, një fëmijë shpejtonte drejt një korridori të brendshëm, duke mbytur të qeshurën.

Fancioulle, i tronditur, i zgjuar në mes të ëndrrës së tij, mbylli në fillim sytë, i rihapi aty për aty, të zmadhuar pa masë, pastaj shqeu gojën si të donte të merrte frymë me ngulç, u lëkund paksa përpara, paksa prapa, dhe më në fund ra i vdekur mbi skenë.

Fishkëllima, e shpejtë si një thikë, a ia kishte kursyer vërtet mundimin xhelatit? A ia kish marrë

mendja Princit ç'aftësi vrasëse mbartte dredhia e tij? Kemi të drejtë të dyshojmë mbi këtë gjë. A i erdhi atij keq për Fancioull-in e tij të dashur dhe të paimitueshëm? Është bukur dhe e ligjshme që ta besojmë.

Ishte hera e fundit që zotërinjtë fajtorë kishin shijuar spektaklin e komedisë. Po atë natë ata u fshinë nga kjo botë.

Që atëherë, shumë aktorë të pantomimës, të vlerësuar siç e meritonin në vende të ndryshme, kanë ardhur të luajnë në oborrin ***; por asnjëri prej tyre nuk ka mundur t'i afrohet talentit të mrekullueshëm të Fancioulle, as të ngrihet në *rangun* e tij.

XXVIII

Monedha fallco

Ndërsa largoheshim nga një duhanshitës, miku im filloi të ndante me kujdes të hollat që i kishin mbetur: në xhepin e majtë të setrës futi monedha të vogla ari; në të djathtin, ato prej argjendi; në xhepin e majtë të pantallonave një sasi të madhe monedhash tunxhi, dhe së fundi, në të djathtin, një monedhë argjendi dy frangash, të cilën e kishte shqyrtuar me një kujdes të veçantë.

"Ç'ndarje e çuditshme dhe e përpiktë", thashë unë me vete.

Më pas takuam një lypës që na nderi kësulën duke u dridhur. Nuk njoh gjë më tronditëse sesa elokuenca e heshtur e atyre syve lutës që shprehin njëherazi, për njeriun e ndjeshëm që di t'i lexojë, aq shumë përulësi dhe aq shumë qortim. Ka diçka që i afrohet thellësisë së kësaj ndjenje të ndërlikuar në sytë e përqarë të qenve të rrahur.

Dhurata e mikut tim qe shumë më e madhe se e imja, dhe unë i thashë: "Keni të drejtë; pas kënaqësisë që të jep habia vetë, nuk ka më të madhe kënaqësi sesa të bësh një surprizë.

— Ishte monedha fallco", m'u përgjigj ai qetësisht, si të donte të përligjte bujarinë e tij.

Por në trurin tim të mbrapshtë, që gjithnjë përpiqet t'i ndërlikojë gjërat, (ç'prirje të lodhshme që më ka dhuruar natyra!) shkrepi befas mendimi që një sjellje e tillë nga ana e mikut tim mund të falej vetëm po të ishte e nxitur nga dëshira e tij për të krijuar një ngjarje në jetën e këtij djalli të mjerë, ose, ndoshta, për të marrë vesh pasojat e kobshme ose jo që mund të sjellë një monedhë fallco në dorën e një lypësi. Po sikur ajo të shumëfishohej në monedha të vërteta? Po sikur ajo ta çonte drejt e në burg? Një bujtinar apo një bukëpjekës, për shembull, mund ta denonconte si falsifikues të hollash, ose si shpërndarës parash fallco. Por kishte po aq të ngjarë që monedha fallco të ishte, për ndonjë spekulator të vogël e të varfër, zanafilla e një pasurimi të shpejtë. Kështu më bridhte fantazia, duke i dhënë flatra mendjes së mikut tim dhe duke përfytyruar të gjitha pasojat e mundshme që rridhnin nga të gjitha hamendjet e mundshme.

Por ky i fundit m'i ndërpreu papritmas ëndërrimet duke përsëritur fjalët e mia: "Keni të drejtë; nuk ka kënaqësi më të ëmbël sesa të befasosh dikë duke i dhënë më shumë se sa ai shpreson".

E pashë mu në dritë të syrit, dhe u tmerrova

kur vura re që sytë e tij ndrisnin nga një çiltëri që s'mund ta vije në dyshim. Atëherë kuptova qartë që ai kishte dashur të bënte në të njëjtën kohë një akt bamirësie dhe një punë me leverdi, të fitonte dyzet kacidhe dhe zemrën e Zotit, të fitonte parajsën me pak shpenzime, dhe së fundi të siguronte falas namin e një njeriu përdëllimtar. Do t'ia kisha falur dëshirën për një kënaqësi kriminele, për të cilën mendoja pak më parë se qe i aftë ta shijonte. Do të më ishte dukur e çuditshme, e veçantë, që ai argëtohej duke kompromet uar të varfrit; por kurrë s'kam për t'ia falur idiotësinë me të cilën i kishte bërë llogaritë. Asnjëherë nuk përligjet të qenurit i lig, por ka një farë merite kur e kuptojmë që jemi të tillë; vesi më i pandreqshëm është të bësh keq nga budallallëku.

XXIX

Lojtari zemërgjerë

Dje, tek ecja përmes turmës së bulevardit, ndjeva përkitjen e një Qenieje misterioze, të cilën kisha kohë që dëshiroja ta takoja, dhe që e njoha menjëherë, edhe pse nuk e kisha parë kurrë. Pa dyshim që ajo duhet të kishte të njëjtën dëshirë ndaj meje meqenëse, teksa më kalonte pranë, më bëri me sy një shenjë kuptimplote së cilës nxitova t'i bindem. E ndoqa me vëmendje, dhe shumë shpejt zbrita në një banesë nëntokësore mahnitëse ku shndriste një luks të cilit nuk i afroheshin as pallatet më të bukura të Parisit. M'u duk e habitshme se si kisha mundur të kaloja aq shpesh pranë këtij limeri të madhërishëm pa e vënë re hyrjen. Atje sundonte një atmosferë e mrekullueshme, ndonëse dehëse, që të bënte të harroje gati aty për aty të gjitha ndyrësitë e mërzitshme të jetës; aty thithej një prehje e muzgët, e ngjashme me atë që duhet të

kenë provuar ngrënësit e lotusit kur, ndërsa zbarkonin mbi një ishull të lumtur, të ndriçuar nga dritat e një pasditeje të pafundme, kanë ndjerë, midis tingujve kotullues të ujëvarave melodioze, t'iu lindte dëshira që të mos i shihnin më vatrat, gratë e fëmijët e tyre, dhe kurrë më të mos merrnin udhën e detit.

Kishte atje fytyra të çuditshme burrash e grash, të shenjuara nga një bukuri fatale, që më dukej se i kisha njohur më parë në epoka dhe vise që nuk më kujtoheshin dot saktësisht, dhe që më ndillnin më tepër një simpati vëllazërore sesa frikën që ngjall zakonisht e panjohura. Sikur të doja të përpiqesha të përshkruaja disi shprehjen e jashtëzakonshme të vështrimeve të tyre, do të thosha që kurrë nuk kam parë sy që shndrisin aq energjikisht nga tmerri i mërzisë dhe nga dëshira e pavdekshme për të jetuar.

I zoti i shtëpisë dhe unë, ndërsa uleshim së bashku, ishim bërë ndërkaq miq për kokë, siç thuhet. Hëngrëm, pimë pa masë gjithfarë verërash të rralla, dhe, gjë jo më pak e rrallë, pas disa orësh më dukej se nuk isha më shumë i dehur se ai. Megjithatë, loja, kjo kënaqësi mbinjerëzore, kishte ndërprerë herë pas here të pirën tonë të shpeshtë, dhe duhet të them që ndërkaq e kisha luajtur dhe humbur shpirtin me një moskokëçarje dhe lehtësi heroike. Shpirti është diçka kaq e paprekshme, shumicën e herëve kaq e padobishme, dhe disa herë kaq e bezdisshme, saqë s'ndjeva më shumë trazim sesa

po të kisha humbur kartvizitën gjatë një shëtitjeje.

Pimë ngadalë ca puro, shija dhe aroma e pakrahasueshme e të cilave të ngjallte në shpirt nostalgjinë e viseve dhe lumturive të panjohura. I trallisur nga gjithë këto kënaqësira, unë mora guximin, në një hov intimiteti që nuk m'u duk se e bezdisi, të thërrisja duke ngritur një kupë të mbushur gjer në buzë: "Le të pimë për shëndetin tuaj të pavdekshëm, o Cjap plak!".

Biseduam gjithashtu për gjithësinë, për krijimin dhe shkatërrimin e saj të ardhshëm; për idenë e madhe të shekullit, domethënë idenë e përparimit dhe të përsosmërisë, dhe në përgjithësi, për të gjitha llojet e vetëkënaqësisë njerëzore. Mbi këtë temë, Madhëria e Tij nuk shteronte në mahi të lehta dhe të pakundërshtueshme, dhe shprehej me një të folur të hijshëm plot humor të qetë, që s'e kisha dëgjuar kurrë më parë nga asnjëri prej folësve më të shquar të njerëzimit. Më shpjegoi absurditetin e filozofive të ndryshme që kishin pushtuar deri me sot trurin e njerëzimit, dhe madje, denjoi të më tregonte në mirëbesim disa parime themelore, dobitë e të cilave nuk mund t'ia them njeriu. Nuk u ankua fare për namin e keq që i kishte dalë në të gjitha vendet e botës, më siguroi që ai vetë ishte personi më i interesuar për të shkatërruar *bestytninë*, dhe më pohoi që kishte patur frikë për fuqinë e vet vetëm një herë, ditën kur kishte dëgjuar një predikator, më finok se sivëllezërit e tij, të thërriste nga katedra: "Vëllezërit e mi të dashur, kurrë mos harroni, kur

të dëgjoni të lavdërohet progresi i diturisë, se dredhia më e bukur e djallit është që t'ju bindë se ai nuk ekziston!".

Kujtimi i këtij oratori të famshëm na shpuri natyrshëm drejt temës së shkollave, dhe miku im i çuditshëm më siguroi se shpeshherë denjonte të frymëzonte penën, fjalën dhe ndërgjegjen e pedagogëve, dhe se merrte vetë pjesë gati gjithmonë, ndonëse i padukshëm, në të gjitha mbledhjet akademike.

Duke marrë zemër nga gjithë kjo dashamirësi, e pyeta nëse kishte lajme nga Zoti dhe nëse e kishte parë gjë kohët e fundit. Ai m'u përgjigj me një moskokëçarje të ngjyruar lehtas me paksa trishtim: "Përshëndetemi kur takohemi rastësisht, por si dy xhentëllmenë të vjetër tek të cilët një edukatë e lindur nuk mund ta shuaj krejt, megjithatë, kujtimin e mërive të vjetra".

Më duket e dyshimtë që Madhëria e Tij t'i ketë kushtuar kaq shumë kohë ndonjë të vdekshmi tjetër të thjeshtë si unë, dhe më zuri shqetësimi se mos po e teproja. Më në fund, ndërsa agimi ngjethës zbardhonte qelqet e dritareve, ai personazh i famshëm, i kënduar nga aq shumë poetë dhe i shërbyer nga aq shumë filozofë, që pa e kuptuar punonin për lavdinë e tij, më tha: "Dua që të ruani nga unë një kujtim të mirë, dhe t'ju provoj që Unë, mbi të cilin thuhen aq shumë zezona, mund të bëhem ndonjëherë *djall i mirë*, për të përdorur një nga shprehjet tuaja të rëndomta. Për t'ju shpërblyer

humbjen e pandreqshme të shpirtit, po ju jap çmimin që do të kishit fituar po t'ju kishte ndihmuar fati, me fjalë të tjera, mundësinë për ta kaluar lehtë dhe për ta shëruar, gjatë gjithë jetës suaj, sëmundjen e çuditshme të Mërzisë, që është burimi i të gjitha të këqijave dhe përparimeve tuaja të kota. Kurrë nuk do të formuloni një dëshirë të cilën unë s'do t'ju ndihmoj ta sendërtoni; do të mbretëroni mbi sivëllezërit tuaj vulgarë, do të jeni i lajkatuar, madje edhe i adhuruar; argjendi, ari, diamantet, pallatet përrallorë do të vinë t'ju kërkojnë dhe do t'ju lutin që t'i pranoni, pa bërë as dhe përpjekjen më të vogël për t'i fituar; do të ndërroni atdhe dhe vise sa herë që t'jua kërkojë fantazia; do të deheni me ëndje, pa u lodhur, në vende të mrekullueshme, ku bën gjithnjë ngrohtë dhe ku gratë kundërmojnë si lulet, — e të tjera, e të tjera...", shtoi ai, duke u ngritur e duke më shoqëruar te porta me një buzëqeshje dashamirëse.

Po të mos kishte qenë frika se mund të poshtërohesha përpara gjithë asaj turme të madhe njerëzish, do të isha gjunjëzuar me kënaqësi në këmbët e këtij lojtari zemërgjerë për ta falenderuar për bujarinë e tij të padëgjuar. Por, pak nga pak, pasi u ndava me të, mosbesimi i pashërueshëm më përshkoi zemrën; nuk guxoja ta besoja një lumturi kaq të jashtëzakonshme dhe tek shtrihesha për të fjetur, duke thënë lutjet, sipas një zakoni të pakuptimtë që më kishte mbetur, ende përsërisja gjysmë në gjumë: "Zoti im! o Zoti im! bëj që djalli ta mbajë fjalën!"

XXX

Litari

Për Edouard Manet

"Iluzionet, — më thoshte miku im, — janë ndoshta po aq të panumërta sa ç'janë marrëdhëniet që njerëzit krijojnë ndërmjet tyre, ose me sendet. Dhe kur iluzioni venitet, domethënë kur ne shohim një njeri apo një fakt ashtu siç ai ekziston pavarësisht nga ne, kemi atëherë një ndjenjë të çuditshme, të përbërë sa nga keqardhja për fantazmën e zhdukur aq dhe nga befasimi i këndshëm përballë të vërtetës së re. Nëse ekziston një dukuri e qartë, e rëndomtë, që është gjithnjë e njëjtë dhe e një natyre që njihet menjëherë, është dashuria e nënës. Është po aq e vështirë të përfytyrosh një nënë pa dashuri mëmësore, sa një dritë pa ngrohtësi; a nuk do të ishte pra krejtësisht e përligjur që dashuria e nënës të shpjegojë të gjitha veprimet dhe fjalët e një nëne për fëmijën e saj? E megjithatë, dëgjoni këtë histori të shkurtër në të

cilën unë kam qenë veçanërisht i mashtruar nga iluzioni më i natyrshëm.

"Mjeshtëria e piktorit më shtyn t'i vështroj me kujdes fytyrat dhe fizionomitë që më dalin përpara, dhe ju e dini vetë se ç'kënaqësi na jep kjo pirje, që na bën të na duket jeta më e gjallë dhe më kuptimplote sesa iu duket të tjerëve. Në lagjen e largët ku unë banoj dhe ku pallatet janë ende të ndarë nga lëndina të gjera, më zinte shpesh syri një fëmijë, fizionomia veçanërisht çapkëne dhe e gjallë e të cilit më joshi që në fillim. Ai pozoi shpesh për mua, ndërsa unë e shndërroja herë në cigan të vogël, herë në ëngjëll, herë në Dashuri mitologjike. E kam bërë të mbante violinën e ciganit, Kurorën me Gjemba dhe Gozhda të Pasionit, dhe Pishtarin e Erosit. Dhe aq shumë më bëri për vete çapkënllëku i tij, saqë një ditë iu luta prindërve, njerëz të varfër, që të kishin mirësinë ta linin të banonte tek unë, duke iu premtuar se do ta mbathja siç i kishte hije, se do t'i jepja ca para dhe se nuk do ta detyroja të bënte punë tjetër veç pastrimit të penelave dhe pazarit. Kur e lau mirë fytyrën, djaloshi u bë shumë tërheqës dhe jeta që bënte tek unë i dukej si parajsë në krahasim me atë që do të kishte duruar në kasollen e prindërve. Vetëm se duhet të them që ky djalosh më habiti disa herë me ca kriza të çuditshme të një trishtimi te parakohshëm për moshën e tij. Shumë shpejt zunë t'i pëlqenin pamasë sheqernat dhe likeret aq sa një ditë, pasi kisha vënë re që megjithë paralajmërimet e mia ai prapë kishte bërë një

vjedhje të këtij lloji, e kërcënova se do ta dërgoja te prindërit e tij. Pastaj dola dhe punët që kisha për të bërë më morën mjaft kohë.

"Përfytyroni tmerrin dhe habinë time kur, duke hyrë në shtëpi, gjëja e parë që më ra në sy ishte djaloshi im i vogël, miku mistrec i jetës sime, i varur në panelin e këtij dollapit këtu! Këmbët gati i ciknin dyshemenë, një karrige, që me siguri ai e kishte shtyrë me këmbë, ishte përmbysur pranë tij, koka e tendosur nga ngërçi i varej mbi njërin sup, ndërsa fytyra e buhavitur dhe sytë e shqyer me një vështrim të ngulët rrëqethës, më dhanë në fillim iluzionin se ishte ende gjallë. Ta zbrisja që andej nuk ishte punë aq e lehtë. Ai ishte i ngrirë krejt ndërkohë, dhe mua më vinte një neveri e pashpjegueshme që ta lija të binte si thes përdhé. Duhej që ta mbaja të tërin me njërin krah, ndërsa me dorën tjetër t'i prisja litarin. Por kur kjo u bë, ende nuk mbaroi puna; përbindëshi i vogël kishte përdorur një spango të hollë që i ishte futur thellë në mish, dhe tani duhej që me një gërshërë të imët të gjeja litarin midis dy palave të enjtura për t'i çliruar qafën.

"Harrova t'ju them që kisha bërtitur me të madhe për ndihmë; por asnjëri prej fqinjëve nuk erdhi të më ndihmonte, duke i ndejtur kështu besnik zakonit të njerëzve të qytetëruar të cilët nuk duan në asnjë mënyrë, nuk e di sepse, të ngatërrohen me punët e një të varuri. Më në fund erdhi një mjek që deklaroi se fëmija kishte vdekur shumë orë më parë. Më vonë, kur na u desh ta zhvishnim për ta futur në

arkivol, ngurtësia e kufomës ishte e tillë saqë, duke mos ia dalë mbanë që t'ia përkulnim gjymtyrët, na u desh t'ia shqyenim dhe t'ia prisnim rrobat që të mund t'ia hiqnim.

"Shefi i policisë, të cilit, natyrisht, m'u desh t'i deklaroja aksidentin, më vështroi shtrembër dhe më tha: "E dyshimtë më duket kjo punë" i nxitur me siguri nga një dëshirë e rrënjosur thellë dhe nga zakoni profesional për t'i futur frikën kujt t'i dilte përpara, të pafajshmëve dhe fajtorëve.

"Mbetej një punë e rëndësishme për t'u bërë, dhe vetë mendimi më shkaktonte një ankth të tmerrshëm: duheshin lajmëruar prindërit. Nuk më bënin këmbët. Më në fund e pata dhe këtë kurajo. Por, për habinë time të madhe, nëna u tregua shumë gjakftohtë dhe asnjë lot nuk ia njomi cepin e syrit. E shpjegova këtë fakt të çuditshëm duke u përpjekur të përfytyroja lemerinë që ajo duhej të provonte, dhe m'u kujtua proverbi "Dhimbjet më të tmerrshme janë ato të heshturat". Ndërsa babai u mjaftua të thoshte me një pamje gjysmë të trullosur, gjysmë ëndërrimtare: "Fundja, ndoshta është më mirë kështu; sidoqoftë, ai keq do të kish përfunduar".

"Ndërkaq trupi ishte i shtrirë mbi divanin tim dhe, i ndihmuar nga një shërbëtore, unë merresha me përgatitjet e fundit, kur nëna e djalit hyri në atelie. Ajo donte të shihte, siç më tha, kufomën e të birit. Me të vërtetë që nuk mundja dot ta pengoja të dehej me fatkeqësinë e saj dhe të mos i lija këtë ngushëllim të fundit dhe të zymtë. Pastaj, ajo më

kërkoi t'i tregoja vendin ku ishte varur i biri. "Oh, jo zonjë, — iu përgjigja unë, kjo do t'ju shkaktonte tepër dhimbje". Dhe ndërsa padashur sytë më vajtën te dollapi i përmortshëm, vura re me një neveri të përzier me tmerr dhe zemërim, që gozhda kishte mbetur mbi derë dhe prej saj varej ende një copë e gjatë litari. Unë u vërsula me gjallëri për të shkulur ato mbeturina të fundit të tragjedisë, dhe teksa po bëhesha gati t'i hidhja nga dritarja, e gjora grua më zuri krahun dhe më tha me një zë që të këpuste shpirtin: "Oh zotëri, m'i jepni mua këto, ju lutem, ju përgjërohem!" Dëshpërimi, kështu m'u duk mua, do ta kishte tronditur kaq shumë, saqë tani ajo ndjente dhembshuri për ç'ka kishte qenë mjeti i vdekjes së të birit, dhe donte ta ruante si një relike të tmerrshme dhe të shtrenjtë. — Kështu ajo m'i mori gozhdën dhe spangon.

"Më në fund! Më në fund, gjithçka ishte kryer. S'më mbetej gjë tjetër veçse t'i vihesha përsëri punës, më me gjallëri se zakonisht, për të hequr nga mendja pak nga pak këtë kufomë të vogël që obsedonte skutat e trurit tim, dhe fantazma e të cilës më lodhte duke më vështruar me sytë e saj të ngurosur. Por të nesërmen mora një paketë me letra: disa prej banuesve të pallatit, të tjerat prej pallateve fqinjë; njëra prej katit të parë, tjetra prej të dytit, tjetra prej të tretit, dhe kështu me radhë; disa ishin shkruar në një stil gjysmë zbavitës, si të donin të fshihnin nën një shaka të sipërfaqshme sinqeritetin e kërkesës; kishte të tjera që ishin krejt të

paturpshme dhe të shkruara me gabime, por të gjitha kishin të njëjtin qëllim: të më merrnin një copë nga i bekuari litar zindjellës. Midis autorëve kishte, duhet ta them, më shumë gra sesa burra; por jo të gjithë, besoëni, i përkisnin klasës së ulët dhe të rëndomtë. I kam ruajtur ato letra.

"Dhe atëherë, papritmas, gjithçka u bë e qartë në mendjen time dhe kuptova përse nëna donte aq shumë të ma rrëmbente litarin dhe se me çfarë allishverishesh ajo kishte ndërmend të ngushëllohej".

XXXI

Prirjet

Në një kopsht të bukur, ku rrezet e diellit vjeshtor dukeshin sikur jua kishte ënda të vonoheshin në qejf të tyre, nën një qiell tashmë të gjelbëremë, ku re të arta endeshin si të ishin kontinente në udhëtim, katër fëmijë të bukur, katër çunakë, me siguri të lodhur nga loja, bisedonin mes tyre.

Njëri thoshte: "Dje më çuan në teatër. Në pallate të mëdhenj dhe të trishtuar, prapa të cilëve duket deti dhe qielli, burra dhe gra, seriozë dhe të trishtuar edhe ata, por shumë më të bukur dhe më mirë të veshur se sa njerëzit që shohim zakonisht, flasin me një zë melodioz. Kërcënohen, përgjërohen, hidhërohen, dhe e shpien shpesh dorën te një kamë që iu varet në brez. Ah sa bukur që ishte! Gratë janë shumë më të hijshme dhe më të gjata se ato që vijnë vizitë në shtëpi, dhe, ndonëse sytë e tyre të

mëdhenj e të zgavërt dhe faqet e përflakura iu japin një pamje të tmerrshme, është e pamundur të mos i duash. Ke frikë, të vjen të qash, dhe megjithatë ndjehesh i kënaqur... Dhe pastaj, më e çuditshmja është që kjo të jep dëshirën të vishesh si ata, të thuash dhe të bësh të njëjtat gjëra, të flasësh me të njëjtin zë..."

Njëri nga fëmijët, i cili kishte ca çaste që nuk e dëgjonte më shokun dhe vëzhgonte me një ngulmim të habitshëm nuk e di se ç'pikë të qiellit, tha papritur: "Vështroni, vështroni atje tutje...! A *e* shihni? Është ulur mbi atë renë e vogël e të vetmuar, atë renë e vogël ngjyrë zjarri që lëviz ngadalë. Duket sikur edhe *Ai* po na vështron".

"Po për kë e ke fjalën? pyetën të tjerët.

"Zoti!" u përgjigj ai më një ton përsosmërisht të vendosur. "Oh, tani u largua; pas pak s'do mund ta shikoni më. Me siguri që udhëton për të vizituar të gjitha vendet. Shikoni, do të kalojë prapa atyre pemëve që janë afër horizontit... dhe tashti po zbret prapa kambanares... Ah, nuk duket më!". Dhe fëmija ndenji për një kohë të gjatë i kthyer nga i njëjti drejtim, duke ngulur mbi vijën që ndan tokën nga qielli ca sy ku ndriste një shprehje e jashtëzakonshme ekstaze dhe keqardhjeje.

"Sa budalla që është dhe ky me atë Zotin e tij që veç ai na e shikoka!" tha atëherë i treti, qenia imcake e të cilit kishte një gjallëri dhe shpuzë të veçantë. "Unë do t'ju tregoj diçka që s'ju ka ndodhur kurrë, dhe që është ca më tërheqëse sesa

teatri apo retë tuaja. — Ka disa ditë, prindërit më morën me vete në një udhëtim, dhe në bujtinën ku ndaluam, meqenëse nuk kishte shtretër për të gjithë, më vunë të flija në të njëjtin shtrat me guvernanten time". — Ai i tërhoqi shokët pranë vetes dhe filloi të fliste me zë më të ulët. — "Është një ndjesi e çuditshme, pranojeni, që të gjendesh në shtrat me guvernanten tënde, në errësirë. Ngaqë s'më zinte gjumi, u argëtova, ndërsa ajo flinte, duke prekur krahët, qafën dhe supet. Krahët dhe qafën i kishte shumë më të bëshme se të gjitha gratë e tjera, dhe lëkurën e kishte aq të lëmuar, aq të lëmuar, si të ishte letër shkrimi, ose letër mëndafshi. Ishte aq qejf, sa do të kisha vazhduar gjatë kështu po të mos kisha patur frikë; e para, frikë se mos e zgjoja, por ndieja edhe një si tjetër frikë të panjohur. Pastaj e futa kokën në flokët e saj që i derdheshin mbi shpinë, të dendura si një krifë, dhe që mbanin një erë po aq të mirë, ju betohem, sa lulet e kopshtit në këtë orë. Provojeni, kur t'ju jepet rasti, të bëni kështu si unë dhe do ta shihni!"

Autori i ri i këtij zbulimi të mahnitshëm, ndërsa tregonte, i kishte zgurdulluar sytë nga një lloj çmeritje ndaj asaj që ndjente ende, dhe rrezet e diellit në perëndim, duke rrëshkitur përmes kaçurrelave kuqëse e të shpupurisura, i krijonin rreth kokës një si aureolë sulfurore pasioni. Ishte e lehtë të merrej me mend që ai nuk do ta humbte kohën duke kërkuar Zotin nëpër re, por do ta gjente shpesh diku tjetër.

Më në fund foli dhe i katërti: "Ju e dini që unë nuk zbavitem fare në shtëpi; nuk më shpien kurrë në shfaqje, tutori im është tepër koprac; Zoti nuk merret me mua dhe mërzinë time, dhe unë nuk kam as një guvernante të bukur që të më përkëdhelë. Shpesh më duket se do të më pëlqente të ecja përpara, gjithnjë drejt, pa e ditur se ku, pa patur njeri që mund të shqetësohej për mua, dhe të vizitoja gjithnjë vende të reja. Kurrë nuk ndihem mirë askund, dhe gjithmonë më duket sikur do të isha më mirë në atë vend ku nuk jam. E pra, në panairin e fundit të fshatit fqinj, pashë tre burra që bënin atë jetë që dua unë. Ju të tjerët nuk i vutë re. Ata ishin të gjatë, të zeshkët dhe shumë krenarë, ndonëse të rreckosur, me një pamje që linte përshtypjen se nuk ia kishin nevojën njeriut. Sytë e tyre të mëdhenj dhe të errët ndriçoheshin krejt kur luanin muzikë, një muzikë të çuditshme që herë të jep dëshirën të kërcesh, herë të qash, ose të dyja në të njëjtën kohë, dhe që të krijon përshtypjen se mund të ikje nga mendtë e kokës po ta dëgjoje tepër gjatë. Njëri prej tyre, tek sa prekte me hark violinën e tij, dukej se shprehte një vuajtje, dhe tjetri, ndërsa i binte me një çekiçth tastierave të një pianoje të vogël që i varej në qafë me një rrip lëkure, dukej sikur tallej me përqarjet e shokut të tij; kurse i treti i përplaste herë pas here cimbalet e tij me një furi të jashtëzakonshme. Ishin kaq të kënaqur me veten, saqë vazhduan t'i bien muzikës së tyre primitive edhe pasi turma u shpërnda. Në fund mblodhën

kacidhet që njerëzit iu kishin dhënë, ngarkuan trastat mbi shpinë dhe u larguan. Unë desha të merrja vesh se ku jetonin dhe i ndoqa për së largu, deri në buzë të pyllit, dhe vetëm atëherë kuptova që ata nuk banonin kurrkund.

Njëri prej tyre tha: "A ta hapim tendën?".

"Jo për besë!" u përgjigj tjetri, "nata është kaq e bukur!"

I treti thoshte, ndërsa numëronte fitimet: "Këta njerëzit e këtushëm nuk e ndiejnë fare muzikën, dhe gratë e tyre kërcejnë si arinj. Fatmirësisht, pas një muaji do të jemi në Austri, ku njerëzit janë më të përzemërt".

"Ndoshta do të bënim më mirë të shkonim drejt Spanjës, meqenëse stina po kalon; të ikim përpara se të fillojnë shirat, dhe të mos lagim gjë tjetër përveç gurmazit", tha njëri nga dy të tjerët.

"Siç e shihni, mbaj mend gjithçka. Pastaj, pasi pinë nga një gotë raki, ranë të flenë me fytyrë drejtuar nga yjet. Në fillim më erdhi t'i lusja të më merrnin me vete dhe të më mësonin t'iu bija veglave të tyre; por nuk guxova, pa dyshim sepse është gjithnjë shumë e vështirë të marrësh një vendim për çfarëdo qoftë, dhe veç kësaj, sepse kisha frikë se do më kapnin pa dalë ende nga Franca".

Pamja mospërfillëse e tre djelmoshave të tjerë më bëri të mendoja që ky fëmijë ishte që tani *i pakuptuar* prej askujt. E vështrova me vëmendje; kishte në sytë dhe ballin e tij diçka të parakohshme fatale, që nuk ngjallte simpati, por që, nuk e di

sepse, e ndezi timen në atë pikë saqë për një çast, pata idenë e çuditshme se mund të kisha një vëlla që ende nuk e njihja.

Dielli perëndoi. Nata solemne ra kudo. Fëmijët u ndanë, duke shkuar secili, pa e ditur as vetë, sipas rrethanave dhe rastësisë, drejt fatit të vet, për të skandalizuar të afërmit dhe për t'u joshur prej turpit a lavdisë.

XXXII

Tirsi

Për Franz Liszt-in

Çfarë është tirsi? Në kuptimin moral dhe poetik të fjalës, është një emblemë fetare në dorën e atyre priftërinjve dhe priftëreshave që i thurin lavde perëndisë të cilës i shërbejnë dhe i zbërthejnë kumtet. Por në të vërtetë, s'është veçse një shkop, një shkop i thjeshtë, një purtekë kulprash, një mbështetëse vreshtash, i thatë, i fortë dhe i drejtë. Rreth e rrotull këtij shkopi, duke formuar dredha kapriçioze, lodrojnë dhe harbohen kërcyej dhe lule, disa dredharakë si vëthë, të tjera të varura si zile apo si kupa të përmbysura. Dhe një lavdi e habitshme shpërthen nga ky gërshetim vijash dhe ngjyrash, të ëmbla ose verbuese. A nuk duket sikur vija e lakuar dhe spiralja i bëjnë korte vijës së drejtë dhe i kërcejnë përqark me një adhurim të heshtur? A nuk duket sikur të gjitha këto kurora dhe kupa lulesh të brishta, shpërthime aromash dhe ngjyrash,

kërcejnë një fandango[1] mistike rrotull shkopit të shenjtë? Po kush është ai i vdekshëm i pakujdesshëm që do guxojë të gjykojë nëse lulet dhe pjergullat janë krijuar për shkopin, apo nëse shkopi është vetëm një shkas për të treguar bukurinë e pjergullave dhe luleve? Tirsi është mishërimi i dyzimit tuaj të habitshëm, mjeshtër i plotfuqishëm dhe i adhuruar, Bacchant i dashur i Bukurisë së mistershme dhe të pasionuar. Kurrë ndonjëherë një nimfë e nxitur nga Bacchus-i i pamposhtur nuk e ka shkundur tirsin, mbi kokat e shoqeve të saj të marrosura, me energjinë dhe fantazinë me të cilën ju tundni gjeninë tuaj mbi zemrat e sivëllezërve. Shkopi, i drejtë, i fortë dhe i palëvizshëm, përfaqëson vullnetin tuaj; lulet janë shëtitja e fantazisë tuaj rreth vullnetit, elementi femëror që kryen rreth mashkullit piruetat e tij të mrekullueshme. Vijë e drejtë dhe vijë arabeske, qëllim dhe shprehje, ngurtësi e vullnetit, dredhë e fjalës, unitet synimi, larmi mënyrash, përzierje e plotfuqishme dhe e pandashme e gjenisë, cili kritik do të ketë kurajon e urryer që t'ju veçojë dhe t'ju ndajë?

I dashur Liszt, përmes mjegullave, përtej lumenjve, sipër qyteteve ku pianot i bien lavdisë suaj, ku shtypshkronjat përkthejnë mençurinë tuaj, në çfarëdo vendi që të ndodheni, në mrekullirat e qytetit të pavdekshëm apo në mjegullnajat e atyre

1. Valle spanjolle.
2. Personazh mitik, i lidhur me shpikjen e birrës.

viseve ëndërruese që i ngushëllon Cambrinusi[2], nëse jeni duke kompozuar këngë kënaqësie apo dhimbjeje të parrëfyeshme, apo duke i besuar letrës së bardhë mendimet tuaja të pakapshme, psalm i Kënaqësisë dhe i Ankthit të përjetshëm, filozof, poet dhe artist, ju përshëndes në pavdekësi!

XXXIII

Dehuni pareshtur

Duhet të jeni gjithnjë të dehur. Kjo është e gjitha; e vetmja gjë e rëndësishme. Për të mos e ndjerë barrën e tmerrshme të Kohës që të dërrmon shpatullat e të përkul shpinën, duhet të deheni pareshtur.

Po me se? Me verë, me poezi ose me virtyt, si t'jua dojë zemra. Por vetëm dehuni.

Dhe nëse ndonjëherë, në shkallët e një pallati, mbi barin e gjelbër të një hullie, apo në vetminë e zymtë të dhomës tuaj, iu ndodh që të zgjoheni, pasi dehja ka rënë ose është zhdukur krejt, pyesni erën, valën, yllin, zogun, orën e murit, çdo gjë që fluturon, që rënkon, që rrokulliset, që këndon, që flet, pyetini sa është ora; dhe era, vala, ylli, zogu, ora e murit, do t'ju përgjigjen: "Është ora që të deheni! Për të mos qenë skllevërit e martirizuar të Kohës, dehuni; dehuni pareshtur! Me verë, me poezi ose me virtyt, si t'jua dojë zemra!".

XXXIV

Kaq shpejt!

Njëqind herë tashmë dielli kish dalë, i qeshur ose i trishtuar, nga govata e pamasë e detit, brigjet e të cilit mezi duken; njëqind herë ai ishte rizhytur, vezullues ose i zymtë, në banjon e tij të pamasë mbrëmësore. Kishim ditë që soditnim anën tjetër të qiellit dhe zbërthenim alfabetin e antipodeve. Dhe të gjithë pasagjerët ofshanin dhe ankoheshin, thuajse afrimi i tokës e acaronte edhe më shumë dhimbjen e tyre. "Kur pra, thoshin ata, do të mund të flemë pa u troshitur nga valët e detit, pa u shqetësuar nga era që gërhin më fort se ne? Kur do të mund të hamë ca mish që nuk është i kripur si elementi i urryer që na mbart? Kur do të mund të tresim ushqimin në një kolltuk që nuk tundet e shkundet?".

Kishte ca që iu vente mendja te vatra, që i merrte malli për gratë e tyre të pabesa e turivarura dhe për

pjellën e tyre qaramane. Të gjithë e kishin humbur mendjen aq shumë nga pamja e tokës që nuk dukej, saqë mendoj se do të kishin ngrënë bar me më shumë ëndje sesa bagëtia.

Më në fund, që larg u shfaq një breg; dhe ndërsa i afroheshim, pamë se ishte një tokë me një bukuri të madhërishme, mahnitëse. Dukej sikur melodité e jetës buronin prej saj si një murmurimë e lehtë, dhe sikur brigjet lëshonin deri larg një aromë të mrekullueshme lulesh dhe frutash.

Menjëherë, të gjithëve iu hypi gëzimi dhe i harruan pakënaqësitë. Të gjitha grindjet pushuan, të gjitha fajet e ndërsjellta u falën; dyluftimet që ishin vendosur u shuan nga kujtesa dhe mëritë fluturuan si të ishin tym.

Vetëm unë isha i trishtuar, i trishtuar në një shkallë të papërfytyrueshme. Si një prift të cilit i shkulin hyjninë e tij, nuk mundesha, pa një hidhërim të pikëlluar, të shkëputesha nga ky det aq përbindsh-mërisht tërheqës, nga ky det aq pafundësisht i larmishëm në thjeshtësinë e tij të frikshme, dhe që duket sikur përmban në vetvete me lojërat, pamjet, zemërimet dhe buzëqeshjet e tij, tiparet, agonitë dhe përndezjet e të gjitha shpirtrave që kanë jetuar, që jetojnë dhe që do të jetojnë!

Ndërsa i thosha lamtumirë kësaj bukurie të pakrahasueshme, ndjehesha i dërrmuar për vdekje; ja përse, kur gjithkush nga bashkudhëtarët e mi tha "Më në fund!", unë nuk munda të thërras veçse "*Kaq shpejt!*".

E megjithatë ishte toka, toka me zhurmat, pasionet, prehjen dhe festat e saj; ishte një tokë e pasur dhe e mrekullueshme, plot premtime, që na dërgonte një aromë misterioze trëndafilash dhe myshku, dhe nga e cila melodité e jetës mbërrinin deri tek ne si një murmurimë të dashuruarish.

XXXV

Dritaret

Ai që vështron nga jashtë përmes një dritareje të hapur, nuk shikon kurrë aq shumë gjëra sa ai që vëren me vëmendje një dritare të mbyllur. Nuk ka gjë më të thellë, më misterioze, më të pasur, më turbulluese, më joshëse sesa një dritare e ndriçuar nga një qiri. Ajo që mund të shohësh në dritë të diellit është gjithmonë më pak interesante se ato çka ndodhin pas një xhami. Brenda kësaj vrime të errët ose plot dritë jeton jeta, ëndërron jeta, vuan jeta.

Përtej valëve të pullazëve, më zënë sytë një grua të pjekur, tërë rrudha tashmë, të varfër, gjithnjë të përkulur mbi diçka, dhe që nuk del kurrë jashtë. Me fytyrën e saj, veshjen, lëvizjet, pra me pothuajse asgjë, unë kam rindërtuar historinë e kësaj gruaje, ose më saktë legjendën e saj, dhe herë pas here ia rrëfej vetes duke qarë.

Edhe po të kish qenë një plak i varfër, do t'i kisha rikrijuar një histori po aq lehtë.

Dhe kështu shkoj të shtrihem, duke u ndjerë krenar që kam jetuar dhe vuajtur brenda njerëzve të tjerë, jashtë vetes sime.

Ndoshta ju do të më pyesnit: "A je i sigurt që kjo legjendë i përgjigjet të vërtetës?" Po ç'rëndësi ka se si është realiteti që ndodhet jashtë meje, në qoftë se ai më ka ndihmuar që të jetoj dhe të ndiej jo vetëm që jam, por edhe kush jam.

XXXV

Dëshira për të pikturuar

Fatkeq është ndoshta njeriu, por i lumtur është artisti i sfilitur nga pasioni!

Digjem nga dëshira për të pikturuar atë që më është shfaqur aq rrallë dhe që është tretur aq shpejt, si diçka e bukur e penglënëse, e mbetur pas udhëtarit që e merr nata me vete. Sa kohë ka kaluar ndërkaq qysh nga zhdukja e saj!

Ajo është e bukur, më tepër se e bukur; ajo është befasuese. Tek ajo mbretëron e zeza: dhe gjithçka që ajo frymëzon është e errët dhe e thellë. Sytë e saj janë dy shpella në të cilat xixëllon turbull misteri, dhe vështrimi i saj ndriçon si një rrufe: është një shpërthim në mes të territ.

Do ta krahasoja me një diell të zi, në qoftë se do të ishte e mundur të përfytyrohej një yll i zi nga i cili buron dritë e lumturi. Por ajo të sjell më tepër ndërmend hënën, që pa dyshim i ka lënë gjurmë

me ndikimin e saj të frikshëm; jo atë hënën e bardhë të idileve që i shëmbëllen një nuseje të ftohtë, por një hënë ogurzezë e dehëse, të varur në thellësirat e një nate me stuhi dhe të troshitur nga retë që vrapojnë; jo atë hënën paqësore që viziton fshehtazi gjumin e njerëzve të dëlirë, por një hënë të shkulur nga qielli, të mundur e gjithë mllef, që Shtrigat tesaliane e detyrojnë me forcë të vallëzojë mbi barin e tmerruar.

Në ballin e saj të vogël spikatin vullneti i patundur dhe etja për prenë. Megjithatë, në pjesën e poshtme të kësaj fytyre kaq shqetësuese, flegrat e të cilës thithin të panjohurën dhe të pamundurën, shpërthen me një hir të papërshkrueshëm e qeshura e një goje të gjerë, të kuqe e të bardhë, fort të hijshme, që i shëmbëllen mrekullisë së një luleje të mahnitshme që ka çelur mbi tokën vullkanore.

Ka disa gra që të ndjellin tundimin që t'i mposhtësh e të kënaqesh me to; ndërsa një e tillë si kjo të zgjon dëshirën që të vdesësh ngadalë nën vështrimin e saj.

XXXVII

Bamirësitë e hënës

Hëna, si trillane që është, të vështroi që nga dritarja, tek flije në djep, dhe tha me vete: "Ky fëmijë më pëlqen".

Pastaj zbriti butë-butë shkallën e saj prej resh dhe u fut brenda pa u ndjerë, nëpërmjet xhamave. U shtri mbi ty me dhembshurinë e epshme të një nëne dhe shpalosi ngjyrat e saj mbi fytyrën tënde. Ja sepse sytë të mbetën të gjelbër, ndërsa faqet jashtëzakonisht të zbehta. Ishte soditja e kësaj vizitoreje që i bëri sytë e tu kaq çuditërisht të mëdhenj; dhe ajo të shtrëngoi kaq ëmbëlsisht në grykë, saqë qysh atëherë, ty s'tu nda më dëshira për të qarë.

Megjithatë, në shpërthimin e gëzimit të saj, Hëna mbushte krejt dhomën si një atmosferë fosforeshente, si një helm shndritës; dhe e gjithë kjo dritë plot jetë mendonte dhe thoshte: "Ti do ta

ndjesh përjetë ndikimin e puthjes time. Ti do të jesh e bukur sipas mënyrës time. Ti do të duash ç'ka dua unë dhe ç'ka më do mua: ujin, retë, heshtjen dhe natën; detin e pafund dhe të gjelbër, ujin e patrajtë dhe të shumëtrajtshëm; vendet ku s'do të jesh; të dashurin që s'do ta njohësh; lulet e përbindshme; parfumet që të bëjnë të përçartësh; macet që shtriqen mbi piano dhe që rënkojnë si gratë, me një zë të ngjirur e të ëmbël!

"Dhe ti do të dashurohesh nga të dashurit e mi, do të adhurohesh nga adhuruesit e mi. Ti do të jesh mbretëresha e burrave me sy të gjelbër, grykën e të cilëve e kam shtrënguar gjatë përkëdheljeve të mia nëpër netë; mbretëresha e atyre që duan detin, detin e pafund, të shqetësuar e të gjelbër, ujin e patrajtë dhe të shumëtrajtshëm, vendet ku nuk janë, gruan që nuk e njohin, lulet ogurzeza që iu ngjajnë temjanicave të një feje të panjohur, parfumet që turbullojnë mendjen, dhe kafshët e egra dhe epshore që janë emblemat e çmendurisë së tyre".

Ja pra pse tani, unë gjendem i shtrirë te këmbët e tua, e nëmura dhe e shtrenjta fëmija ime e përkëdhelur, duke kërkuar në të gjithë qenien tënde ndikimin e Hyjnisë së frikshme, e ndrikullës fatale, e mëndeshës helmuese të të gjithë njerëzve *me hënë*.

XXXVIII

Cila është Benedikta e vërtetë?

Kam pasë njohur dikur një farë Benedikta, që e mbushte ajrin me ideal, sytë e së cilës rrezatonin dëshirën për madhështi, bukuri, lavdi dhe gjithçka tjetër që të shtyn të besosh në pavdekësi.

Por kjo vajzë e mrekullueshme ishte tepër e bukur për të jetuar gjatë; kështu ajo vdiq disa ditë pasi e kisha njohur, dhe qeshë unë vetë që e varrosa, një ditë kur pranvera tundte temjanicën e vet deri edhe në varreza. Qeshë unë që e varrosa, të mbyllur mirë në një tabut prej druri të parfumuar e të pakalbshëm, që u shëmbëllente arkëzave të stolisura indiane.

Dhe ndërsa sytë nuk më ndaheshin prej vendit ku qe groposur thesari im, papritmas pashë një grua të vogël që kishte një ngjashmëri të habitshme me të ndjerën, dhe që, ndërsa rrihte me këmbë, me një egërsi të çuditshme prej të marri, dheun e

posagërmuar, thoshte duke ia plasur gazit: "Jam unë Benedikta e vërtetë! Unë, një fundërrinë me nam! Dhe si ndëshkim për çmendurinë dhe verbimin tënd, ti do të më duash kështu siç jam!".

Por unë, si i ndërkryer, iu përgjigja: "Jo! jo! jo!". Dhe për të theksuar më fort revoltën time, përplasa këmbën në tokë me kaq forcë, saqë ajo u zhyt gjer në gju në gropën e posambyllur, dhe kështu, si një ujk i kapur në kurth, qëndroj i mbërthyer, përgjithmonë ndoshta, në varrin e idealit.

XXXIX

Një kalë race

Ajo është mjaft e shëmtuar! E megjithatë, shumë e këndshme!

Koha dhe Dashuria i kanë lënë shenja me kthetrat e tyre dhe i kanë mësuar mizorisht që çdo minutë e çdo puthje rrëmben me vete rini dhe freski.

Ajo është me të vërtetë e shëmtuar; ajo është milingonë, merimangë, nëse ju pëlqen, madje skelet; por ajo është gjithashtu pije çudibërëse, bar shërues, magji! me një fjalë ajo është e mrekullueshme.

Koha nuk ka mundur t'ia prishë harmoninë vezulluese të të ecurit, as elegancën e pashkatërrueshme të trajtave. Dashuria nuk e ka ndryshuar dot ëmbëlsinë e frymës së saj fëminore dhe Koha nuk e ka pakësuar aspak floknajën e saj të dendur, e cila përhap me parfumet e saj të egra të gjithë gjallërinë e vrullshme të Jugut të Francës:

Nîmes, Aix, Arles, Avignon, Narbonne, Toulouse, qytete të bekuara nga dielli, të përzemërta e gjithë hijeshi!

Koha dhe Dashuria më kot e kanë kafshuar gjithë ëndje: ato s'ia kanë pakësuar aspak hirin e papërcaktuar, por të përhershëm, të gjoksit të saj djaloshar.

E harxhuar ndoshta, por jo e lodhur, dhe gjithmonë heroike, ajo të kujton ata kuajt prej race të mirë që syri i një amatori të vërtetë i njeh menjëherë, edhe kur ata janë të mbrehur në një pajton të marrë me qera apo në ndonjë qerre të rëndë.

Pastaj ajo është aq e ëmbël dhe e zjarrtë! Ajo dashuron ashtu siç dashurojnë njerëzit në vjeshtë; thua se afrimi i dimrit ndez në zemrën e saj një zjarr të ri, dhe përkushtimi i saj i dhembshëm nuk është kurrë i lodhshëm.

XL

Pasqyra

Një burrë tmerrësisht i shëmtuar hyn dhe qëndron përpara pasqyrës.

"—Përse shikoheni në pasqyrë, kur e dini që kjo gjë s'mund t'ju japë veçse pakënaqësi?"

Burri tmerrësisht i shëmtuar më përgjigjet: "—Zotëri, sipas parimeve të pavdekshme të '89-ës[1], të gjithë njerëzit kanë të drejta të barabarta; pra edhe unë kam të drejtën time të sodit veten në pasqyrë; me kënaqësi apo pa kënaqësi, kjo ka të bëjë vetëm me ndërgjegjen time."

Në emër të logjikës, unë kisha pa dyshim të drejtë; por në emër të ligjit, ai s'e kishte gabim.

1. E ka fjalën për Deklaratën e të Drejtave të Njeriut të Revolucionit francez të 1789-ës.

XLI

Porti

Porti është një vendqëndrim fort i këndshëm për një shpirt të lodhur nga mundimet e jetës. Gjerësia e qiellit, arkitektura e paqëndrueshme e reve, ngjyrat e ndryshueshme të detit, xixëllima e fareve, krijojnë një prizëm të mrekullueshëm për të zbavitur sytë pa i lodhur kurrë. Trajtat e hajthshme të anijeve, me velat dhe pajisjet e tyre të ndërlikuara, të cilat luhaten harmonishëm nga lëkundjet e valëve, shërbejnë për t'i ushqyer shpirtit ndjenjën e ritmit dhe të bukurisë. E mbi të gjitha këto, për atë që nuk ka më as kureshtje, as ambicje, ekziston një lloj kënaqësie misterioze dhe aristokrate: kënaqësia e të soditurit, tek qëndron i shtrirë në belvedere ose me bërrylat e mbështetur mbi molo, të gjithë asaj morije lëvizjesh të atyre që nisen e të atyre që mbërrijnë, të atyre që kanë ende fuqi të dëshirojnë, të udhëtojnë apo të pasurohen.

XLII

Portrete të dashurash

Në një buduar burrash, domethënë një kthinë shtëpie bixhozi elegante ku pihet duhan, katër zotërinj tymosnin cigare dhe pinin. Nuk mund t'i quaje as të rinj as të vjetër, as të pashëm as të shëmtuar; por pavarësisht nga mosha në fytyra iu dallohej shenja e pagabueshme e veteranëve të gëzimit, ajo nuk-e-di-se-çfarë e papërshkrueshme, ai trishtim i ftohtë dhe tallës që le të kuptohet qartë se: "ne kemi patur një jetë të pasur dhe tani kërkojmë diçka që të mund ta duam e ta çmojmë".

Njëri prej tyre e solli fjalën te gratë. Do të kishte qenë më filozofike që të mos flitej fare për këtë temë, por edhe njerëzit me mend, pasi kanë pirë mirë, nuk i përbuzin bisedat e rëndomta. Në çaste të tilla njerëzit e dëgjojnë atë që flet siç dëgjohet një muzikë vallëzimi.

"Të gjithë burrat, po thoshte ai, kanë patur

moshën e Kerubinit[1]: kjo është periudha kur në pamundësi për të gjetur nimfa pyjesh, nuk të vjen neveri të puthësh edhe trungje dushqesh. Kjo është shkalla e parë e dashurisë. Në fazën e dytë fillon të zgjedhësh, dhe këtu fillon dekadenca. Është periudha kur burri kërkon me të vërtetë bukurinë. Për sa më përket mua, zotërinj, jam krenar për faktin që prej kohesh tashmë, kam arritur në periudhën klimaterike të fazës së tretë, kur edhe bukuria vetë nuk mjafton më në qoftë se nuk është e shoqëruar nga parfumet, stolirat e të tjera gjëra. Madje do të thosha që disa herë, dëshiroj me gjithë shpirt, ashtu siç dëshirohet një lumturi e panjohur, ekzistencën e një faze të katërt, që do të ishte ajo e qetësisë absolute. Por gjatë gjithë jetës sime, me përjashtim të periudhës kur kisha moshën e Kerubinit, kam qenë më i ndjeshëm se askush ndaj marrëzisë nervozuese dhe mediokritetit acarues të grave. Ajo çka më pëlqen më shumë te kafshët është dëlirësia e tyre. Përfytyroni pra, sa shumë më ka bërë të vuaj mikesha ime e fundit.

"Ishte fëmija jashtë martese e një princi. Kuptohet vetiu që ishte e bukur; po të mos kish qenë e tillë, përse do ta kisha zgjedhur? Por ajo e prishte këtë cilësi kaq të rëndësishme me një ambicje të pahijshme e shëmtuese. Ishte një grua që kishte gjithnjë maninë të hiqej si burrë. "Ju s'jeni burrë! Ah sikur të isha burrë! Nga ne të dy, burri

1. Personazh i komedisë së Beaumarchais *Martesa e Figaros*, i cili simbolizon zgjimin e parë të adoleshentit ndaj dashurisë.

jam unë!" Të tilla ishin refrenet e padurueshme që dilnin nga ajo gojë, nga e cila nuk do të kisha dashur të dëgjoja gjë tjetër përveç këngëve. Kur shprehja admirimin tim për ndonjë libër, poemë apo opera, aty për aty ajo ma kthente: "Ju ndoshta mendoni që kjo është vërtet e fuqishme? Po a e dini ju se ç'është madhështia?" dhe fillonte debatin mbi këtë çështje.

"Një ditë të bukur filloi të merrej me kimi dhe qysh atëhere unë fillova të ndiej një maskë qelqi midis buzëve tona. Përveç të gjitha këtyre, hiqej dhe si e turpshme. Kur unë guxoja të bëja ndonjë gjest pak si tepër të dashuruar, ajo tkurrej si të ishte një lule mos-më-prek...

— E si përfundoi e gjitha kjo? tha njëri nga tre të tjerët. Nuk ju dija kaq të duruar.

— Zoti, vazhdoi ai, ia gjeti shërimin të keqes. Një ditë e gjeta Minervën time, aq të etur për madhështi e ideal, kokë më kokë me shërbëtorin tim, në një gjendje të atillë që u detyrova të tërhiqesha pa u ndjerë për të mos i bërë të skuqeshin. Po atë mbrëmje i përzura të dy duke i paguar secilit atë që i takonte.

—Në rastin tim, mori fjalën sërish ai që e kishte ndërprerë pak më parë, unë s'mund t'i vë faj njeriu tjetër veç vetes sime. Lumturia erdhi të strehohej tek unë dhe unë s'arrita ta njoh. Këto kohët e fundit fati më kishte dhuruar një grua, e cila ishte pa dyshim më e ëmbla, më e nënshtruara dhe më e devotshmja qenie e kësaj bote. Gjithmonë e

gatshme! dhe pa asnjë entuziazëm! "Me gjithë qejf, në qoftë se kjo ju jep kënaqësi" — kjo ishte përgjigjia e saj e zakonshme. Po t'i jepnit murit apo kanapesë një dru të mirë, ata do të nxirrnin me siguri më shumë rënkime sesa ç'nxirrnin vrundujt e dashurisë më të zjarrtë nga gjoksi i së dashurës sime. Pas një viti jete të përbashkët, më pohoi që s'e kishte njohur kurrë kënaqësinë. Ky dyluftim i pabarabartë m'u zvetënit atëherë, dhe ajo vajzë e pakrahasueshme u martua. Kohë më pas, më shkoi mendja ta rishikoja dhe ajo më tha, duke më treguar gjashtë fëmijë të bukur: "Miku im i dashur, gruaja e martuar është po aq *e virgjër* sa ç'ishte e dashura juaj". Asgjë s'kishte ndryshuar tek ajo femër. Herë pas here më vjen keq që e humba; duhej të isha martuar me të".

Të tjerët filluan të qeshin dhe fjalën e mori një i tretë:

"Zotërinj, unë kam njohur kënaqësira që ndoshta ju i keni shpërfillur. Dua të flas për anën komike të dashurisë, por të një komiku që nuk e përjashton adhurimin. Unë e kam adhuruar të dashurën time të fundit më shumë, mendoj, sesa ju keni dashur apo urryer tuajat. Dhe të gjithë e adhuronin po aq sa unë. Kur hynim në një restorant, pas disa minutash çdokush harronte të hante për ta soditur. Kamarierët vetë, apo gruaja që rrinte te banaku, e ndjenin këtë përndezje ngjitëse që i bënte të harronin shërbimin. Për t'i rënë shkurt, kam jetuar për disa kohë vetëm për vetëm me një *fenomen* të

gjallë. Ajo hante, përtypej, bluante, gllabëronte, gëlltiste, por me pamjen më të qetë dhe të shkujdesur që mund të ekzistojë. Më ka mbajtur kështu në ethe për një kohë të gjatë. Kishte një mënyrë të ëmbël, ëndërrimtare, angleze dhe romaneske të të thënit "Kam uri!". Dhe i përsëriste këto fjalë ditë e natë duke treguar dhëmbët më të bukur në botë, që ju mallëngjenin dhe ju zbavitnin në të njëjtën kohë. Mund të kisha bërë tërë atë pasuri duke e treguar nëpër panaire si *një përbindësh që ha çdo gjë*. Unë e ushqeja mirë; e megjithatë ajo më braktisi... — Për ndonjë furnizues ushqimor me siguri? — Ose diçka e përafërt, ndonjë nëpunës në intendencë i cili ia arrinte me mënyrën e vet t'i ofronte ndoshta fëmijës së shkretë një racion të denjë për disa ushtarë bashkë. Kështu ma merr mendja të paktën

— Unë, tha i katërti, kam hequr vuajtje të tmerrshme nga e kundërta e asaj për të cilën kritikohet zakonisht femra egoiste. Ju të vdekshëm fort të lumtur, jeni me fat që keni pse të qaheni për të metat e mikeshave tuaja!".

Këto fjalë të thëna me një ton shumë serioz, dolën nga goja e një burri me pamje të butë dhe të shtruar, me një fizionomi gati klerikale, ndriçuar për fat të keq nga ca sy gri të çelët vështrimi i të cilëve thoshte: "Unë dua!" ose: "Kështu duhet!" apo: "Unë s'fal kurrë!".

"Në qoftë se ju G..., aq nervoz sa jeni, ose ju të dy K... dhe J..., aq frikacakë dhe të cekët sa ç'ju

njoh unë, do kishit patur marrëdhënie me një farë gruaje që njoh unë, ose do t'ia kishit mbathur me të katra, ose do të kishit dhënë shpirt. Unë kam mbijetuar, siç e shihni dhe vetë. Përfytyroni dikë që është i paaftë të bëjë edhe gabimin më të vogël në ndjenja ose në qëllime; përfytyroni një qetësi karakteri dëshpëruese; një devotshmëri pa komedira dhe pa teprime; një butësi pa dobësi; një energji pa egërsi. Historia e dashurisë sime i përngjet një udhëtimi të pafund mbi një sipërfaqe të pastër dhe të lëmuar si pasqyrë, marrëmendthi monoton, që më pasqyronte të gjitha ndjenjat dhe gjestet me përpikërinë ironike të ndërgjegjes sime, në mënyrë të atillë që unë s'mund t'i lejoja vetes një gjest apo një ndjenjë të paarsyeshme pa parë menjëherë qortimin e heshtur të spektrit tim që s'më ndahej. Dashuria po më dukej si një mbikëqyrje e mërzitshme. Sa shumë marrëzira ajo më ka ndaluar t'i bëj dhe që tani më vjen keq që s'i kam kryer! Sa borxhe të paguara kundër dëshirës sime! Ajo m'i ndalonte të gjitha përfitimet që do të kisha mundur të nxirrja nga çmenduria ime. Me ca rregulla të ftohta dhe të pakapërcyeshme, ajo u vinte fre të gjitha kapriçove të mia. Dhe ajo që e bënte më të urryer, ishte se ajo nuk kërkonte ndonjë mirënjohje pasi rreziku kishte kaluar. Sa e sa herë mezi e kam mbajtur veten për të mos iu hedhur në grykë duke i klithur: "Mos ji pra kaq e përsosur, femër e poshtër! që të mund të të dua pa shqetësim dhe pa mllef!". Për vite të tëra e kam adhuruar, me zemrën

plot helm. Por në fund, s'isha unë ai që gjeti vdekjen!

— Ah! bënë të tjerët, ajo paska vdekur?

— Po! nuk mund të vazhdonte më ashtu. Dashuria ishte kthyer për mua në një makth të padurueshëm. Të fitosh ose të vdesësh, siç thotë Politika, e tillë ishte alternativa që më impononte fati! Një mbrëmje, në një pyll... në buzë të një liqeni..., pas një shëtitjeje melankolike gjatë së cilës sytë e saj pasqyronin ëmbëlsinë e qiellit, ndërsa zemra ime ishte e tkurrur si ferri...

— Çfarë!

— Si!

— Ç'doni të thoni?

— Ishte e pashmangshme. Unë e kam ndjenjën e drejtësisë tepër të fortë për të rrahur, fyer ose zbuar një shërbëtor shembullor. Por më duhej ta përshtatja këtë ndjenjë me urrejtjen që më zgjonte ajo qenie; ta hiqja qafe atë njeri duke patur respekt. Ç'tjetër mund të bëja me të, meqenëse *ajo ishte e përsosur?*".

Tre të tjerët e vështruan me ca sy të humbur dhe paksa të trullosur, duke bërë sikur nuk merrnin vesh dhe duke dhënë të kuptohej tërthorazi që ata vetë, nuk do të kishin qenë të aftë për një akt aq të ashpër, ndonëse arsyeja ishte e mjaftueshme.

Pastaj u sollën shishe të reja, për të vrarë Kohën që e ka jetën aq të gjatë, dhe për të shpejtuar Jetën që rrjedh aq ngadalë.

XLIII

Qitësi galant

Ndërsa llandoni përshkonte pyllin, ai e urdhëroi të ndalonte afër një qendre qitjeje meqenëse ia kishte ënda të shtinte ca plumba për të *vrarë* Kohën. Të vrasësh atë përbindësh, nuk është kjo puna më e zakonshme dhe më e ligjshme për këdo?

Dhe i ofroi me mirësjellje dorën të dashurës, grua e mrekullueshme dhe e neveritshme, grua misterioze të cilës ai i detyrohet për aq shumë kënaqësira e dhimbje, dhe ndoshta gjithashtu për një pjesë të gjenisë së tij.

Shumë plumba qëlluan jashtë tabelës; madje njëri u ngul në tavan; dhe ndërsa krijesa bukuroshe qeshte si e marrë, duke u tallur me ngathtësinë e të shoqit, ky i kthehet papritmas dhe i thotë: "E shikoni atë kukullën atje djathtas, me hundë përpjetë dhe me pamje aq mendjemadhe? E pra, ëngjëlli im i dashur, *do të përfytyroj që ajo kukull jeni ju*". Dhe

duke mbyllur sytë, tërhoqi këmbëzën e armës. Kukullës i iku koka paq.

Atëherë, ai u përkul përpara të dashurës, të mrekullueshmes, të neveritshmes gruas së tij, Muzës së tij të pashmangshme dhe të pamëshirshme, dhe duke i puthur dorën me respekt, shtoi: "Ah! ëngjëlli im i dashur, sa ju falenderoj për shkathtësinë time!"

XLIV

Supa dhe retë

Edashura vogëlushja ime e çmendur po më shërbente darkën, ndërsa nga dritarja e hapur e dhomës së bukës unë soditja arkitekturat e lëvizshme që Zoti bën me retë, ndërtimet e mrekullueshme të të paprekshmes. Dhe thosha me vete, i përhumbur në soditje: "—Të gjitha këto fantazmagori janë pothuajse po aq të bukura sa sytë e dashnores sime bukuroshe, të çmendurës vogëlushe të përbindshme me sy të blertë."

Befas mora një grusht të fuqishëm në kurriz dhe dëgjova një zë të çjerrë dhe të këndshëm, një zë histerik dhe si të ngjirur nga alkooli, zërin e vogëlushes sime të dashur që thoshte: "A do të filloni ta hani supën, or rrotë, or tregtar resh?"

XLV

Qitja dhe varreza

— *Kafene me pamje nga varreza.* — "Tabelë e çuditshme, tha me vete shëtitësi ynë, — por e zgjedhur mirë për të ndjellë etjen! Me siguri që i zoti di të çmojë Horacin dhe poetët dishepuj të Epikurit. Ndoshta njeh madje edhe rafinimin e thellë të egjyptianëve të vjetër, për të cilët nuk kishte gosti të vërtetë pa skelete ose pa ndonjë emblemë që të kujtonte shkurtësinë e jetës".

Dhe ai hyri, piu një birrë përballë varreve dhe tymosi ngadalë një puro. Pastaj i shkrepi në kokë të zbriste në këtë varrezë, bari i të cilës ishte goxha i lartë dhe ndjellës, dhe ku mbretëronte një diell i fortë.

Aty jashtë drita dhe ngrohtësia po harbonin, thuajse dielli i dehur ishte shtrirë sa gjatë e gjerë mbi një tapet lulesh të mrekullueshme, të ushqyera nga shkatërrimi. Një fëshfërimë e fuqishme jete

mbushte ajrin, — jeta e qenieve jashtëzakonisht të vogla, — e ndërprerë rregullisht nga krisma pushkësh që vinin nga një qendër qitjeje aty afër, dhe që shpërthenin si tapa shishesh shampanje në mes të zukamës së një simfonie të shurdhët.

Atëherë, nën diellin që i ngrohte trurin dhe në mes të parfumeve të përndezura të Vdekjes, ai dëgjoi një zë që pëshpëriste nga poshtë varrit mbi të cilin ishte ulur. Dhe ai zë thoshte: "Mallkuar qofshin shënjestrat dhe karabinat tuaja, të gjallë të zhurmshëm që as s'ju bëhet vonë për të ndjerët dhe qetësinë e tyre hyjnore! Mallkuar qofshin ambicjet tuaja, mallkuar qofshin llogaritë tuaja, të vdekshëm të paduruar, që vini të mësoni artin e të vrarit pranë tempullit të Vdekjes! Sikur ta dinit se sa lehtë fitohet çmimi, se sa kollaj qëllohet shenja, dhe sa e zbrazët është çdo gjë, përveç Vdekjes, nuk do të lodheshit kaq shumë, të gjallë që veç rropateni, dhe do ta turbullonit më pak gjumin e atyre që kanë arritur të rrokin Qëllimin, të vetmin qëllim dhe shenjë[1] të vërtetë të jetës së urryer!".

1. Lojë fjalësh, meqënëse në frëngjisht fjala but ka dy kuptime: qëllim (në përgjithësi) dhe shënjestër për të qëlluar. Në shqip është përdorur afria midis qëllim dhe shtirje (nga folja qëlloj) me pushkë.

XLVI

Humbja e aureolës

"Ah, ç'ne ju këtu, mik i dashur? Ju në një vend kaq famëkeq! ju, amatori i kuintesencave! ju, hamësi i ambrozisë! Me të vërtetë që po më habitni.

— I dashur mik, ju e dini se sa tmerr i kam unë kuajt dhe llandonët. Qëparë, duke kaluar me shpejtësi bulevardin dhe duke kërcyer për të shmangur baltën, në mes të atij kaosi të lëvizshëm ku vdekja mund të arrijë nga të katër anët përnjëherësh, aureola ime, nga një lëvizje e beftë, më rrëshqiti nga koka dhe ra në baltën e kalldrëmit. Nuk pata kurajon të ulesha ta merrja. Mendova që ishte më mirë të humbja dekoratat sesa të më thyheshin kockat. Por pastaj thashë me vete që ndonjëherë fatkeqësia ka të mirat e saj. Tani mund të shëtis incognito, të kryej akte të ulëta, të shijoj kënaqësinë e të qenit maskara, si të vdekshmit e thjeshtë. Ja pra, tek më keni, më në fund të

ngjashëm me ju, siç e shihni!

— Ju duhet të lajmëroni për humbjen e kësaj aureole, ose t'i drejtoheni policisë që t'jua gjejë.

— Jo, për besë. Ndihem mirë kështu. Ju jeni i vetmi që më njohët. Sido që të jetë, dinjiteti më mërzit. Pastaj mendoj me kënaqësi që ndonjë poet i dobët do ta gjejë dhe do ta vërë mbi kokë paturpësisht. Ç'kënaqësi të bësh dikë të lumtur! Dhe sidomos një të lumtur që do të më bëjë të shqyhem gazit! Përfytyroni X-in apo Z-n! Hëm, sa qesharake do t'ishte!".

XLVII

Zonjusha bisturi

Ndërsa po dilja nga lagjja, nën ndriçimin e fenerëve, ndjeva një krah që rrëshqiste butësisht nën krahun tim dhe dëgjova një zë që më pështpëriste në vesh: "Mjek jeni ju, zotëri?"

U ktheva të shihja: ishte një vajzë e gjatë, me sy paksa të çakërritur, e lyer lehtas, me flokët që i valëviteshin në erë së bashku me fjongot e kapeles.

" — Jo, nuk jam mjek. Më lini të kaloj."

" — Oh po, ju jeni mjek. Duket qartë. Ejani në shtëpinë time. Do të mbeteni vërtet i kënaqur nga unë, ejani!"

" — Me siguri që do të vij t'ju takoj, por më vonë, *pas mjekut* ta marrë dreqi!..."

"Aha! ia bëri ajo, gjithnjë e varur në krahun tim, dhe duke ia plasur gazit, — ju qënkeni mjek hokatar, kam njohur shumë si ju. Ejani!"

E dua me pasion misterin, sepse gjithnjë kam

shpresën se do ta zhbiroj. E lashë veten pra të tërhiqesha nga kjo bashkëbiseduese, ose më mirë nga kjo enigmë e papritur.

Po e lë mënjanë përshkrimin e kasolles; mund ta gjeni tek plot poetë të vjetër francezë mjaft të njohur. Por, një imtësi i pat shpëtuar Régnier-it: dy-tre portrete mjekësh të famshëm ishin varur në mure.

Më priti si jo më mirë! Zjarr bubulak, verë e ngrohtë, puro; duke më ofruar këto gjëra të mira dhe duke ndezur edhe vetë një puro, krijesa bufone më thoshte: "Rrini si në shtëpinë tuaj, miku im, zini rehat. Kjo do t'ju kujtojë spitalin dhe kohën e bukur të rinisë. — Epo kjo, kur ju paskan dalë këto thinja? Ju s'ishit kështu, nuk ka shumë kohë, kur ishit asistenti i L... Më kujtohet që ju ishit ai që e ndihmonte në operacionet e vështira. Ja një burrë të cilit i pëlqen të presë, të çajë e të krasisë! Ju ishit ai që i zgjaste instrumentet, fijet dhe sfungjerët. Dhe kur operacioni përfundonte, ai thoshte gjithë krenari, duke parë orën: "Pesë minuta zotërinj!" Eh, unë ku s'jam futur dhe i njoh mirë këta Zotërinj."

Disa çaste më vonë, duke m'u drejtuar me "ti", ia mori përsëri të njëjtit avaz, duke më thënë: "Ti je mjek, apo jo, maçoku im?"

Ky refren i pakuptimtë më bëri të brofja në këmbë. "Jo! thirra i xhindosur.

— Kirurg atëherë?

— Jo dhe jo! veç në qofsha për të të prerë kokën ty! T'ëmën e s'ëmës!

— Prit një sekondë, tha ajo, do ta shohësh vetë

Dhe nxori nga një sirtar një tufë letrash, që s'ishin gjë tjetër veçse koleksioni i portreteve të mjekëve të shquar të asaj kohe, të litografuar nga Maurin, nga ato që gjenden të ekspozuara prej vitesh në skelën Voltaire.

"Pa shiko, e njeh këtë këtu?

—Po, është X. Emrin e ka të shkruar poshtë për më tepër ; por e njoh personalisht.

— Ma mori mendja! Shiko, ja dhe Z., ai që thoshte gjatë leksionit, duke folur për X.: "Ai përbindësh që i duket shpirtligësia që në fytyrë!" E gjithë kjo sepse tjetri nuk ishte në të njëjtën mendje me të! Sa qeshnim me këtë gjë në Fakultet atëherë. të kujtohet? — Ja dhe K., ai që denonconte te qeveria kryengritësit që mjekonte në spital. Ishte koha e rebelimit. Si është e mundur që një burrë kaq i pashëm të ishte kaq pa shpirt? — Ja dhe W., mjek i famshëm anglez; e njoha gjatë një udhëtimi që bënte në Paris. Nuk të duket se ngjan me një zonjushe?"

Dhe ndërsa prekja një pako të lidhur me spango që gjendej gjithashtu mbi tryezë: "Prit pak, tha ajo; këta janë mjekët praktikantë dhe këta këtu janë asistentët."

Dhe shpalosi një masë të madhe fotografish mbi të cilat dukeshin fytyra shumë më të reja.

"Herën e ardhshme që do të shihemi ti do të ma japësh fotografinë tënde, apo jo shpirt?

—Po mirë, i thashë, duke ngulmuar edhe unë

në idenë time, — pse kujton se jam mjek?

—Sepse ti je kaq i mirë dhe i sjellshëm me gratë!

—Ç'logjikë e çuditshme!, thashë me vete.

—Oh, nuk gabohem asnjëherë ; kam njohur mjaft prej tyre. Aq shumë i dua këta zotërinj sa që, edhe pa qenë e sëmurë, shkoj herë pas here t'i shoh, kështu, për qejf. Ka që më thonë me ftohtësi: "Po ju s'jeni aspak e sëmurë!" Po ka të tjerë që më kuptojnë sepse une iu spërdridhem.

— Dhe kur ata nuk të kuptojnë...?

— Meqënëse i shqetësoj *kot*, iu lë 10 franga mbi vatër. — Ah sa të mirë dhe të butë që janë këta njerëz! Kam zbuluar në spitalin e Mëshirës një mjek student, të bukur si ëngjëll e të sjellshëm, dhe që i bie bretku, të shkretit djalë! Shokët e tij më thanë që s'kishte asnjë qindarkë sepse prindërit i ka të varfër dhe nuk kanë mundësi t'i dërgojnë asgjë. Kjo më dha besim. Fundja unë jam goxha femër e bukur, ndonëse jo fare e re. I thashë: "Eja të më takosh, eja shpesh. Mos ki merak se unë s'kam nevojë për para." Po ta merr mendja që ia lashë të kuptonte këtë gjë në mënyrë të tërthortë; nuk ia thashë copë; druhesha shumë se mos e poshtëroja, fëmijën e gjorë! — Epo, do më besosh nëse të them që më ka hypur në kokë një dëshirë e çuditshme që s'guxoj t'ia them? Do ma kish qejfi që ai të vinte të më takonte me çantën dhe bluzën e doktorit, të njollosur me gjak!"

Ajo i lëshon këto fjalë me një pamje krejt të

padjallëzuar, ashtu si një burrë i ndjeshëm do t'i thoshte një aktoreje që i pëlqen: "Do të doja t'ju shihja të veshur me kostumin që kishit në atë rolin e famshëm që lozni në skenë."

Unë, duke vazhduar të këmbëngulja, e pyeta përsëri: "A të kujtohet se në ç'periudhë dhe në ç'rrethana ka lindur tek ty ky pasion kaq i veçantë?"

Në fillim mezi më kuptoi ; por më në fund ia arrita qëllimit. Dhe atëherë ajo mu përgjigj me një pamje tepër të trishtuar, e madje, nëse më kujtohet mirë, duke ulur sytë: "Nuk e di... nuk më kujtohet."

Çfarë çudirash s'takohen në një qytet të madh kur di si të shëtisësh dhe të vëzhgosh gjithçka! Jeta gëlon nga përbindsha të pafajshëm. — O Zoti im! ju, Krijuesi, ju, i Plotfuqishmi; ju që keni krijuar Ligjin dhe Lirinë ; ju, sovrani që na lini të bëjmë ç'të duam, ju, gjykatësi që falni ; ju që jeni plot shkaqe dhe motive, dhe që më keni futur ndoshta në shpirt shijen e tmerrit me qëllim që të shndërroni zemrën time njëlloj siç shërohen gjërat me anë të thikës; o Zot, kini mëshirë, kini mëshirë për të çmendurit dhe të çmendurat! O Krijues! a mund të ekzistojnë përbindsha në sytë e Atij që është i vetmi që e di përse ata ekzistojnë, që e di se si *janë bërë* dhe se ç'duhej bërë që ata të *mos bëheshin*?

XLVIII

Any where out of the world

Kudo që të jetë, jashtë kësaj bote

Kjo jetë është një spital ku çdo i sëmurë s'ka veç një dëshirë: të ndryshojë shtratin. Njëri do të donte ta kalonte vuajtjen pranë stufës, ndërsa tjetri kujton se do të shërohej pranë dritares.

Gjithmonë më duket sikur do të jem më mirë atje ku nuk ndodhem, dhe këtë punën e shpërnguljes e pleqëroj vazhdimisht me shpirtin tim.

"Thuamë, shpirti im, i mjeri shpirt i ngrirë, ç'do të mendoje po të banonim në Lisbonë? Atje duhet të bëjë ngrohtë, dhe ti do mund të këndelleshe si të ishe një hardhucë. Ky qytet është në buzë të detit; thonë se është ndërtuar me mermer dhe se njerëzit atje kanë një urrejtje të atillë për gjelbërimin, saqë i shkulin të gjitha pemët. Ja pra një peizash sipas shijes tënde; peizazh i përbërë nga drita dhe minerali, dhe uji për t'i pasqyruar!".

Shpirti im nuk përgjigjet.

"Meqenëse ty të pëlqen aq shumë të pushosh gjithë duke soditur spektaklin e lëvizjes, do të vish të banojmë në Hollandë, në atë tokë që të jep prehje? Ndoshta do të zbavitesh në këto vise, pamjen e të cilave e ke admiruar aq shpesh nëpër muzera. Ç'mendon për Roterdamin, ty që të pëlqejnë pyjet e direkëve dhe anijet e lidhura buzë shtëpive?".

Shpirti im qëndron i heshtur.

"Batavia do të të pëlqente ndoshta më shumë? Atje do të gjenim, për më tepër, shpirtin e Evropës të shkrirë me bukurinë tropikale".

Asnjë përgjigje. — A mos vallë shpirti im paska vdekur?

"Deri në këtë pikë qenke topitur saqë gjen kënaqësi veç në fatkeqësinë tënde? Po të jetë puna kështu, le t'ia mbathim drejt viseve që janë shembëlltyrat e Vdekjes. — Lërma mua këtë punë, shpirti im i mjerë! Do të bëjme gati valixhet për Torneo. Të ikim edhe më larg, në anën tjetër të Baltikut; edhe më larg nga jeta, nëse është e mundur; le të vemi në pol. Atje dielli e fshik tokën vetëm pjerrtazi, dhe gërshetimet e ngadalta të dritës dhe të natës zhdukin larminë dhe shtojnë monotoninë, këtë fytyrë të dytë të asgjësë. Atje, ne mund të bëjmë banja të gjata errësire, ndërkohë që, për të na zbavitur, agimet boreale do të na dërgojnë herë pas here tufa rrezesh rozë, si pasqyrime të fishekzjarreve që vijnë nga Ferri!".

Më në fund, shpirti im shpërthen, dhe plot urtësi më bërtet: "Kudo që të jetë! kudo që të jetë! veç të jetë jashtë kësaj bote!".

XLIX

T'i rrahim të varfrit!

Kisha pesëmbëdhjetë ditë që isha mbyllur në dhomën time, i rrethuar me libra që ishin në modë asokohe (përpara gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë vjetësh); e kam fjalën për librat ku flitet për artin se si t'a bëjmë një popull të lumtur, të mençur dhe të pasur për njëzet e katër orë. Kisha tretur pra, — dua të them gëlltitur, — përçartjet e të gjithë ndërmarrësve të lumturisë publike, të atyre që i këshillojnë të gjithë të varfërit të kthehen në skllevër si dhe të atyre që përpiqen t'i bindin që ata janë të gjithë mbretër të shkurorëzuar. Nuk është pra aspak e habitshme që ndodhesha në një gjendje mendore që i afrohej mjaft trallisjes dhe budallallëkut.

Vetëm se më ishte dukur që ndieja, në thellësirat e mendjes sime, farën e errët të një ideje më të epërme se e gjithë enciklopedia e recetave prej grash shtëpiake që sapo kisha lexuar. Por ishte veçse

ideja e një ideje, diçka shumë e turbullt.

Pastaj dola, se më zuri një etje e madhe. Sepse dëshira e zjarrtë për të lexuar libra të dobët të ngjall një nevojë po aq të madhe për ajër të pastër dhe pije freskuese.

Ndërsa bëhesha gati të hyja në një tavernë, një lypës më zgjati kësulën, me një nga ato vështrime aq të paharrueshme saqë do të ishin të aftë të përmbysnin sovranët, sikur mendja të mund të lëvizte lëndën dhe sikur syri i një hipnotizuesi të mund të piqte rrushtë[1].

Në të njëjtën kohë dëgjova një zë që më pëshpëriste në vesh, një zë që e njoha menjëherë; ishte ai i një Engjëlli të mirë, ose i një Demoni të mirë, që më shoqëron gjithandej. Meqenëse Sokrati kishte Demonin e tij të mirë, pse mos ta kem dhe unë Engjëllin tim të mirë, dhe pse mos ta kem edhe unë nderin, ashtu si Sokrati, që të marr një çertifikatë marrëzie të nënshkruar nga mendje-mprehti Lélut dhe nga shumë i mençuri Baillarger[2]?

Ndryshimi midis Demonit të Sokratit dhe atij timit është se ai i Sokratit i shfaqej atij vetëm për ta mbrojtur, paralajmëruar dhe ndaluar, ndërsa i imi merr mundimin të më këshillojë, të më propozojë, të më bindë. Sokrati i shkretë kishte vetëm një Demon që e ndalonte; ndërsa ai i imi

1. Kjo shprehje i referohet një praktike të asaj kohe që përdorte hipnotizuesit për të shpejtuar pjekjen e frutave.

2. Lélut dhe Baillarger janë doktorë të famshëm të kohës së Baudelaire-it. Të specializuar në sëmundjet mendore, ata mbronin tezën që Sokrati ka qenë i marrë.

miraton, vepron dhe lufton.

Por zëri i tij më pëshpëriste këto fjalë: "Një njeri është i barabarti i një tjetri vetëm në qoftë se e provon këtë gjë, dhe është i denjë për liri vetëm ai që di ta fitojë atë".

Atëherë, pa një pa dy, iu vërsula lypsit tim. Me një goditje grushti ia mbylla njërin sy, i cili u fry aty për aty dhe u bë sa një top i vogël. Më iku një thua duke i thyer dhëmbët, dhe meqenëse, duke qenë i brishtë që nga lindja dhe i pastërvitur mirë në boks, nuk ndihesha aq i fuqishëm sa për ta vënë poshtë shpejt e shpejt këtë plakush, e kapa me njërën dorë nga jaka, me tjetrën e zura për fyti, dhe fillova t'ia përplasja kokën fort pas një muri. Më duhet ta pohoj që ndërkaq kisha hedhur një sy rreth e rrotull dhe e kisha fjetur mendjen që në atë rrethinë të shkretë nuk kishte mundësi të më shihte ndonjë polic.

Pastaj, me një shkelm kurrizit, aq të fortë sa për t'i thyer omoplatet, e hodha përtokë këtë gjashtë-dhjetvjeçar të dobët, kapa një degë të trashë peme që ndodhej përtokë, dhe e rraha me zellin kokëfortë të kuzhinierit që do të zbusë një biftek.

Papritur, — oh ç'mrekulli! oh kënaqësi e filozofit që vërteton përsosurinë e teorisë së tij! — pashë atë skelet antik të kthehej dhe të brofte në këmbë me një energji që kurrë s'do të më kish vajtur mendja se mund të vinte nga një mekanizëm aq i shkatërruar, dhe, me një shprehje urrejtjeje që m'u duk si *shenjë e mirë*, endacaku i drobitur u vërsul

mbi mua, m'i nxiu të dy sytë, më theu katër dhëmbë, dhe me të njëjtën degë peme më zhdëpi në dru. Me mjekimin tim energjik kisha arritur pra t'ia riktheja krenarinë dhe jetën.

Pastaj i bëra gjithë ato shenja për t'i dhënë të kuptonte që e quaja diskutimin si të mbaruar, dhe duke u ngritur në këmbë, me kënaqësinë e një sofisti të Portikës[3], i thashë: "*Zotëri, ju jeni i barabartë me mua!* Kini mirësinë të më nderoni duke marrë gjysmën e parave të mia; dhe nëse jeni filantrop, kujtohuni ta zbatoni mbi të gjithë sivëllezërit, kur ata t'ju kërkojnë lëmoshë, teorinë që unë pata *dhimbjen* të provoj mbi kurrizin tuaj".

Ai m'u betua që e kishte kuptuar teorinë time dhe që do t'u bindej këshillave të mia.

3. Një stoik. Në Greqinë antike filozofët mblidheshin te Porta e Portikës.

L

Qentë e mirë

Për z. Joseph Stevens[1]

Asnjëherë nuk më ka ardhur turp, madje edhe përpara shkrimtarëve të rinj të shekullit tim, të them që e adhuroj Buffon-in; por sot, nuk do të thërras në ndihmë gjeninë e këtij piktori të madhështisë së natyrës. Jo.

Do të preferoja shumë më tepër t'i drejtohesha Sterne-it dhe t'i thoja: "Zbrit nga qielli, ose ngjitu deri tek unë që prej fushave Eliziane, për të më frymëzuar që të shkruaj mbi qentë e mirë, qentë e gjorë, një këngë që do të ishte e denjë për ty, hokatar sentimental, hokatar i pakrahasueshëm! Eja kaluar mbi këtë gomar të famshëm që të shoqëron gjithmonë në kujtimin që ke lënë pas; dhe ky gomar të mos harrojë sidomos të mbajë, të varur hijshëm

1. Një piktor kafshësh, tabloja e të cilit më 1857, Intérieur de saltimbanque (Dhoma e një akrobati) duket se ka frymëzuar këtë prozë.

midis dhëmbëve, gurabien e tij të pavdekshme[2]!".

Prapsu muzë akademike! Në dreq vaftë kjo plakushe puritane. Unë dua të thërras muzën e përditshme, qytetaren, atë gjithë jetë, që të më ndihmojë të thurr këngë për qentë e mirë, qentë e gjorë, qentë e përbaltur, ata që të gjithë i largojnë si të kishin morrat apo murtajën, me përjashtim të lypësit të cilin shoqërojnë dhe të poetit që i shikon me një vështrim vëllazëror.

As që më bëhet vonë për qenin pispilluq, për këtë mendjemadh me katër këmbë, danez, king çarl, karlin apo spanjel, aq i kënaqur me veten saqë sulet në mënyrë të palejueshme nëpër këmbët ose mbi gjunjët e mysafirit, si të ishte i sigurt se të gjithë e duan, i zhurmshëm si një fëmijë, budalla si një lavire, disa herë gërnjar dhe i paturpshëm si një shërbëtor! Nuk më bëhet vonë sidomos për ata gjarpërinj me katër putra që dridhen dhe s'bëjnë asgjë, që i quajnë langonj, dhe që nuk kanë në turinjtë e tyre të mprehtë as një shqisë nuhatjeje të mjaftueshme për të ndjekur hapat e një miku, e as në kokën e tyre të shtypur aq zgjuarsi sa për të lozur domino!

Në kolibe, gjithë këta parazitë të mërzitshëm!

Çojini në koliben e tyre të mëndafshtë dhe të pambuktë! Unë këndoj për qenin e pistë, qenin e varfër, qenin e rrugëve, qenin endacak, qenin instiktin e të cilit, ashtu si atë të varfanjakut, të

2. Bëhet fjalë për një incident në pjesën Tristam Shandy të Sterne.

ciganit apo të aktorit ambulant, e ka mprehur në mënyrë të admirueshme nevoja, kjo nënë aq e mirë, kjo padrone e vërtetë e zgjuarsisë!

Unë këndoj për qentë fatkeqë, qoftë ata që enden të vetmuar nëpër rrugicat dredharake të qyteteve të mëdhenj, qoftë ata që i kanë thënë njeriut të vetmuar, me sy të pulitur dhe të zgjuar: "Merrmë me vete, dhe me dy fatkeqësitë tona do të mund të krijojmë ndoshta një si lloj lumturie!".

"*Ku venë qentë?*" thoshte dikur Nestor Roqueplan[3] në një artikull të pavdekshëm që ai, pa dyshim, e ka harruar e për të cilin vetëm unë, dhe ndoshta Sainte-Beuve[4], kujtohemi ende.

Ku venë qentë, thoni ju, njeri i pavëmendshëm? Shkojnë në punë të tyre.

Takime pune, takime dashurie. Përmes mjegullës, përmes dëborës, përmes baltës, në zhegun përvëlues, nën shiun që derdhet curril, ata shkojnë e vinë, çapiten, kalojnë nën makina, të çakërdisur nga pleshtat, pasioni, nevoja ose detyra. Si ne, ata janë ngritur që në pikë të mëngjesit, dhe fitojnë jetën e tyre ose vrapojnë drejt ëndjeve.

Kà që flenë nëpër gërmadha në periferi dhe që vijnë çdo ditë, në të njëjtën orë, për të kërkuar mbeturinat përpara derës së ndonjë kuzhine restoranti në Port-Royal; ka të tjerë që vrapojnë në lukuni, deri 5 milje larg, për të ndarë ushqimin që

3. Nestor Roqueplan (1804-70), drejtor teatri dhe kritik.

4. Charles Augustin Sainte-Beuve (1804-69), përveçse kishte shkruar poezi dhe një roman (Volupté), ishte kritiku më me ndikim i asaj kohe.

iu ka përgatitur zemërgjerësia e atyre beqareve gjashtëdhjetvjeçare, zemra bosh e të cilave iu është kushtuar kafshëve, meqënëse burrat mendjefyell nuk jua duan më.

Ka të tjerë që, si skllevër të arratisur, të marrosur nga dashuria, largohen në ditë të caktuara nga lagjja e tyre për të vajtur në qytet dhe për t'iu sjellë për nja një orë rrotull ndonjë bushtre të bukur, me një tualet paksa të lënë pasdore, por krenare dhe mirënjohëse.

Dhe të gjithë janë shumë të përpiktë, pa blloqe, pa shënime dhe pa portofole.

A e njihni Belgjikën përtace dhe a i keni admiruar si unë të gjithë ata qen të fuqishëm të mprehur në karrocën e kasapit, që nga bulmetorja deri te bukëpjekësi, dhe që tregojnë me lehjet e tyre ngadhënjyese kënaqësinë krenare që ndiejnë nga rivalizimi me kuajt?

Ja dy prej tyre që bëjnë pjesë në një sistem më të qytetëruar. Më lejoni t'ju fus në dhomën e një artisti kabareje që nuk ndodhet aty. Një shtrat prej druri të lyer, pa perde, velenxa që zvarrisen, të ndyera nga tartabiqet, dy karrige prej kashte, një stufë, një ose dy vegla muzike të prishura. Oh, ç'orendi të trishtueshme! Por vështroni, ju lutem, këta dy personazhe të zgjuar, të veshur me rroba sa të grira nga përdorimi aq edhe madhështore, të krehur si trubadurë[5] ose si ushtarakë, që ruajnë me

5. Poet që këndonte këngë kreshnikësh ose serenata dashurie.

një vëmendje shtriganësh *veprën pa emër* që zien mbi stufën e ndezur, në mes të së cilës ngrihet një lugë e gjatë që duket si një nga ata direkët ajrorë që lajmërojnë se ndërtimet kanë përfunduar.

A nuk do të ishte e drejtë që këta aktorë kaq të zellshëm të mos marrin rrugën pa e mbushur më parë stomakun me një supë të fuqishme që të mban? Dhe a nuk do t'ia falnit pak lakminë në të ngrënë këtyre djallushëve të shkretë që iu duhet të durojnë gjithë ditën e perëndisë mospërfilljen e publikut dhe padrejtësitë e një drejtori që merr pjesën më të madhe të fitimeve dhe që ha më shumë supë sesa të katër aktorët bashkë?

Sa herë i kam soditur, me buzë në gaz dhe i prekur, këta filozofë me katër këmbë, skllevër të bindur, të nënshtruar ose të përkushtuar, që fjalori republikan mund t'i kishte quajtur skllevër *jozyrtarë* sikur republika, tepër e zënë me *lumturinë* e njerëzve, të kishte kohë të merrej me *nderin* e qenve!

Dhe sa herë kam menduar që për të shpërblyer kaq kurajo, kaq durim dhe punë të rëndë, ekziston ndoshta diku (kush e di, fundja më në fund?) një parajsë e veçantë për qentë e mirë, qentë e varfër, qentë e pistë dhe të pikëlluar. Swedenborg thotë se ekziston një parajsë për Turqit dhe një për Hollandezët!

Barinjtë e Virgjilit dhe të Teokritit pritnin si çmim, për këngët e tyre, një djath të mirë, një fyell nga fabrikanti më i zoti ose një dhi me gjinj të fryrë.

Poeti që iu ka kënduar qenve të gjorë ka marrë si shpërblim një setër të bukur, me një ngjyrë që është njëherazi e pasur dhe e venitur, që të kujton diejt vjeshtorë, bukurinë e grave të pjekura dhe verat në Saint-Martin.

Askush nga ata që ishin të pranishëm në tavernën e rrugës Villa-Hermosa nuk do ta harrojë se me ç'gjallëri piktori e hoqi setrën për t'ia dhënë poetit, aq mirë e kishte kuptuar që ishte diçka e vlefshme dhe e ndershme që t'iu këndoje qenve të gjorë.

Si një tiran italian i madhërishëm që, në kohët e vjetra, i ofronte hyjnorit Aretino[6] një kamë të zbukuruar me diamantë ose një mantel oborri në këmbim të një soneti të çmuar apo të një poeme satirike origjinale.

Dhe sa herë që poeti vesh setrën e piktorit, ai është i detyruar të mendojë për qentë e mirë, për qentë filozofë, për verat në Saint-Martin dhe për bukurinë e grave vërtet të pjekura.

6. Pietro Aretino (1492-1556), satirist italian, paksa i shthurrur.

Epilog

Sot zemër lehtë jam ngjitur te kjo bregore e bukur
Prej ku qyteti duket i shtrirë skaj me skaj
Spitali, purgatori, bordelli, ferri, burgu,

Ku marrëzia e njerëzve shpërthen si një lulnajë.
Ti e di mirë, Satan, o zot i brengës sime,
Se unë s'vij këtu si qaraman të qaj;

Por si bandilli plak që vjen tek mikja plakë
Nga kjo lavire e trashë kam qejf të dehem thumb
Prej mishit skëterror të saj të ndizem flakë.

I fjetur qofsh, në ag i shtrirë gjithë përtaci,
I rëndë, i terratosur, me rrufë a i ngrefosur
Në vellon mbrëmësore spërkitur me flori,

Të dua, ashtu si je, o horr kryeqytet!
Laviret dhe banditët na japin shpesh ca ëndje,
Që leshkot e pafisëm s'i kapin kurrë në jetë.

PËRKTHEU: ISMAIL KADARE

PËRMBAJTJA

	Proza e të mallkuarit	5
	Për Arsène Houssaye	17
I.	I huaji	21
II.	Dëshpërimi i plakës	22
III.	Confiteor i artistit	23
IV.	Një hokatar	25
V.	Dhoma dyshe	27
VI.	Secili Kimerën e vet	31
VII.	I çmenduri dhe Venusi	33
VIII.	Qeni dhe shishja	35
IX.	Xhamashitësi i keq	36
X.	Në orën një të mëngjesit	40
XI.	Gruaja e egër dhe dashnorja nazemadhe	43
XII.	Turmat	47
XIII.	Vejushat	49
XIV.	Akrobati i vjetër	54
XV.	Embëlsira	58
XVI.	Ora	62
XVII.	Një hemisferë në një floknajë	64

XVIII. Ftesë për udhëtim 66
XIX. Lodra e varfanjakut 71
XX. Dhuratat e zanave 74
XXI. Tundimet ose Erosi, Plutusi dhe Fama 78
XXII. Muzgu i mbrëmjes 83
XXIII. Vetmia 86
XXIV. Projektet 89
XXV. Doroteja e bukur 92
XXVI. Sytë e të varfërve 95
XXVII. Një vdekje heroike 98
XXVIII. Monedha fallco 105
XXIX. Lojtari zemërgjerë 108
XXX. Litari 113
XXXI. Prirjet 119
XXXII. Tirsi 125
XXXIII. Dehuni pareshtur 128
XXXIV. Kaq shpejt! 129
XXXV. Dritaret 132
XXXVI. Dëshira për të pikturuar 134
XXXVII. Bamirësitë e hënës 136
XXXVIII. Cila është Benedikta e vërtetë? 138
XXXIX. Një kalë race 140
XL. Pasqyra 142
XLI. Porti 143
XLII. Portrete të dashurash 144
XLIII. Qitësi galant 151

XLIV.	Supa dhe retë	153
XLV.	Qitja dhe varreza	154
XLVI.	Humbja e aureolës	156
XLVII.	Zonjusha bisturi	158
XLVIII.	Any where out of the world Kudo që të jetë, jashtë kësaj bote	163
XLIX.	T'i rrahim të varfrit!	165
L.	Qentë e mirë	169

Epilog 175

Përmbajtja 177



CIP. Katalogizimi në botim. B. K. Tiranë

Baudelaire, Charles
Brenga e Parisit: Poema në prozë / Charles Baudelaire; Përkth. nga origj. B. Kadare. -Tiranë: Onufri, 2000
180f.; 21 cm - (Fondi i artë i letërsisë botërore)
Tit. origj. Le spleen de Paris

ISBN 99927-30-86-2

840-3

Proza franceze

SHTYPUR *DAJTI POLIGRAFI* TIRANE 2000

Në këtë bibliotekë që do të jetë e para në historinë e botimit shqiptar, lexuesi ynë do të skajojë njëra pas tjetrës veprat më të mëdha që ka krijuar gjer më sot mendja dhe pena e njeriut, në të gjithë rruzullin tokësor, nga antikiteti gjer në ditët tona. Do të ërshetohet kështu botimi i veprave klasike me ato moderne, i autorëve të njohur për lexuesin shqiptar, i vendeve të afërta dhe të largëta, gjithmonë me të vetmin kusht: çdo libër të jetë pjesë e Fondit të Artë të Letërsisë Botërore.

Vetë shkrimtarët e "mallkuar", jo vetëm që nuk deshën të përligjin asgjë për veprën e tyre, por me dëshirë shkuan drejt lëçitjes dhe mallkimit. "Unë e kultivoj histerinë time me ngazëllim e tmerr", shkruante Baudelaire në ditarin e tij intim. Në këtë rendje drejt bujës e skandalit, atje ku dukej se ishte strehuar forca e tyre, pikërisht atje, bashkë me të, ishte strehuar edhe brishtësia. Krijuesit e mëdhenj, ata, mendja e të cilëve punon në sferat sipërane të artit, vetvetiu i shmangen përzierjes së jetës së tyre të përditshme me aventurën e madhe të krijimit. Me fjalë të tjera, duke qenë të detyruar të jetojnë jetën njerëzore, qoftë me shkëlqimin e luksin, qoftë me mizerjen e saj, ata s'mund t'i marrin seriozisht as njërën as tjetrën, e aq më pak të vetmahniten a të vetvajtojnë për to. Shkurt, sfida e tyre ndaj epokës zhvillohet në përmasa të tjera dhe vështirë se mund të ketë gjë të përbashkët me modën kalimtare, me përndezjet e kafeneve, me lavdinë e dyshimtë, që mund të vijë nga përdorimi i drogës, apo përkëdhelja e amoralitetit.

ISMAIL KADARE

ISBN 99927-30-86-2



E 5

Çmimi 500 Lekë